



Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
MISIONI NË KOSOVË

Departmenti për të Drejtat e Njeriut dhe Sundim të së Drejtës

TË DREJTAT PRONËSORE NË KOSOVË
(Janar 2002)

Tabela e përmbajtjeve

I. Përmbledhja ekzekutive

II. Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe të Drejtat Pronësore

II. Hyrje në kornizën ligjore në Kosovë

1. Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara
2. Standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut
 - i. Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut (KEDNJ)
 - ii Marrëveshja Ndërkombëtare për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore (MNDESK)
 - iii Standardet tjera ndërkombëtare për të drejtat e njeriut
3. Ligji në fuqi
 - i Rregullorja e UNMIK-ut 2000/59, për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24 mbi ligjin në fuqi në Kosovë
 - ii Rregulloret e UNMIK-ut mbi themelimin e DPÇBP-së dhe KKPBP-së
 - iii Rregulloret tjera përkatëse të UNMIK-ut në lidhje me të drejtat pronësore
 - iv Ligji vendës në fuqi
4. Problemet të cilat burojnë nga korniza e tanishme ligjore në Kosovë
 - i Hierarkia e ligjeve
 - ii Vlefshmëria e akteve ligjore të kryera ndërmjet 22 marsit 1999 dhe 12 qershorit 1999
5. Disponibiliteti i ligjit në fuqi në Kosovë
6. Rekomandimet përkitazi me ligjin në fuqi në Kosovë

III. Drejtorati për Çështje Banesore dhe Pronësore dhe Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore

1. Informata paraprake

2. Komisioni për Ankesa dhe Parashtrësia pranë Drejtoratit për Çështje Banesore dhe Pronësore

- i Mandati dhe përbërja**
- ii Dhjetori i vitit 2001, afati për parashtrimin e ankesave**
- iii Aktivitetet për grumbullimin e ankesave**
- iv Zgjidhja e ankesave**

3. Vendosja dhe aktivitetet e DPÇBP-së

- i Administrimi i pronave të braktisura dhe skema e ndarjes së tyre. Delegimi i pushtetit komunave**

i.a) Regjioni i Pejës/Pec

i.b) Regjioni i Prishtinës/Pristina

i.c) Regjioni i Mitrovicës/Mitrovica

i.d) Regjioni i Gjilanit/Gnjilane

- ii. Mungesa e DPÇBP-së në regjionin e Prizrenit**
- iii. Problemet sa i përket administrimit dhe ndarjes së pronave të braktisura**
- iv. Problemet sa i përket delegimit të pushtetit të DPÇBP-së organeve komunale**
- v. Qasja e minoriteteve dhe grupeve të tjera të rrezikuara në Kosovë në DPÇBP**
- vi. Vendosja e DPÇBP-së jashtë Kosovës: Serbi, Mal të Zi dhe Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë (IRJM)**
- vii. Bashkëpunimi juridik dhe gjyqësor ndërmjet të administratave në regjion: UNMIK-u, RFJ-ja dhe IRJM-ja**
- viii. Dëbimet dhe e Drejta për Banim Adekuat**
- ix. Përfshirja e organeve të rendit publik në dëbime**

4. Rekomandimet

IV. Gjykatat e rregullta në Kosovë: Gjykimi i lëndëve që kanë të bëjnë me të drejtat pronësore dhe e drejta në proces të rregullt gjyqësor

- 1. Mandati i Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes sipas Kornizës Kushtetuese sa i përket çështjeve gjyqësore.**
- 2. Jurisdikcioni i gjykatave të rregullta sipas ligjit të zbatueshëm sa i përket pronës**
- 3. Konflikti i kompetencave ndërmjet të KKPB-së dhe gjykatave të rregullta**
 - i. Rregullimi i konfliktit të kompetencave me ligjin e zbatueshëm vendës**

- ii. Gjetjet e OSBE-së sa i përket konfliktit të kompetencave ndërmjet të KKPB-së dhe gjykatave të rregullta
- iii. Rastet e konfuzionit dhe konfliktit të kompetencave ndërmjet të KKPB-së dhe gjykatave të rregullta
- iv. Iniciativat për zgjidhjen e problemeve
- 4. Ngecja në zgjidhjen e kontesteve pronësore në gjyqet e rregullta në Kosovë
- 5. Qasshmëria e gjykatave të rregullta për minoritetet të cilat kërkojnë përkufizimin e të drejtave pronësore
- 6. Rekomandimet përkitazi me të drejtat pronësore dhe procesin e rregullt gjyqësor nëpër gjykatat e rregullta në Kosovë.

Shtojca: Prona në Kosovë – Pasqyrë Historike

Vërejtje

Burimet e ligjit vendës të cituara bë këtë raport paraqesin përkthime jozyrtare. Të vetmet përkthime zyrtare të ligjit vendës mund të gjinden në Gazetën Zyrtare të UNMIK-ut. Gjer më tani, përveç rregulloreve të UNMIK-ut, në këtë gazetë, nuk janë publikuar ndonjëri prej ligjeve vendëse mbi pronën. Gazetat Zyrtare për të gjitha rregulloret e UNMIK-ut, ato prej vitit 1999 dhe 2000, janë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe serbe dhe janë publikuar në verzionin elektronik, ndërsa vetëm disa rregullore të vitit 2001 janë përkthyer zyrtarisht, kurse asnjë nga ato të vitit 2002.

I. Përmbledhje ekzekutive

Të drejtat pronësore në Kosovë vazhdojnë të jenë në krizë. Mekanizmat përgjegjës për zgjidhjen e kontesteve pronësoro-juridike nuk funksionojnë plotësisht. Që nga raporti i klauar i OSBE-së, mbi pronën, ligjet e pronës ende nuk janë qartësuar. Ende ekziston një mungesë e udhëzimeve përkitazi me atë se çfarë veprimesh duhet ndërmarrë me qëllim të sigurimit të një qasje të harmonizuar, me qëllim të zgjidhjes së rasteve që kanë të bëjnë me shkeljen e të drejtave pronësore. Uzurpimi i paligjshëm, mungesa e qasjes së barabartë në mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave pronësore, shitjeve strategjike të pronave serbe dhe arbitrariteti i cili ekziston në sistemin gjyqësor dhe organet komunale, ende vazhdon të jetë si i tillë. Krahas kësaj, duke marrë parasyshë paqartësinë e tanishme e cila buron nga ligjet e tanishme dhe se ligjet vendëse të cilat janë pruar në fuqi para vitit 1989, janë disajnuar në bazë të nevojave dhe interesave të ekonomisë së kontrolluar, është mëse e qartë se duhet bërë një reformë të sistemit gjithëpërfshirës juridik. Si rrjedhojë e mungesës së reformave, në këtë drejtim pason, cenimi sistematik dhe tejet i përhapur i të drejtave pronësore dhe banesore.

Ky raport ofron një pasqyrë sa i përket përparimit të arritur nga ana e dy institucioneve kryesore të cilat janë përgjegjëse për sigurimin e mjeteve efikase juridike, vizavi shkeljeve të të drejtave pronësore, siç janë, Drejtorati për Çështje Banesore dhe Pronësore (DPÇBP) dhe Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore (KKPB) në njërën anë, dhe gjykatat e rregullta në anën tjetër. Me qëllim të vendosjes së temës të cilën e shtjellojmë në kontekst të kësaj, ky raport gjithashtu ofron një përmbledhje të standardeve të pranuar ndërkombëtarisht për të drejtat pronësore, legjilacionit të nxjerrur nga Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara (UNMIK) dhe ligjit vendës në fuqi. Me qëllim të adresimi të një numri të problemeve më të mëdha, ky raport gjithashtu bën rekomandime sa i përket marrjes së veprimeve në të ardhmen. Ky raport përqendrohet në tri fusha kryesore:

1) OSBE-ja kishte raportuar vazhdimisht në shtator të vitit 2000, se mungesa e qartësisë të cilat burojnë nga ligjet e pronës, paraqet problemin kryesorë, i cili ndërlidhet me gëzimin e barabartë të të drejtave pronësore në Kosovë. Një mungesë e tillë e qartësisë, reflektohet nga zbatimi joadekuat i ligjit nga ana e organeve të cilat ushtrojnë funksione shtetërore. Një përmirësim i dukshëm në këtë drejtim është arritur me miratimin e rregullave të procedurës të DPÇBP-së dhe KKPB-së. Sidoqoftë, ligji në fuqi mbi pronën ende nuk është hartuar dhe publikuar, përderisa na mungon një interpretim autoritativ i tij. Derisa të mos ndodhë kjo, vihet në rrezik qartësia ligjore që ka të bëjë me të drejtat pronësore. Një shembull i qartë i gjithë kësaj, paraqet interpretimi i ndryshëm i hierarkisë së ligjeve dhe vlefshmërisë së akteve ligjore të cilat janë nxjerrur ndërmjet marsit 1989 dhe qershorit 1999. Rekomandimet thelbësore të këtij raporti, sa i përket ligjeve të pronës, janë paraqitur si në vazhdim:

- **Sqarimi i ligjit, nëpërmjet të një interpretimi autoritativ, dhe publikimi i ligjeve të pronës paraqet një nevojë urgjente në këtë drejtim.**
- **Ligjet duhet t'i vëhen në dispozicion gjyqësisë, komunitetit ligjor dhe nëpunësve publik, brenda një periudhe kohore të duhur, dhe të botuara në të gjitha gjuhët zyrtare, siç parashikohet me rregulloret e UNMIK-ut.**

2) Mandati i DPÇBP-së dhe KKPB-së, konsiston në atë që, *inter alia*, të zgjidh kontestet pronësoro-juridike, të administrojë pronat e braktisura dhe ofroj udhëzime për çështje përkatëse UNMIK-ut dhe akterëve tjerë ndërkombëtar. Pas një viti gjatë të cilit ekzistonte një vakum ligjor, ky institucion u sanksionua me një rregullore, e cila edhe ia ndau mandatin të cilin institucioni në fjalë duhet ta kryej. Krahas kësaj, marrëveshja e 5 nëntorit 2001, ndërmjet UNMIK-ut dhe

qeverisë së RFJ-së, i mundësuan DPÇBP-së të lansojë aktivitetet e saj të mbledhjes së kërkesave pronësoro-juridike edhe në vetë Serbi dhe Mal të Zi. Përkundër zhvillimeve të tilla, ky institucion ende nuk funksionon plotësisht. Gjendja e tanishme financiare e institucionit në fjalë, ka shtyer menagjmentin e tij që të zvogëlojë deri në minimum aktivitetet e veta në Kosovë dhe të përqëndrohet më shumë në mbledhjen e kërkesave pronësoro-juridike në Serbi dhe Mal të Zi. Në bazë të planit të tanishëm të parashikimit financiar, ky institucion gradualisht do t'i mbyllë programet e veta dhe do të pushojë me aktivitetet në verën e vitit 2002. Suksesi i DÇBP-së, në realizimin e mandatit të vet, paraqitete si esencial në procesin e rikthimit dhe riintegrit të minoriteteve të Kosovës. Momentalisht, në njërin anë, nuk ekziston ndonjë ndërlikim në mes të programeve apo/dhe aktiveve të planifikuara të rikthimit dhe riintegrit të minoriteteve, gjithashtu, në anën tjetër, nuk ekziston procesi i vlerësimit dhe njoftimit apo procesi i dëbimit nga banesat/shtëpitë.

Rekomandimet themelore të këtij dokumenti, që kanë të bëjnë me ndarjen adekuate të resurseve, përkritazi me Drejtoratin për Çështje Banesore dhe Pronësore dhe Komisionin për Ankesa dhe Parashpresa pranë Drejtoratit për Çështje Banesore dhe Pronësore, janë paraqitur si në vijim:

- **HABITAT-i dhe UNMIK –u duhet t'i japin një prioritet më të madh ndarjes së resurseve për DPÇBP-në dhe KKPB-në. Resurset në fjalë duhet të ndahen në mënyrë të qëndrueshme në mënyrë që ky institucion të jetë në gjendje të kryej mandatin e tij në mënyrë adekuate.**
- **Resurset duhet të administrohen drejtpërdrejt nga DPÇBP-ja. UNMIK-u, duhet të siguroj që DPÇBP-ja dhe KKPB-ja duhet të funksionojnë në kuadër të kornizës ligjore të UNMIK-ut dhe të shqyrtoj mënyrat për gjetjen e bashkëpunimit dhe integritit të shtuar. DPÇBP-ja dhe KKPB-ja nuk mund të përmbushin mandatin e tyre pa përkrahjen e dhënë nga ana e degëve dhe organeve të tjera të UNMIK-ut.**

Ekzistojnë një sërë çështjesh të cilat DPÇBP-ja dhe KKPB-ja duhet t'i adresojnë në mënyrë që të kryejnë mandatin e tyre, duke supozuar se këto dy institucione do të gjejnë mjete të mjaftueshme financiare. Rekomandimet kryesore përkritazi me Drejtoratin për Çështje Banesore dhe Pronësore dhe Komisionin për Ankesa dhe Parashpresa pranë Drejtoratit për Çështje Banesore dhe Pronësore janë paraqitur si në vijim:

- **Ky institucion duhet të ofroj udhëzime UNMIK-ut dhe të gjitha institucioneve tjera të cilat biejnë nën ombrellën mbi çështjet e ndryshme pronësoro-juridike.**
- **Ky institucion duhet të përmirësoj efikasitetin e punës së tij, veçanërisht në kryerjen e mandatit të tij, duke shpejtuar zgjidhjen e kërkesave pronësoro-juridike dhe ekzekutimit të vendimeve të marra.**
- **Bashkëpunimi i shtuar me organet dhe institucionet tjera të cilat ushtrojnë funksione shtetërore të cilat janë përgjegjëse për të drejtat pronësore dhe banesore për qëllim të parandalimit të shkeljeve të të drejtave pronësoro-banesore dhe të krijimit të një baze solide për disajnimin dhe funksionimin efikas të politikave banesore.**

3) Sistemi juridik civil kërkon një reformë të përgjithshme e cila i merr parrasysh edhe institucionet dhe realitetet e reja të cilat mbretërojnë në Kosovë dhe që merret me efektet e konfliktit. Njëri prej problemeve kryesore i cili duhet adresuar në këtë drejtim është edhe konfuzioni i pranishëm lidhur me çështjen e kompetencave ndërmjet gjykatave të rregullta dhe KKPB-së. Së dyti, lëndët pronësore të pazgjidhura dhe të grumbulluara duhet të zgjidhen (gjykohen), dhe në veçanti, ato të cilat presin zgjidhje që para 12 qershorit 1999, sidomos ato

dosjet e të cilave kanë humbur apo janë shkatërruar si rezultat i konfliktit të armatosur, dhe ato ku palë kontestuese janë edhe institucionet të cilat ushtrojnë funksione shtetërore. Dhe së fundi, qasja e minoriteteve në mekanizmat për vërtetimin e të drejtave dhe detyrimeve të tyre pronësore, mebetet një shqetësim kryesor për OSBE-në duke marrur parasysh informatat të cilat i përmban ky raport. Rekomandimet kryesore të këtij raporti sa i përket gjykatave të rregullta dhe përmirësimit të përgjithshëm të kompetencave civile janë:

- **Duhet të themelohet një komision drejtues ndërqeveritar me qëllim të zhvillimit, rekomandimit, promovimit dhe hartimit të legjislacionit dhe dokumenteve tjera, të cilat kanë për qëllim, adresimin e problemeve të cilat janë të identifikuara gjithashtu edhe me këtë dokument. Një grup i tillë punues duhet të ketë edhe pëlqimin e marrë nga instancat më të larta të organizatave të përfshira në këtë proces.**
- **Ligjet përkatëse procedurale, duke përfshirë këtu edhe Ligjin e Procedurës Civile, Rregulloren e Gjykatave të Rregullta dhe Ligjin e Procedurës Administrative, duhet të ndryshohen, nëpërmjet të rregulloreve dhe urdhëresave administrative ,me qëllim që të sigurohet një integritim i plotë i DPCBP-së dhe KKPB-së në sistemin e tërësishëm juridik dhe të garantohet e drejta për një proces të mirëfilltë gjyqësor.**
- **Roli i Gjykatës Supreme, sa i përket mospërputhjes së kompetencave, duhet të sqarohet nga vetë Gjykata Supreme nëpërmejt të jurisprudence, dhe grupit punues ndërqeveritar mbi konfliktin e kompetencave. Rezultati i gjithë kësaj duhet të inkorporohet në reformën e tërësishme ligjore.**
- **Duhet të bëhet një përcaktim i qartë në kontekst të reformave ligjore të propozuara në këtë raport, mbi statusin i cili duhet dhënë lëndëve të cilat presin vendimin përfundimtar nëpër gjykata të cilat gjithashtu janë prezentuar para themelimit të UNMIK-ut.**

I. Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe të drejtat pronësore

Njëra prej obligimeve primare të prezencës ndërkombëtare civile në bazë të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara është “promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut”.¹ Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm i 12 qershorit 1999 i jep përgjegjësinë kryesore OSBE-së sa i përket të drejtave të njeriut, e cila paraqet një rëndësi prej shtyllave të ndërtimit të institucioneve pranë UNMIK-ut. Njëra prej detyrave themelore për Misionin e OSBE-së në Kosovë e cila përfshihet gjithashtu edhe në vendimin nr. 305 të këshillit Ministror të OSBE-së është monitorimi i të drejtave të njeriut dhe ndërtimi i institucioneve. Paragrafi 87 i raportit të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara thotë se,

‘UNMIK do të ketë një trup të monitoruesve të të drejtave të njeriut dhe këshilltarëve të cilët do të kenë qasje të papenguar në të gjitha pjesët e Kosovës për të hetuar rastet e shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe të sigurojnë se shqetësimet që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut do të adresohen gjatë aktiviteteve të përgjithshme të cilat i kryen ky mision. Monitoruesit e të drejtave të njeriut, nëpërmjet të Zëvendësit të Përfaqësuesit Special për Ndërtimin e Institucioneve, do të raportojnë për gjetjet e tyre vetë Përfaqësuesit Special. Gjetjet e monitoruesve të të drejtave të njeriut do të bëhen publike rregullisht dhe do të shfrytëzohen sipas nevojës nga ana e mekanizmave për të drejtat e njeriut pranë OSBE-së, në konsultim me Zyrën e Komesariatit të Lartë të

¹ UNSCR 1244 par. 11(j)

*Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut. UNMIK-u do të promovoj aftësitë e raportimit dhe përgjigjes së koordinuar.*²

Spektori i të Drejtave të Njeriut, pranë Departamentit për të Drejtat e Njeriut dhe Sundim të së Drejtës të Misionit të OSBE-së në Kosovë, ka përqëndruar aktivitetet e veta në të drejtat pronësore dhe banesore, në të drejtën për proces të mirëfilltë gjyqësor dhe të drejtën për mjete juridike efikase. Këto të drejta përfshijnë në vete edhe ndihmën për rindërtim të pronave banesore, qasjen në strehimoret e përkohshme për personat e pa strehë dhe qasjen në mekanizmat për zgjidhjen e kontesteve rezidenciale dhe jorezidente. (KKPB-në dhe gjykatat e rregullta). Spektori i të Drejtave të Njeriut, përqëndron aktivitetin e vet gjithashtu edhe në monitorimin e dëbimeve, ekspropriimit, procedurave dhe praktikave administrative, si në nivel komunal ashtu edhe në atë qëndror dhe në reformën legislative që ka të bëjë me të drejtat pronësore.

Që nga raporti i kaluar,³ OSBE-ja ka monitoruar implementimin e legjislacionit të pronës dhe aktivitetet e DPÇBP-së, organeve komunale dhe organeve të rendit publik. Krahas kësaj, OSBE-ja shkëmben shumë informata me DPÇBP-në, me qëllim të ndërmarrjes së veprimeve të koordinuara, duke përfshirë këtu edhe lehtësimet gjatë parashtrimit të kërkesave pronësoro-juridike nga ana e grupeve të popullatës me liri të kufizuar të lëvizjes. Për më tepër, ajo ka rritur vetëdijen në kuadër të grupeve të popullatës të cilat i ka nën shënjestër të aktiviteteve të saj, duke përfshirë këtu, edhe opinionin e përgjithshëm publik, minoritetet dhe nëpunësit civil sa i përket mekanizmave në dispozicion për qëllim të mbrojtjes së të drejtave pronësore dhe mënyrat në bazë të të cilave ata mund t'ju qasen këtyre mekanizmave. Duke iu referuar raportit të fundit të OSBE-së, mund të theksohet se rekomandimet për veprim të dhëna nga OSBE-ja janë vënë në jetë, veçanërisht sa i përket lehtësimit të qasjes së plotë të minoriteteve në mekanizmat përkatës, duke i dalur në ndihmë DPÇBP-së në organizimin e ekipeve mobile, në përkrahjen e rritjes së vetëdijes publike, duke shpërndarë fletushka informative dhe duke ofruar trajnim për gjyqësinë. Sidoqoftë, OSBE-ja është e vetëdijshme për nevojën e vazhdimin të aktiviteteve të tilla. Natyrisht, identifikimi i vazhdueshëm i problemeve dhe zgjidhjeve shërbejnë për të definuar aktivitetet dhe qëllimet e OSBE-së.

OSBE-ja ka qenë gjithashtu e përfshirë në procesin e krijimit të një institucioni *ad hoc* për zgjidhjen e kontesteve pronësoro-banesore. OSBE-ja gjithashtu është e përfshirë në ofrimin e udhëzimeve UNMIK-ut, sa i përket çështjeve pronësoro-juridike, siç janë, DPÇBP-ja dhe KKPB-ja. Krahas kësaj, OSBE-ja ka marrur pjesë në zhvillimet ligjore të kohëve të fundit në kuadër të UNMIK-ut, në monitorimin e punës së gjykatave të rregullta në këtë drejtim dhe ka mbështetur idenë e zbatimit të politikave të të drejtave të njeriut, të cilat janë në pajtim me të drejtat e njeriut si në nivel komunal ashtu edhe në atë qëndror. OSBE-ja gjithashtu ka intervenuar tek organet të cilat ushtrojnë funksione shtetërore sidomos pasi që kanë kuptuar për ndonjë pohim serioz mbi shkeljet e të drejtave pronësore. Me partnerët e saj në kuadër të bashkësisë ndërkombëtare dhe akterët tjerë, OSBE-ja do të vazhdojë të promovojë në mënyrë aktive idenë për reforma ligjore. Kjo në veçanti ka të bëjë me, sigurinë e funksionit shtetëror dhe procesin e mirëfilltë gjyqësor. Për më tepër, metodat intervenuese të OSBE-së janë në proces të formulimit të tyre në procedura të brendshme standarde vepruese me qëllim të përmirësimit të situatës sa i përket realizimit të rezultateve sistematike, të sakta dhe të qëndrueshme. Në partneritet me institucionet tjera dhe palët të cilat kanë interes në çështjet pronësore, OSBE-ja do të vazhdojë të promovojë implementimin e legjislacionit të tanishëm në fuqi. Ajo gjithashtu do të vazhdojë të identifikojë fushat ku mund të realizohen këto reforma dhe të promovojë një legjislacion pasues, dhe nëpërmjet të bashkëpunimit me misionet tjera të OSBE-së do të promovojë qasje dhe politika regionale që kanë të bëjnë me zbatimin e të drejtave pronësore.

² S/1999/779 12 korrik 1999

³ Shih Raportin e OSBE-së, Kriza e afërt të pronave në Kosovë (shtator 2000).

Së fundi, OSBE-ja përkrah krijimin e politikave dhe mekanizmave kontrollues për të siguruar që anëtarët e stafit, si ata vendës ashtu edhe ata ndërkombëtar, të cilët punojnë për agjencitë e huaja në Kosovë të mos pengojnë në implementimin adekuat të këtyre ligjeve. UNMIK-u dhe organizatat tjera ndërkombëtare të cilat janë prezente në Kosovë duhet të miratojnë dhe implementojnë mekanizmat e tillë, siç ka vepruar bashkësia ndërkombëtare edhe në Bosnjë dhe Hercegovinë. OSBE-ja thirret në Kodin e saj të Mirësjelljes për anëtarët e saj e cila thotë se: "Anëtarët e Misioneve të OSBE-së duhet të respektojnë ligjet e vendeve në të cilat ata gëzojnë privilegje dhe imunitet". Mund të ndërmerren madje edhe veprime disiplinore kundër një anëtari të stafit të OSBE-së për mosrespektim të Kodit të Mirësjelljes së OSBE-së.

II. Hyrje në kornizën ligjore në Kosovë

1. Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara

Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, paragrafi 11 (j), i njeh të gjitha standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut si të aplikueshme në Kosovë. Një mbrojtje e tillë e të drejtave të njeriut është për më tutje e precizuar edhe në ligjin e zbatueshëm.

2. Standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut

i. Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut (KEDNJ)

Këto janë disa prej dispozitave të KEDNJ të cilat vlejnë për rastin e Kosovës kur kemi të bëjmë me të drejtat pronësore:

- **E drejta për pronë (neni 1 Protokoli 1);**
- **E drejta për proces të drejtë gjyqësor (neni 6);**
- **E drejta për mjete juridike efikase (neni 13);**
- **Ndalimi i diskriminimit (neni 14);**
- **Ndalimi i shkeljes së të drejtave (neni 17).**

ii. Marrëveshja Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (MNDESK)

Komisioni i Kombeve të Bashkuara i dalë nga Marrëveshja Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore nga gjiri i saj nxerrur edhe një organ të pranuar ndërkombëtarisht të drejtësisë. Interpretimet e dhëna nga ky komision sa i përket të drejtave të paraqitura si mëposhtë janë esenciale për vlerësimin e punës së autoriteteve të cilat kryejnë funksione shtetërore në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.⁴ Krahas kësaj, është e pamundshme që të vlerësohet realizimi i të drejtave pronësore (banesore dhe atyre jo-banesore) në Kosovë pa i shqyrtuar pakëz edhe të drejtat banesore. Dispozitat e mëposhtme të kësaj Marrëveshje përmbajnë në vete edhe një referim që iu është bërë detyrimeve të cilat i kanë autoritetet të cilat kryejnë funksione shtetërore sa i përket të drejtave banesore:

- **Detyrimet shtetërore sa i përket të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore (neni 2);**
- **E drejta për strehim adekuat (neni 11).**

iii. Standardet tjera ndërkombëtare për të drejtat e njeriut

Duke marrë parasysh se Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara nënkupton se UNMIK-u ka për detyrë që të promovojë dhe mbroj të gjitha standardet e pranuar ndërkombëtarisht, standardet përkatëse ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, me theks të

⁴ Shih Komentin e Përgjithshëm Nr.3 dhe Komentin e Përgjithshëm Nr. 7 të Komitetit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore.

posaçëm për të drejtat pronësore dhe banesore të cilat meritojnë konsideratë të veçantë. Për shembull, Marrëveshja Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor (MNEFDR), Konventa mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Gruas (KEFDG) dhe Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve, përcaktojnë standarde të qarta në raport me të drejtat pronësore për grupet e njerëzve të cilët janë nën shënjestër të aktiviteteve të tyre. Rregullorja 2000/59, e 27 tetorit 2000, mbi ligjin në fuqi, përshkruan një sërë instrumentesh ndërkombëtare relevante dhe i bën ato drejtpërdrejt të zbatueshme në Kosovë.

Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë, e pruar në fuqi më 15 maj 2001 nga ana e PSSP-së, nëpërmjet të Rregullores së UNMIK-ut 2001/9, inkorporon në kuadër të kornizës ligjore vendëse në Kosovë, standardet kryesore ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. OSBE-ja ka vërejtur se, megjithatë, Marrëveshja Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore nuk është e përfshirë në kuadër të Kornizës Kushtetuese, edhe pse është e përfshirë në kuadër të Rregullores së UNMIK-ut 59, për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/24 mbi ligjin në fuqi në Kosovë dhe së këndejmi do të vëzhgohet nga të gjithë personat të cilët kryejnë detyra publike apo kryejnë funksione publike në Kosovë (shih si mëposhtë).

3. Ligji i Zbatueshëm

i. Rregullorja e UNMIK-ut 2000/59, për ndryshimin e Rregullores Nr. 1999/24 mbi Ligjin në fuqi në Kosovë

“Ligji i Zbatueshëm në Kosovë është i definuar në bazë të Rregullores 2000/59 për ndryshimin e Rregullores Nr. 1999/24 mbi ligjin në fuqi në Kosovë. Në bazë të Rregullores në fjalë, ligji i zbatueshëm në Kosovë janë të gjitha rregulloret e nxjerrura nga PSSP-ja dhe ligji i cili ishte në fuqi në Kosovë para 22 marsit të vitit 1989 (me rregulloret të cilat mbisundojnë në rast të mospërputhjes së kompetencave).”⁵

ii. Rregullorja e UNMIK-ut për themelimin e DPÇBP-së dhe KKPB-së

UNMIK-u ka themeluar Drejtoratin për Çështje Banesore dhe Pronësore (DPÇBP) dhe Komisionin për Kërkesa Pronësore dhe Banesore (KKPB). DPÇBP-së i është dhënë mandati ekskluziv për zgjidhjen e kërkesë padive më kontraverze banesoro-pronësore, duke përfshirë këtu edhe:

- **kërkesat për kthimin e pronës së humbur si rezultat i diskriminimit;**
- **kërkesat për regjistrimin e shitblerjeve joformale të pronës; dhe**
- **kërkesat nga refugjatët dhe personat e zhvendosur të cilët e kanë humbur posedimin ndaj shtëpive të tyre dhe të cilët dëshirojnë t'i kthejnë apo vëjnë në qarkullim pasurinë e tyre.**

⁵ Rregullorja e UNMIK-ut 2000/59 thekson se:

“2 Në qoftë se një gjykatë e jurisdikcionit kompetent, një organ ose një person që duhet të zbatojë një dispozitë të legjislacionit, konstaton se një çështje ose një situatë nuk mund të mbulohet nga legjislacioni i përcaktuar në paragrafin 1.1 të kësaj rregulloreje, por mbulohet nga një ligj tjetër në fuqi në Kosovë pas 22 marsit 1989, i cili nuk është diskriminues dhe është në përputhje me nenin 1.3 të kësaj rregulloreje, atëherë gjykata, organi ose personi, si përjashtim, e zbaton atë ligj.

3. Gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, të gjithë personat me detyra publike ose që mbajnë pozita publike duhet t'i respektojnë standardet e njohura ndërkombëtare të të drejtave të njeriut siç pasqyrohen veçanërisht në: Deklaratën universale të të drejtave të njeriut të, Konventën Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut, Marrëveshjen ndërkombëtare për të drejtat qytetare dhe politike, Marrëveshjen ndërkombëtare për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore

4. Asnjë person, i cili ushtron detyra publike apo mban ndonjë pozitë publike në Kosovë nuk lejohet të diskriminojë ndonjë person tjetër për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, gjuhës, fesë, bindjes politike ose bindjeve të tjera, origjinës kombëtare, etnike apo sociale, shoqërimet me një komunitet kombëtar, pasurisë, lindjes ose të ndonjë statusi tjetër.

Jurisdikcion për zgjidhjen e të gjitha kontesteve tjera pronëso-ro-juridike e kanë gjykatatat vendëse. DPÇBP-ja gjithashtu duhet të udhëzojë UNMIK-un mbi një sërë çështjesh pronëso-re, duke përfshirë këtu edhe rekomandimet për ndjekjen e politikave përkatëse si dhe ofrimin e këshillave juridike përkitazi me ligjin mbi pronën.⁶ Rregulloret të cilat kanë themeluar DPÇBP-në dhe KKPB-në dhe rregullat e saj të procedurës janë paraqitur si mëposhtë:

- Rregullorja e UNMIK-ut mbi themelimin e DPÇBP-së dhe KKPB-së (15 nëntor 1999);
- Rregullorja e UNMIK-ut 2000/60 mbi kërkesat pronëso-ro-banesore dhe rregullat e procedurës dhe dëhmitë të DPÇBP-së dhe KKPB-së (31 tetor 2000).

iii. Rregulloret tjera të UNMIK-ut për të drejtat pronëso-re

Rregullorja e UNMIK-ut 1999/10 mbi anulimin e legjislaturës diskriminuese që ka të bëjë me çështjet banesore dhe të drejtën e pronësisë (13 tetor 1999);

- Rregullorja e UNMIK-ut 2000/38 mbi themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë (30 qershor 2000);
- Rregullorja e UNMIK-ut 2000/47 mbi statusin, privilegjet dhe imunitetin e KFOR-it, UNMIK-ut dhe të personelit të tyre (18 gusht 2000);
- Rregullorja e UNMIK-ut 2000/53 mbi Ndërtimet (25 shtator 2000);
- Rregullorja e UNMIK-ut 2000/54 për ndryshimin e Rregullores nr. 1999/1 të UNMIK-ut, të ndryshuar, mbi autorizimet e administratës së përkohshme në Kosovë (27 shtator 2000);⁷
- Rregullorja e UNMIK-ut 2001/9 për Kornizën Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë (15 maj 2001);
- Rregullorja e UNMIK-ut 2001/17 për regjistrimin e kontratave të shitblerjes së patundshmërive në disa prej zonave gjeografike në Kosovë (22 gusht 2001).

iv. Ligji i zbatueshëm vendës

Ekzistojnë një sërë faktorësh substancial të cilët ndërhyjnë në realizimin e plotë të të drejtave pronëso-re. Ktu hyjnë: tensionet e vazhdueshme etnike, mangësitë e tanishme dhe ekonomia e pazhvilluar a cila gjindet në transformim asajë të kontrolluar në ekonomi të tregut dhe gjithashtu, pasojat e ligjeve dhe politikave të mëparshme diskriminuese. Megjithatë nëse gjithë kësaj i shtohet edhe fakti se kemi edhe paqartësi të mëdha në kuadër të ligjeve ekzistuese, dhe fakti se ligjet e zbatueshme të cilat janë pruar në fuqi para vitit 1989 janë krijuar në bazë të nevojave dhe interesave të cilat buronin nga ekonomia e kontrolluar, çdokush mund të përfundoj se nevojitet të bëhet një reformë e tërsishme ligjore në këtë drejtim.

Në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/59, për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/24, ligji vendës në fuqi më 22 mars 1989 në Kosovë është burim sekondar i ligjit gjatë hartimit të Rregullores së UNMIK-ut. Ligji vendës i cili ka qenë në fuqi pas 22 marsit 1989 është i zbatueshëm vetëm në ato raste kur ligji mbështetet në baza të reja dhe nuk është “diskriminues”.

⁶ Prona shoqërore ashtu siç është e definuar edhe me N. III të Preambulës së Kushtetutës së RSFJ-së të vitit 1974. Ky koncept për më tepër është i definuar në Përmbajtjen e Kushtetutës.

⁷ Kjo Rregullore i jep UNMIK-ut pushtet që të administroj pronën shoqërore në Kosovë.

Disa prej ligjeve vendëse të cilat kanë qenë në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989, të cilat janë relevante sa i përket të drejtave pronësore, janë të paraqitura si mëposhtë:

- Ligji mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore (Gazeta Zyrtare të RSFJ-së, Nr.6/80);
- Ligji mbi qarkullimin e pasurisë së paluajtshme (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës, Nr. 45/81, 29/86 dhe 28/88);
- Ligji mbi ekspropriimin (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës, Nr. 37 /71);
- Ligji mbi Tokën Ndërtimore (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës, Nr. 14/80 dhe 42/86);
- Ligji mbi Marrëdhëniet Banesore (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës, Nr. 11/83, 29/86 dhe 42/86);
- Ligji mbi Bashkëpronësinë (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës, Nr. 43/80 dhe 22/87);

Sa i përket kompetencave, jurisdikcionit dhe procedurave, më të rëndësishmet janë ato të paraqitura si mëposhtë:

- Ligji mbi Gjykatat e Rregullta (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës Nr. 21/78);
- Ligji i Procedurës Civile (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së Nr. 4/77, 36/77, 36/80, 69/82, 58/84 dhe 74/87)⁸.

4. Problemet të cilat burojnë nga korniza e tanishme ligjore në Kosovë

i. Hierarkia e ligjeve

Rregullorja e UNMIK-ut 2000/59 shkakton konfuzion. Së pari, Rregullorja thekson se instrumentet subsidiare të Rregulloreve të UNMIK-ut kanë fuqi më të madhe ligjore se sa ligjet vendëse. Megjithatë, pyetja se çka kualifikohet si “instrumente subsidiare” është e hapur për interpretim, për shkak se nuk është e definuar me tekstin e kësaj rregullore⁹. Së dyti, ajo thekson se ligjet të cilat kanë qenë në fuqi para 22 marsit 1989, kanë fuqi më të madhe ligjore ndaj atyre të cilat kanë hyrë në fuqi ndërmjet asaj date dhe datës kur është themeluar UNMIK-u më 12 qershor 1999. A do të thotë kjo se janë të pavlefshme aktet ligjore – për shembull, shitblerjet e patundshmërive – të cilat janë kryer në pajtim me ligjin gjatë periudhës intervenuese? Kjo çështje është e shtjelluar edhe mëposhtë. Së treti, ligjet në fuqi pas 22 marsit 1989, janë të zbatueshme nëse mbulojnë baza të reja ligjore dhe nëse nuk janë diskriminuese.¹⁰ Kjo përsëri ngrit edhe çështje të tjera, siç është çështja e interpretimit (çka janë në të vërtetë këto (‘bazat e reja’). Për më tepër, ne nuk posedojmë me ndonjë informatë se ku tjetër, përveç në enklavat serbe apo tri komunat veriore serbe, nga strukturat e tyre paralele, të aplikohen ligjet të cilat kanë hyrë në fuqi pas 22 marsit 1989. Aktet ligjore të cilat janë aplikuar nga ana e strukturave paralele, në emër të ndonjë autoriteti tjetër përpos të atij të UNMIK-ut, nuk kanë ndonjë vlerë ligjore në territorin e Kosovës.

Më 22 mars 1989, Kuvendi i Serbisë ka suprimuar autonominë të cilën e gëzonte gjër atëherë Krahina Socialiste Autonome e Kosovës. Pas asaj date i tërë legjislacioni i nxjerrur nga Kuvendi i

⁸ Pas vitit 1989 Ligji i Procedurës Civile është ndërruar në disa raste Gazeta Zyrtare e RSFJ-së Nr. 57/89, 20/90, 27/90, 35/91, 27/92, 31/93, 24/94, 12/98, 15/98)

⁹ Sidoçoftë, neni 2 i Rregullores së UNMIK-ut nr.2000/59, thotë se gjykatat mund të kërkojnë nga PSSP-ja, spjegime të ndërlidhura me ekzekutimin e rregulloreve në kuadër të ligjit në fuqi.

¹⁰ Shih supra 6

Serbisë, ishte diskriminues dhe kishte ndikim tek të gjitha grupet etnike në Kosovë. Për shembull, Ligji mbi Ndryshimet dhe Plotësimet mbi Kufizimin e Shitblerjeve të Pasurisë së Paluajtshme (Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë Nr. 22/91) parashihte kufizime gjatë shitblerjes së pronave të paluajtshme ndërmjet të individëve të grupeve të ndryshme etnike, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike.¹¹ Si rezultat i kësaj, shumë ligje të cilat mëtojnë që të promovojnë reforma ekonomike përkritazi me pronën banesore dhe atë jo-banesore nuk janë marrur parasysh fare në bazë të rregullave të UNMIK-ut të cilat kishin pasoja negative. Për shembull Ligji mbi Marrëdhëniet Banesore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë Nr. 50/1992 dhe Nr. 45/95), Ligji mbi Ndërmarrjet (Gazeta Zyrtare e Republikës Federative të Jugosllavisë Nr. 29/96 dhe 29/97), Ligji mbi Shërbimet Publike dhe Regjistrimin e Pasurive të Patundshme (Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë Nr. 83/92-2897 dhe Nr. 53/93-2467).

Për më tepër, nuk ekziston ndonjë organ i pavarur i cili do të interpretonte ligjin dhe në të njëjtën kohë do të bënte përfundim sistematik të të gjitha dispozitave ligjore të cilat konsiderohen të natyrës diskriminuese. Korniza Kushtetuese mbi Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë, nuk i jep shprehimisht kompetencë, Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, për të bërë një përcaktim të tillë dhe dihet se nuk ekziston ndonjë organ tjetër i cili do të bënte një gjë të tillë.¹² Si rezultat i gjithë kësaj është edhe fakti se secili zyrtar i cili ushtron funksion publik është i shtyer që të bëjë interpretimin e tij vetanaka, zakonisht duke përjashtuar zbatimin e cilitdo ligji i cili ka hyrë në fuqi pas 22 marsit 1989 për shkak se konsiderohen si diskriminuese. Në mungesë të një organi gjyqësor i cili do të vendoste për këto çështje, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse e cila do të siguronte që ligji të interpretohet sipas parimeve të shëndosha ligjore, karshi kritereve tjera të cilat në vete përfshijnë edhe përshtatjet politike.

ii. Vlefshmëria e akteve ligjore të cilat janë nxjerrur ndërmjet 22 marsit të vitit 1989 dhe 12 qershorit 1999

E vetmja njohje ligjore shprehimore e cila u jipet akteve të tilla ligjore të cilat janë nxjerrur ndërmjet të 22 marsit 1989 dhe 12 qershorit 1999, mund të gjindet në kuadër të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 mbi Rregullat e Procedurës të DPÇBP-së dhe KKPBP-së e cila thekson se të “gjitha pronat të cilat janë fituar në mënyrë ligjore në kohën e fitimit të tyre mbeten të vlefshme pa marrë parasysh ndryshimet të cilat janë bërë në ligjin e zbatueshëm në Kosovë”.¹³ Korniza Kushtetuese si e tillë rezultoi me pasoja të dëmshme sa i përket qartësisë ligjore të këtyre akteve, veçanërisht të atyre të cilat kanë të bëjnë me aktet ligjore të nxjerrura gjatë të ashtuquajturës periudhë të diskriminimit (22 mars 1989 dhe 12 qershor 1999). OSBE-ja ka vërejtur se të gjitha

¹¹ Sidoqoftë, Ligji mbi Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit mbi Bartjen e Pronësisë të Paluajtshme (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës Nr. 28/88) për ndryshimin e Ligjit mbi Bartjen e Pronësisë të Paluajtshme (Official Gazette SAP Kosovo No. 45/81 and 29/86) gjithashtu ndalon bartjen e pronësisë së paluajtshme ndërmjet të qytetarëve të kombësive të ndryshme nga territori i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës. Ju lutem vini re se ky ligj është pruar në fuqi nga Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës në vitin 1988.

¹² Rregullorja e UNMIK-ut 2001/19 mbi Kornizën Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë nën Kapitullin 9 neni 4 parasheh kompetencat e Dhomës së Posaçme mbi çështjet që kanë të bëjnë me Kornizën Kushtetuese të Gjykatës Supreme:

“9.4.11 Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme do të vendos:

(a) Me kërkesën e kryetarit të Kosovës, çdo anëtar i Kryesisë së Kuvendit, çdo komisioni parlamentar, apo të jo më pak se pesë anëtarëve të Kuvendit, apo qeverisë, se a është ndonjë ligj i cili është miratuar nga ana e Kuvendit jokompatibil me Kornizën Kushtetuese, duke përfshirë këtu edhe instrumentet ndërkombëtare ligjore siç janë të parapara me Kapitullin e tretë të saj mbi të Drejtat e Njeriut;

(b) Në lidhje me ndonjë kontest i cili mund të ekzistoj ndërmjet të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes, apo ndërmjet të ndonjë Institucioni të Vetëqeverisjes dhe ndonjë komisioni parlamentar, një apo më shumë anëtar i Kryesisë së Kuvendit në kuadër të të drejtave dhe detyrimeve të cilat i kanë dhe të cilat i parasheh Korniza Kushtetuese;

(c) Me kërkesë të ndonjë organi apo zyreje të pavarur e cila është e paraqitur në Kapitullin 10 dhe 11, se a cenon vendimet e prura nga Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes pavarësinë dhe përgjegjësitë e atij organi të pavarur përkatës apo zyreje; dhe

(d) Me kërkesë të Zyrës së Pokurorit Publik, ajo vendos se a janë veprimet të cilat bëhen nga ndonjë anëtar i Kuvendit, anëtar i qeverisë së Kosovës apo nga vetë Kryetari veprime të ligjshme dhe si të tilla mbulohen me imunitetin të cilin e gëzojnë ata në bazë të Kornizës Kushtetuese.”

¹³ Neni 2 Paragrafi 1 i Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

aktet ligjore të cilat janë pruar në fuqi gjatë asaj kohe, siç ishin bartjet e pronësisë së pronave të ndryshme dhe procesi i denacionalizimit nuk kanë qenë gjithherë të pranuar. Zyrtarët ndërkombëtar dhe ata vendës shpeshherë refuzojnë që të pranojnë vlefshmërinë e akteve të nxjerrura gjatë asaj kohe, duke i konideruar ato ai të pavlefshme. Marrja e vendimeve të prera në këtë drejtim është e bazuar në ndërtimin e rrejtshëm të ligjit të zbatueshëm i cili rezulton me shkelje të të drejtave pronësore. Për shembull, nëpunësit komunal të kadastrit, kanë refuzuar që të bëjnë regjistrimin e pronave në dosjet e kadastrale të cilat janë të ndërlidhura me vendimet të cilat janë marrë pas marsit 1989. Sektori për të Drejtat e Njeriut pranë OSBE-së ka vërejtur se shpeshherë refuzimi i bërë nga këta zyrtarë është bërë në mënyrë gojore, pa dhënë ndonjë arsyetim ligjor përkitazi me atë refuzim.

5. Disponibiliteti i ligjit të zbatueshëm në Kosovë

Sipas jurisprudencës së KEDNJ-në, ligji duhet të jetë i qasshëm, i qartë dhe i parashikueshëm. Këto tri kriteret duhet të plotësohen në mënyrë që këto ligje të ekzistojnë.¹⁴ OSBE-ja i ka dalur në ndihmë disa herë Departamentit të Drejtësisë duke i shpërndarë Rregulloret e UNMIK-ut dhe duke përpiluar kompilacione dhe përktitime jozyrtare të ligjeve të zbatueshme. Sidoqoftë, shpeshherë institucionet, si ato administrative poashtu edhe ato gjyqësore, shpeshherë edhe nuk posedojnë me dokumentet e ligjeve të ndryshme. OSBE-ja ka intervistuar gjyqtarët e ndryshëm rreth çështjeve konkrete që kanë të bëjnë me ligjin e zbatueshëm (Rregulloret e UNMIK-ut dhe ligjet vendëse) dhe gjithmonë gjatë këtyre rasteve kanë marrur përgjigje të paqarta. Shpeshherë, OSBE-ja ka kërkuar që të jipen arsytimit ligjore për vendimet dhe për zyrtarët shtetëror të cilët nuk kanë qenë në gjendje që të japin baza ligjore autoritative. Kjo është bërë për shkak se ai/ajo zyrtar-e, në të vërtetë, nuk e ka poseduar ligjin të cilit i është referuar kur e ka dhënë përgjigjen e tij/saj. Mungesa më e thjeshtë e kopjes së ligjit rezulton me dështimin për ta zbatuar atë¹⁵.

6. Rekomandimet përkitazi me ligjin e zbatueshëm në Kosovë

- **UNMIK-u duhet të përpiloj një kompilacion ku do të publikohen zyrtarisht të gjitha ligjet që kanë të bëjnë me pronën.**
- **Ligji duhet t'i jipet në dispozicion me kohë gjyqësisë, komunitetit ligjor dhe nëpunësve civil të publikuara në gjuhët zyrtare të cilat i parashohin rregulloret e UNMIK-ut. Kjo është përgjegjësi e Zyrës së Këshilltarit Juridik, Departamentit të Drejtësisë dhe ministrive të institucioneve të vetëqeverisjes së përkohshme.**
- **UNMIK-u, duhet të nxjerr një rregullore mbi hierarkinë e ligjeve të pronës dhe mbi vlefshmërinë e akteve ligjore të nxjerrura ndërmjet marsit të vitit 1989 dhe qershorit 1999.**

III. Drejtorati për Çështje Banesore dhe Pronësore dhe Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore

1. Informatat mbi të kaluarën

DPÇBP-ja dhe KKPBP-ja janë institucione të cilat janë themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut 1999/23 të nëntorit të vitit 1999. Ato kanë mandat që të zgjidhin të gjitha kontestet pronësoro-juridike të cilat janë si rrjedhojë e legjislacionit diskriminues i cili zbatohet në Kosovë që nga viti

¹⁴ Qasshmëria, qartësia dhe parashikueshmëria paraqesin tri konditat kryesore të cilat ligji duhet t'i plotësoj. Këto kondita parashihen edhe me drejtësinë e përshkruar në KEDNJ, më saktësisht në vendimet e paraqitura si në vijim: Silver dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar, A 61 1983 dhe Sunday Times kundër Mbretërisë së Bashkuar, A 30, 1975

¹⁵ Departamenti Administrativ i shërbimeve publike është duke botuar Gazetën Zyrtare të Kosovës e cila përmbanë rregulloret dhe udhëzimet administrative të UNMIK-ut (faqe 4)

1988 e deri në përfundimin e konfliktit të armatosur më qershor 1999. Zhvendosjet masive¹⁶ gjatë dhe pas konfliktit rezultuan me një rritje të shkeljeve të të drejtave pronëso-ro-banesore. DPÇBP-ja ka një mandat të gjerë për të mbledhur të gjitha kërkesë-paditë pronëso-ro-juridike, ekzekutimin e vendimeve të marra nga KKPB-ja dhe kryerjen e regjistrimit të pronave të braktisura me qëllim të plotësimit, në baza të përkohshme, të nevojave për strehim të personave të zhvendosur dhe refugjatëve. Komisioni i Kombeve të Bashkuara për Vendbanimet Njerëzore – Habitat, ofron ndihmë teknike gjatë dhënies së përkrahjes institucioneve përkatëse.

Në tetor 2000, si pasojë e veprimeve të bashkërenditura të cilat vijnë nga rradhët e subjekteve të ndryshme, duke përfshirë edhe OSBE-në,¹⁷ PSSP-ja nxjerri rregulloren nr. 2000/60 mbi kërkesat pronëso-ro dhe banesore, rregullat e procedurës dhe të provave të Drejtorisë për Çështje Pronëso-ro dhe Banësore si dhe të Komisionit për Kërkesa Pronëso-ro dhe Banësore.

Kapitulli 11 neni 1 paragrafi (g) i Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut 2001/9) i jep pavarësi DPÇBP-së dhe KKPB-së në raport me Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë. Korniza i referohet instrumenteve të cilat kanë themeluar DPÇBP-në, dhe të cilat parashohin kompetencat, detyrimet dhe përbërjen e këtyre dy institucioneve.

Derisa u nxjerr Rregullorja e UNMIK-ut 2000/60, as DPÇBP-ja dhe as KKPB-ja nuk kishin procedura formale të cilat i aplikonin, edhe pse kërkesat pronëso-ro-banesore pranoheshin nga zyra e tyre në Prishtinë/Pristina. Për shkak të mungesës së procedurave të tilla KKPB-ja nuk mundi të filloj që t'i shqyrtoj dhe zgjidhë kontestet pronëso-ro-banesore, e as nuk ishte në gjendje që të kryej një regjistrim të shtëpive të paokupuara në mënyrë që t'i mbikëqyrë ato përkohësisht për qëllime humanitare. Para kësaj, Rregullorja e UNMIK-ut 1999/23 kishte hequr një spektër të gjerë të kompetencave të cilat gjykatat e rregullta i posedonin dhe atë të komunave dhe në vend të kësaj ajo i dha pushtet DPÇBP-së dhe as KKPB-së. Së këndejmi, Rregullorja 2000/60 ishte me rëndësi vitale për mbarëvajtjen e procesit të pranimit dhe zgjidhjes së kërkesave pronëso-ro dhe banësore. Përkundër mungesës së kompetencave për këtë, shumë komuna filluan të ndajnë pronat e zbrazëta në bazë të kriterëve të paligjshme dhe një numër i madh i individëve ishin duke u vendosur nëpër ato prona.

Që nga publikimi i raportit të fundit të OSBE-së mbi pronën, Rregullorja e UNMIK-ut 2000/60 ishte pruar në fuqi nga PSSP-ja, përderisa DPÇBP-ja kishte arritur një përparim të duhur në vendosjen e zyreve të saj anëmbanë Kosovës.¹⁸ Sot, DPÇBP-ja ka katër Zyre Regjionale të vendosura në Prishtinë/Pristina, Gjilan/Gnjilane, Mitrovicë/Mitrovica dhe Pejë/Pec, ku gati të gjitha komunat janë trajnuar sa i përket rregullave dhe procedurave të cilat i aplikon DPÇBP-ja përderisa janë mbledhur mëse 7.956 kërkesa pronëso-ro-banesore, 936 prona janë nën administrim të DPÇBP-së dhe gjer më tani janë lëshuar 151 leje për banim. DPÇBP-ja ka ekzekutuar rreth 11 vendime administrative për dëbim, në pajtim me mandatin e në bazë të nenit 12 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60, ndërsa 29 uzurpues janë larguar vullnetarisht. Mekanizmi i paraparë me Rregulloret 1999/23 dhe 2000/60 ka arritur që t'i zgjidhë rreth 401 konteste pronëso-ro-juridike. Kontestet mund të zgjidhen edhe nëpërmjet të ndërmjetësimit, p.sh, kur të dyja palët pajtohen rreth një zgjidhje të propozuar nga DPÇBP-ja, apo ato zgjidhen edhe nëpërmjet të vendimit të formës së prerë të marrë nga KKPB-ja. Prej 401 kontestëve pronëso-ro-juridike, 159 prej tyre janë zgjidhur me ndërmjetësim përderisa KKPB-ja ka lëshuar rreth 239 vendime administrative. Gjer më tani vetëm 11 vendime janë ekzekutuar, ndërsa, dy uzurpues janë larguar vullnetarisht. Staf i

¹⁶ Në bazë të Kornizës për Kthim (2001) të Komitetit të Përbashkët mbi Kthimin e Serbëve të Kosovës, 215,104 persona janë zhvendosur në Mal të Zi dhe Serbi që nga qershori i vitit 1999. Sipas raportit mbi gjetjet e OSBE-së përkritazi me të drejtat e njeriut "Kosovo/Kosova: Si shihet si thuhet Pjesa II" 863,500 njerëz janë zhvendosur si rezultat i konfliktit të armatosur.

¹⁷ Shih Raportin Tematik të OSBE-së, Kriza e Afërt e Pronave në Kosovë (shtator 2000).

¹⁸ Shifrat e paraqitura në këtë seksion janë të 16 dhjetorit 2001. DPÇBP-ja ia ofroi të gjitha këto të dhëna OSBE-së më 18 janar 2002.

DPÇBP-së është i përbërë nga 18 ndërkombëtar dhe 140 punëtor vendës prej të cilëve 23 vijnë nga rradhët e minoriteteve. Më 1 nëntor 2001 u arrit një marrëveshje ndërmjet të RFJ-së, qeverisë së Republikës së Serbisë, Qendrës Koordinuese për Kosovë dhe Metohi dhe Habitatit duke i lejuar DPÇBP-së që të mbledhë kërkesat pronësore banesore edhe në vetë Serbi dhe Mal të Zi. Si rrjedhojë e gjithë kësaj, u hapën zyret e përhershme dhe ato satelite në Serbi, përderisa ende nuk janë gjetur fonde të mjaftueshme për hapjen e tyre në Mal të Zi.

Kërkesat e parashtruara	Kërkesat e zgjedhura	Vendimet e lëshuara nga KKPB-ja	Vendimet e ekzekutuara të KKPB-së
7.956	401	239	11

Pronat e regjistruara	Pronat e daministruara	Pronat e shpërndara	Aplikacionet e pranuar
2.267	936	151	Nuk ka të dhëna.

Përkundër zhvillimeve pozitive të arritura në këtë drejtim, DPÇBP-ja dhe KKPB-ja ballafaqohen me një sërë pengesash në kryerjen së mandatit të tyre. Së pari, fondet e siguruara për funksionimin e këtij institucioni do të skadojnë në mars të vitit 2002. Nëse nuk mbushet zbrastësira financiare me rreth 8 milion dollarë amerikan, atëherë DPÇBP-ja nuk do të jetë në gjendje që të funksionoj në mënyrë të rregullt. Krahas kësaj, fondet janë ndarë për programet e ndryshme në zona të caktuara gjeografike e jo për aktivitetet e përgjithshme të këtij institucioni. Së dyti, DPÇBP-ja dhe KKPB-ja nuk janë duke marrë përkrahje të mjaftueshme nga ana e strukturave tjera të cilat veprojnë në kuadër të UNMIK-ut. Mungesa e përkrahjes ka edhe efekte negative në punën administrative të këtij institucioni. Krahas kësaj, UNMIK-u, nuk kishte potencuar në masë të duhur rëndësinë e mandatit dhe punës së DPÇBP-së në raport me komunat. Për shembull, DPÇBP-ë kishte raportuar për vështirësitë gjatë kërkesës së autorizimit për shfrytëzimin e objekteve nën administrim të UNMIK-ut. Së treti, kemi të bëjmë edhe me mungesën e përkrahjes administrative të dhënë nga Habitatit, në pajtim me dokumentin e marrëveshjes të datës 14 janar 2000, gjë që, instancave të larta udhëheqëse të këtij institucioni u shkaktonte probleme gjatë kryerjes së detyrave të tyre, për shkak se, ato atëherë duhet të merren edhe me çështje, siç janë, çështjet e furnizimit dhe ato të logjistikës. Për më tepër, atyre u mungojnë automjetet, radio operatorët dhe një sërë gjësendesh tjera të nevojshme për punën e këtij institucioni, siç është hapësira e mjaftueshme për punë. Sipas përfaqësuesve të DPÇBP-së, ky institucion nuk do të vazhdojë që t'i procesoj kërkesat e pranuar pronësore-juridike pas muajit marsi të vitit 2002, ndërsa, procesi i zbatimit të kërkesave të mëparshme pritet të përfundojë në korrik 2002. Numri i punëtorëve lokal do të reduktohet për 45 dhe një numri të punëtorëve ndërkombëtar nuk do t'ju vazhdohen kontratat fare. Aktivitetet në terren brenda në Kosovë do të zvogëlohen në minimum. Të gjitha këto rrethana paraqesin pengesa të mëdha në realizimin e qëllimeve të parashtruara nga ky institucion. Për më tepër, nuk është e pranueshme që ky institucion të arrij të mbijetojë disi në bazë të ndarjes jo të vazhdueshme dhe në baza ditore të resurseve.

2. Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore

i. Mandati dhe përbërja

Mandati i KKPB-së është i paraparë me nenin 2 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23. KKPB-ja, e cila është e pavarur nga DPÇBP-ja, ka mandat që të “zgjidh kontestet private jokomerciale që

kanë të bëjnë me pronën banesore, deri atëherë kur Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të vendosë se gjykatat lokale janë në gjendje t'i kryejnë funksionet të cilat i janë besuar Komisionit.” Si përjashtim i juridiksioneve të gjykatave vendëse KKPБ-ja ka kompetencë ekskluzive që të zgjidh atë kategori të kërkesave të cilat janë të parapara me nenin 1.2 të Rregullores 1999/23. Neni 1.2 thotë si në vijim:

Si përjashtim nga juridiksioni i gjykatave lokale, Drejtoria për Çështje Pronësore Banesore do të pranojë dhe do t'i evidencojë kategoritë e kërkesave që kanë të bëjnë me pronën banesore, duke përfshirë këtu edhe pronën e përbashkët:

- a) *Kërkesat e personave fizikë, pronësia, posedimi ose e drejta e pronës për banim e të cilëve është shfuqizuar pas datës 23 mars 1989 në bazë të zbatimit dhe qëllimit të legjislacionit diskriminues;*
- b) *Kërkesat e personave fizikë që kanë bërë transaksione jozyrtare me prona të vërteta banesore në bazë të vullnetit të lirë të palëve pas datës 23 mars 1989;*
- c) *Kërkesat e personave fizikë të cilët kanë qenë pronarë, posedues ose që kanë pasur të drejtën e banimit apo të pronës para datës 24 mars 1999, të cilët tani nuk e gëzojnë atë pasuri si dhe në rastet kur prona nuk është këmbyer vullnetarisht.¹⁹*

KKPБ-ja mund t'ja referojë pjesët e veçanta të kërkesave pronësoro-judike gjyqeve lokale apo organeve administrative si dhe mund të merr masa të përkohshme mbrojtëse. Në bazë të Rregullores, vendimet e formës së prerë të marra nga KKPБ-ja janë të detyrueshme dhe të ekzekutueshme dhe nuk janë subjekt i ndonjë shqyrtimi tjetër gjyqësor dhe administrativ.²⁰

KKPБ-ja është e përbërë nga dy ekspertë ndërkombëtar dhe një kosovar në fushën e ligjeve të pronës dhe marrëdhënieve banesore. Këta ekspertë, të njohur si Komisionerë, janë emëruar nga vetë PSSP-ja për një periudhë kohore fillestare prej një viti. Në bazë të Rregulloreve të UNMIK-ut Nr. 1999/23 dhe 2000/60, KKPБ-ja ka të drejtë që t'i qaset të gjitha dosjeve që kanë të bëjnë me çështjen e cila është subjekt i hetimit të tyre.

ii. Zgjatja e afatit për parashtrimin e kërkesave pronësoro banesore

Më 5 nëntor 2001 PSSP-ja zgjati afatin për dorëzimin e kërkesave pronësoro banesore prej 1 dhjetorit 2001 deri më 1 dhjetor 2002 në pajtim me nenin 3.2 (a) dhe (b) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/60.²¹ Zgjatja e këtij afati është pjesë e marrëveshjes së arritur nga PSSP-ja dhe qeveria e Republikës Federative të Jugosllavisë (RFJ) mbi ofrimin e sigurisë dhe garancave tjera për minoritetin serb në Kosovë.²²

Është e rëndësishme të ceket se përkundër afatit të caktuar nga bashkësia ndërkombëtare mund të ketë parashtrues të mundshëm të kërkesave të cilët nuk do të arrijnë që t'i parashtrojnë kërkesat e

¹⁹ Më tutje në tekst e referuar si kategoria A, B dhe C.

²⁰ Nenin 2.7 i Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 thotë: Vendimet e Komisionit janë të formës së prerë dhe obligative.

²¹ Nenin 3.2 i Rregullores së UNMIK-ut 60 thotë: Kërkesat pronësore dhe banesore në bazë të nenit 1.2 (a), (b) apo (c) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23 duhet të dorëzohen në Drejtorat para 1 dhjetorit 2001. Afati kohor për parashtrimin e kërkesave mund të zgjatet nëpërmjet të kumtesës së lëshuar nga PSSP-ja, i cili mundet:

a. refuzoj të zgjat afatin kohor për parashtrimin e kërkesave të cilat bijnë në kuadër të një kategorie përkatëse apo për qëllimet e parapara me nenin 5.2; dhe;

b. ofroj afate të ndryshme kohore për kategoritë e ndryshme të kërkesave apo për qëllime të parapara me nenin 5.2.

²² Marrëveshja e cila ka për qëllim të siguroj pëlqimin e dhënë nga ana e autoriteteve serbe dhe jugosllave përkitazi me pjesëmarrjen e serbëve në zgjedhjet e përgjithshme të 17 nëntorit 2001.

tyre deri në atë datë. Në asnjë mënyrë një afat i tillë nuk duhet të jetë një derogim *de facto* i të drejtës për pronë të parashtruesve në fjalë e as i të drejtës për proces të drejtë gjatë përcaktimit të të drejtave dhe obligimeve të tyre civile. Sipas kësaj, në bazë të këtyre rrethanave kompetencat për zgjidhjen e kontesteve të pronësisë të parapara me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23 duhet t'i kthehet gjykatave të rregullta pas skadimit të afatit më 1 dhjetor 2002.

iii. Aktivitetet për mbledhjen e kërkesave pronësore banesore

Zyret regjionale të DPÇBP-së kujdesen për mbledhjen e kërkesave pronësoro banesore. Zyret Regjionale veprojnë në cilësinë e organeve të shkallës së parë dhe shqyrtojnë se a bie kërkesa e parashtruar nën jurisdikcionin e KKPB-së. Nëse kërkesa e tillë nuk bie nën jurisdikcionin e tre prej kategorive të kërkesave të cilat janë paraqitura më lartë, atëherë parashtruesi i kërkesës këshillohet që të shkoj dhe parashtror kërkesën e tij pranë organit përkatës nën jurisdikcionin e të cilit bie ajo kërkesë. Refuzimi dhe referimi i kërkesës nuk bëhet me shkrim.

Nëse një kërkesë pronësoro-banesore pranohet në një Zyre Regjionale, njësia ligjore në kuadër të selisë së DPÇBP-së në Prishtinë, ofron një kontroll të instancës së dytë të kërkesave të pranuar dhe nëse kërkesa bie jashtë kompetencave të KKPB-së, ajo njësi do të refuzoj kërkesën e parashtruar duke e informuar palën me shkrim përkritazi me mjetet juridike të mundshme të cilat mund t'i shfrytëzoj ajo. Nëse kërkesa bie në njërin nga tre kategoritë e përshkruara, ajo do të regjistrohet dhe do të përcjellet për shqyrtim të mëtutjeshëm nga ana e KKPB-së. Përkundër këtyre kontrollave, KKPB-ja ende mund të konkludoj se kërkesa nuk plotëson njërin nga këto kategori dhe për këtë arsye vendos që ta refuzoj kërkesan e parashtruar. Mund të vërehet se lërkesat C bien në më shumë se një prej kategorive të përshkruara, rasti më i shpeshtë është kur ajo është një përzierje e kërkesave që biejnë nën kategorinë B dhe atyre nën kategorinë C. Sipas shifrave të ofruara nga DPÇBP-ja, 7.956 kërkesa janë regjistruar që nga 24 janari 2001. Duke e rritur shkallën e zgjidhjeve të kontesteve pronësoro-juridike edhe ashtu të rritura kohëve të fundit (228 raste gjatë tetorit dhe nëntorit 2001), sipas shkallës së tanishme të resurseve, do të nevojiten deri në 46 vjet për t'i zgjidhur të gjitha kontestet pronësore nëse ky komision pranon mëse 63,000 kërkesa pronësoro-banesore për të cilat ai vlerëson se mund të parashtrohen në të ardhmen.

Përfaqësuesit e DPÇBP-së deklaruan kohëve të fundit se nuk ka shumë kërkesa të parashtruara të cilat kanë mbetur të pazgjidhura në Kosovë. Mund të jetë vërtetë se nuk ekzistojnë lista të pritjes të kërkesave të parashtruara, mirëpo nëse DPÇBP-ja nuk është prezent në tërë Kosovën, dhe duke marrë parasysh kufizimet në lirinë e lëvizjes, duhet të bëhen përpjekje sistematike për të mundësuar që çdokush që dëshiron të parashtror kërkesë të ketë mundësi të bëj një gjë të tillë.

iv. Zgjidhja e kërkesave pronësoro-banesore

Departamenti ligjor në kuadër të DPÇBP-së kujdeset për procesimin e kërkesave dhe rishqyrtimin e tyre para KKPB-së. Më 10 dhjetor 2001, KKPB-ja ka mbajur sesionin e saj të dhjetë²³. Gjer më tani, 861 raste janë në shqyrtim e sipër. Siç u përmend edhe në hyrjen e këtij dokumenti, KKPB-ja ka pruar deri në 239 vendime. Një numër i përgjithshëm prej 11 dëbimeve janë ekzekutuar që nga 16 dhjetori 2001. Krahas kësaj, dy okupues lëshuan pronat e okupuara vullnetarisht. DPÇBP-ja është përgjegjëse për ekzekutimin e këtyre vendimeve. Nëse procesi i vendim-marrjes nuk përshpejtohet paksa në sesionet e ardhshme të KKPB-së, atëherë ndikimi i saj i ardhshëm në procesin e kthimit do të jetë minimal (shih si më lartë). 159 kërkesa janë zgjidhur gjer më tani nëpërmjet të ndërmjetësimit, para rishqyrtimit të saj nga KKPB-ja. Duhet të bëhen përpjekje për përmirësimin e efikasitetit të punës së këtyre mekanizmave, ne veçanti, sa i përket shpejtësisë me

²³ KKPB-ja vendos mbi kontestet pronësore dhe rregullat shtesë të procedurës gjatë sesioneve plenare, e cila ndodh në mënyrë periodike. Vendimet mirren me konensus apo me shumicë votash. Shih Kapitullin e III-të të Rregullores 2000/60 për më shumë detaje sa i përket rregullave të procedurës të KKPB-së.

të cilën zgjidhen kërkesat dhe ekzekutohen vendimet. Në këtë drejtim të gjitha resurset e nevojshme, duke përfshirë këtu edhe përkrahjen e plotë të sigurisë e cila duhet tu jipet institucioneve në fjalë nga organet e rendit publik.

Vendimet e KKPB-së nuk janë bërë publike për analiza juridike, e cila përbën një përjashtim nga parimi i bërjes publike të procedurave gjyqësore. Arsyeja primare e cila qëndron pas mungesës së disponibilitetit të vendimeve është nevoja për të mbajtur në fshehtësi identitetin e palëve. Kjo është kështu, për shkak të rrezikut të mundshëm të sigurisë se vendimi mund të bihet në favor të palës fituese. Përderisa, duhet respektuar konfidencialitetin e identitetit të palëve për këtë arsye, atëherë, interpretimi ligjor i fakteve dhe i ligjit nga ana e KKPB-së duhet të bëhet publik.

Ky mekanizëm nuk kërkon që parashtruesi i kërkesës të deklaroj përkatësinë e tij/saj etnike, ashtu që nuk ka ndonjë mënyrë që të sigurohet analiza e përkatësisë etnike e atij personi. Sidoqoftë, ekzistojnë shënime të mjaftueshme statistikore të cilat bëjnë me dije për numrin e kërkesave të parashtruara të cilat bijnë nën secilën prej këtyre kategorive të parapara me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/23. Zyrtarët e DPÇB-së kanë vërejtur se shumica e kërkesave të kategorisë C besohet të jenë parashtruar nga ana e individëve të përkatësisë serbe apo që vijnë nga rradhët e minoriteteve tjera, përderisa kërkesat e kategorisë A më së shumti parashtrohen nga individët e përkatësisë shqiptare. Përqindja e kërkesave të kategorisë A është mjaft e ulët në krahasim me përqindjen e kërkesave të parashtruara të kategorisë C.

Që nga 16 dhjetori 2002	Kategoria A	Kategoria B	Kategoria C	Kategoria B+C	Gjithsejt
Nr. i kërkesave të parashtruara	602	255	7067	32	7.956
% e kërkesave të parashtruara	7.5%	3.2%	88.8%	0.5%	100%

Vlen të shqyrtohet fakti se përse është kështu. Nëse bëjmë një kombinim të skenareve të paraqitura si mëposhtë atëherë ajo do të mund t'ju ilustroj disa prej arsyeve në fjalë.

Raportimet për dëbimet me forcë për shkak të trajtimit diskriminues që iu është bërë shqiptarëve të Kosovës, inter alia, përsa i përket pjesëmarrjes së tyre në politikë, të drejtave të punës, dhe të drejtave banesore ishin bërë publike gjatë viteve të nëntëdhjeta, gjë që ishte edhe burim i konfliktit në Kosovë. Ata të cilët kishin humbur shtëpitë apo banesat e tyre për shkak të masave diskriminuese tani kanë rast që të kërkojnë pronësinë ndaj tyre nëpërmjet të KKPB-së. Përveq nëse numri i kërkesave të kategorisë A rritet në të ardhmen, numër mjaft i vogël i kërkesave mund të rezultojnë me një argumentim se shkalla e diskriminimit të popullatës shqiptare përsa i përket marrjes së të drejtave të tyre banesore gjatë viteve të nëntëdhjeta nuk ishte edhe aq e madhe sa që të meritojnë një mekanizëm të tërë i cili është i dedikuar për t'i mbrojtur ato të drejta.

Për më tepër, numri i mjaft i vogël i kërkesave të kategorisë A mund të jetë si rrjedhojë e faktit se shqiptarët e Kosovës të cilët i kanë humbur të drejtat e tyre banesore gjatë viteve të nëntëdhjeta janë duke i okupuar banesat e të tjerëve që nga intervenimi i NATO-s dhe për këtë arsye nuk ndihen se kanë nevojë që të hyjnë në procese të ndërlikuara ligjore me qëllim të rifitimit të të drejtave të tyre të posedimit. Nëse, siç besohet se një numër i madh i shqiptarëve kanë okupuar shtëpitë apo banesat e serbëve, dhe kur KKPB-ja fillon të merr vendime mbi këto çështje, atëherë pritët se do të rritet dukshëm numri i kërkesave të kategorisë A që do të parashtrohen këtij institucioni.

Gjithashtu, shumë shqiptarë nuk kanë qasje në procesin e privatizimit të banesave të cilat ishin pronë shoqërore, proces ky i cili kishte ndodhur gjatë viteve të nëntëdhjeta. Si rrjedhojë e kësaj, të drejtat e tyre poseduese, siç parashihet me të drejtën për pronësi të plotë, mund të merret se kanë vlerë të mjaftueshme ligjore me qëllim që ta çojnë përpara procesin e tyre të inicuar me parashtrimin e kërkesës. Për më tepër, shumë shqiptar të Kosovës nuk janë në dijeni se mund të parashtrorjnë kërkesë pranë KKPB-së përkitazi me të drejtat e tyre të posedimit, të cilat i kishin humbur gjatë viteve të nëntëdhjeta, duke menduar gabimisht se ky mekanizëm e ka mandatin e kufizuar që të merret vetëm me kërkesat përkitazi me të drejtat e pronësis.

Personat e zhvendosur serb, zakonisht parashtrorjnë kërkesat të cilat biejnë nën kategorinë C. Është tejet herët që të vlerësohen efektet e rikthimit të të drejtave të pronësisë të personave të zhvendosur. Fakti mbetet se përpos nëse kushtet e jetesës në të cilat jetojnë pjesëtarët e pakicave nuk përmirësohen, është rrezik që të kemi shumë parashtrues të kërkesave të cilët do të bëjnë përpjekje për t'i shitur pronat e tyre.

3. Vendosja dhe aktivitetet e DPÇB-së

i. Administrimi i pronave të braktisura dhe skema e ndarjes së tyre. Bartja e kompetencave në komuna.

Neni 1.1 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/23 i jep mandat DPÇBP-së që të bëjë evidencimin e banesave të braktisura private, ato të cilat kanë qenë pronë shtetërore dhe ato në pronësi shoqërore dhe të mbikëqyrë shfrytëzimin apo dhënien me qira të tyre për qëllime humanitare.²⁴ Neni 1 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/60 e definon banesën e braktisur si “*banesë, të cilën pronari apo poseduesi ligjorë dhe anëtarët e familjes së tij/saj kanë pushuar ta përdorin përkohësisht ose përgjithmonë dhe e cila është ose e zbrazët ose e zënë në mënyrë joligjore*”. Neni 12 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/60, parasheh procedurat për administrimin dhe ndarjen e pronave, me qëllim të ndarjes së pronave në përdorim të përkohëshëm për refugjatët dhe personat e zhvendosur.²⁵ Atëherë kur, një pronë të jetë vendosur nën kontrollin dhe administrimin e DPÇBP-

²⁴ Paragrafi 1.1 (b) i nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23 thotë: “Drejtorati do të: bëjë mbikëqyrjen e shfrytëzimit ose qiranë e pronave të tilla të braktisura në baza të përkohshme për qëllime humanitare; të ardhurat nga qiraja e pronës së braktisur private ose shoqërore do të regjistrohen në xhirollogari të veçantë dhe do të ruhen për pronarin e vërtetë nga e cila shumë do të hiqen shpenzimet relevante;”

²⁵ Neni 12.1 i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/60 thotë: “Drejtorati autorizohet që ti administrojë banesat e braktisura me qëllim që të mund t’u përgjigjet nevojave banesore të personave të zhvendosur dhe të refugjatëve.

12.2 Drejtorati mund ta lëshojë një urdhër duke vënë, kështu, banesën nën administrimin e vet në cilëndo prej rethanave të mëposhtme:

- (a) me marrëveshjen e palëve për zgjidhjen e kërkesës;
- (b) me kërkesën e paraqitësit të kërkesës, duke e ndjekur vendimin e Komisionit që vërteton të drejtën pronësore të kërkuesit;
- (c) mbas largimit të banuesit aktual, në rast se kërkuesi nuk mund ta riposedojë pronën në afat prej 14 ditësh nga dita e njoftimit për përmbarimin e largimit nga banesa;
- (ç) kur asnjë kërkesë nuk është paraqitur për pronën, dhe prona është ose e zbrazët ose banuesi aktual i pronës nuk kërkon kurrfarë të drejte pronësie mbi atë pronë ose
- (d) në rast se asnjë kërkesë nuk është paraqitur për pronën, me kërkesën e pronarit ose të bartësit të së drejtës së shfrytëzimit të asaj prone.

12.3 Për sa kohë që prona të jetë nën administrimin e Drejtorisë (më tej “**prona nën administrim**”), të drejtat e posedimit të pronarit ose të bartësit të së drejtës së banimit pezullohen për hir të interesit të përgjithshëm.

12.4 Drejtorati mund të lëshojë leje të përkohshme për të qëndruar në pronë e cila është nën administrimin e saj, varësisht nga kriteret dhe kushtet që ajo i konsideron të arsyeshme. Lejet e përkohshme lëshohen për një afat të kufizuar kohor, mirëpo mund të përtërihen me kërkesë.

12.5 Drejtorati i vendos kriteret për ndarjen e pronave nën administrim përkohësisht mbi baza humanitare.

12.6 Drejtorati mund të lëshojë urdhër për largim nga prona nën administrim gjatë cilësdo kohë [...].

së, ajo (DPÇBP-ja) ka kompetenca të gjera që t'i dëboj okupuesit e paligjshëm të asaj prone dhe t'ja jep atë pronë dikujt i cili kualifikohet si rast humanitar. Kriteret për vlerësimin e nevojave humanitare nuk janë të paraqitura në këtë tekst apo në rregullore, ato paraqiten vetëm në kuadër të dokumenteve interne të DPÇB-së.²⁶ DPÇB-ja, edhe pa ndonjë kontrollë tjetër gjyqësore apo administrative, përpos vlerësimit vetanak të saj, mundet që të bie vendim në lidhje me atë se kush është okupues i paligjshëm dhe kush e meriton lejen humanitare për banim në atë pronë.

Anembanë Kosovës, duke përjashtuar Prizrenin, DPÇBP-ja është e angazhuar në një sërë aktiviteteve sa i përket administrimit të banesave të zbrazëta. DPÇBP-ja gjer më tani ka pranuar mëse 1,279 kërkesa për strehim humanitar. Gjithsejt DPÇBP-ja është duke zhvilluar hetime për mëse 2,138 banesa, prej të cilave 923 sosh administrohen nga DPÇBP-ja. Gjer më tani janë lëshuar vetëm 138 leje të përkohshme të banimit.²⁷ Si rezultat i këtyre aktiviteteve DPÇBP-ja ka ekzekutuar gjithsejt shtatë vendime për dëbim. Këto vendime kanë karakter administrativ dhe dallojnë prej vendimeve të lëshuara nga KKPB-ja. Disa leje u janë lëshuar atyre familjeve të cilat mëparë i kanë okupuar banesat në fjalë. Arsyeja kryesore e cila qëndron prapa një shifre kaq të ulët e cila e përshkon këtë fakt është mungesa e resurseve të cilat i ka në dispozicion DPÇBP-ja. Krahas kësaj procedura për administrimin e banesave të braktisura është e disajnuar që të mbroj drejtat e qytetarëve dhe të mënjanoj çfarëdo lloji të arbitraritetit dhe së këndejmi shpeshherë për një kompletimin e një procedure të tillë nevojitet kohë. Dhe së fundi, organet komunale nuk kanë bashkëpunuar në mënyrë adekuate me këtë institucion me qëllim të realizimit të sukseshëm të skemës për ndarjen e banesave të tilla.

Neni 15 i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/60 autorizon DPÇBP-në që të delegoj pushtetin e saj ekskluziv me qëllim të kryerjes së evidencimit të banesave të braktisura. Për shkak të mungesës së kapacitetit të cilës i bashkangjitet edhe vetëdija përkitazi me nevojën për t'i përfshirë edhe autoritetet vendëse në këtë proces, DPÇBP-ja ka lëshuar një urdhëresë administrative e cila e parasheh delegimin e pushtetit komunave.²⁸ Gjer më tani, në mëse 30 komuna të Kosovës janë mbajtur trajnime për stafin e këtij institucioni të cilëve i është mveshur pushteti për kryerjen e fazës së parë të evidencimit të banesave të braktisura. Pushteti i deleguar i mveshet administratorit komunal pasi të jetë trajnuar stafi i komunës. Raportet e DPÇBP-së tregojnë se shumë pak informata vijnë nga ana e komunave në zyret e DPÇBP, mirëpo edhe nëse këto informata sigurohen ato mbledhen në mënyrë aq të dobët sa që nuk mund të shfrytëzohen fare. Mëposhtë, ne kemi siguruar një përshkrim të aktiviteteve regjionale të DPÇBP-së sa i përket administrimit të pronave të braktisura dhe delegimit të pushtetit komunave.

i.a) Regjioni i Pejës/Pec

Drejtori Regjional i DPÇBP-së erdhi në Pejë/Pec në shkurt 2001, përderisa zyra nuk kishte funksionuar gjer në korrik të vitit 2001. Në fillim, ajo zyre kishte për detyrë që të mbuloj regjionin e Pejës/Pec dhe të pranoj kërkesa pronëso-ro-juridike në Mal të Zi. Në një fazë të mëvonshme, kjo zyre kishte mbuluar regjionin e Prizrenit në vend të Malit të Zi, për shkak të mungesës së marrëveshjes me qeverinë e RFJ-së. Për momentin, DPÇBP-ja ka 130 njësi banesore në kuadër të

²⁶ Politika e brendshme e ndarjes së pronave të DPÇBP-së thotë:

“1. Aplikantët duhet të jenë më së paku të moshës 16 vjeçare.

2. Aplikantët duhet të mos kenë strehim të përhershëm apo të përkohshëm.

3. Aplikantët duhet të kenë mjete të mjaftueshme financiare të cilat do t'ju mundësonin atyre që të zgjedhin problemet e tyre banesore në tregun privat.

4. Aplikantët nuk duhet të kenë refuzuar paraprakisht lejen për strehim të përkohshëm pa dhënë ndonjë shpjegim të përshtatshëm dhe të pranueshëm.

5. Aplikantët duhet të jenë në gjendje që të demonstrojnë se kanë lidhje me zonën lokale duke dhënë garanca se kjo nuk e rrezikon sigurinë e tyre.”

²⁷ Këto shifra janë të datës 16 dhjetor 2001. DPÇBP ia siguroi këto detaje OSBE-së më 18 janar 2002.

²⁸ Urdhëresa Administrative e DPÇBP-së Nr. 2000/1 mbi Ekzekutimin e Skemës për Ndarjen e Banësive në pajtim me nenin 15 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60

regjistrin të banesave të braktisura, prej të cilave 49 sosh gjenden në komunën e Gjakovës/Djakovica, përderisa 9 prej tyre janë nën administrim të DPÇBP-së.

Gjatë vitit 2000, komuna filloi të ekzekutoj politikën vetanake mbi çështjet banesore e cila ishte në kundërshtim me jurisdikcionin ekskluziv të DPÇBP-së. Këto aktivitete rezultuan me ndarjen e pronës private banesore duke u bazuar në kriteret të cilat nuk janë në pajtim me standardet për të drejtat e njeriut apo rregulloret e UNMIK-ut, për shembull, duke iu lejuar të ashtuquajturve heronjë të luftës apo familjeve të dëshmorëve t'i okupojnë pronat e tilla. Ky nuk ka qenë i vetmi rast i cili ka ndodhur në Kosovë.²⁹ DPÇBP-ja kishte dërguar ekipin mobil në Gjakovë/Djakovica me qëllim që të filloj t'i administroj pronat në fjalë dhe të sforcoj pushtetin e deleguar komunave. Së pari, shumica e njërive banesore të cilat gjenden në regjistrin e këtij institucioni janë ndërtuar mëparë në kuadër të kompleksit të quajtur Programi Yu³⁰ gjë që shtyn edhe mëtej procesin e administrimit të pronave për shkak të kompleksitetit që kanë të bëjnë me çështjet e pronësisë.³¹ Sidoçoftë, për tu vendosur prona nën administrimin e DPÇBP-së, vetëm nevojitet që kjo e fundit, duhet të jetë e kënaqur se shfrytëzuesi nuk është i ligjshëm apo se prona është e braktisur³¹ Së dyti, komuna, e cila e ushtron pushtetin i cili i është deleguar (shih mëposhtë) ka dorëzuar mëse 23 kërkesa për leje të përkohshme humanitare. Shënimet e përmbajtura në këto kërkesa ishin të pasakta apo jo komplete. Sipas Drejtorit Regjional të DPÇBP-së, nëpunësit civil të komunës së Gjakovës/Djakovica nuk përfillin mandatin dhe aktivitetet të cilat i kryen DPÇBP-ja.

i.b) Regjioni i Prishtinës

Në komunën e Prishtinës, DPÇBP-ja ka katër projekte të cilat janë në zhvillim e sipër, të ashtuquajtura blloqet e Programit Yu, banesat e Universitetit, dhe dy blloqe në Dardani³² dhe dhjetë banesa tjera të cilat janë të izoluar. Në komunat tjera të regjionit i vetmi projekt i madh i cili është kryer, është ai në Obiliq/Obilic (shih mëposhtë). Kohëve të fundit, është lansuar një projekt i ri në Lipjan/Lipljane dhe Fushë Kosovë/Kosovo Polje, i cili nën shënjestër të aktiviteteve të tij ka vendosur blloqet e banesave të cilat banojnë nga persona të cilët i takojnë grupeve të ndryshme etnike. Në Fushë Kosovë/Kosovo Polje, OSBE-ja ka identifikuar një lloj të keqtrajtimit të banorëve të këtij kompleksi të banesave, që në të vërtetë, paraqet okupim të paligjshëm të banesave të personave të zhvendosur. DPÇBP-ja administroj edhe banesat tjera të cilat janë të shpërndara anembanë regjionit.

Obiliq/Obilic është rasti i parë më i madh i administrimit të një numri më të madh të banesave dhe është e vlefshme që të japim një pasqyrë në lidhje me atë se si u zhvillua ky program i administrimit. DPÇBP-ja lansoj një operacion të administrimit të pronave të braktisura në Obiliq/Obilic gjatë marsit të vitit 2001. Ky operacion përfshinte administrimin e dy blloqeve të banesave në qendër të qytetit e cila banohej nga persona të përkatësisë së ndryshme etnike. Disa prej tyre ishin pronar të atyre banesave, disa prej tyre ishin bartës të së drejtës për banim,

²⁹ Për shembull në Ferizaj/Uroševac apo Prizren/Prizren

³⁰ Programi për implementimin e paqës, lirisë, barabartësisë, demokracisë dhe prosperitetit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, e njohur ndryshe edhe si Programi YU, ishte miratuar edhe nga Kuvendi i Republikës Socialiste të Serbisë me qëllim që të parandaloj ngritjen e nacionalizmit shqiptar dhe t'i bind pjesëtarët e grupeve tjera etnike që të mos e lëshojnë Kosovën. Programi YU e cila prekte të gjithë sektorët e shoqërisë në Kosovë mirëpo e cila kishte pasojat të posaçme sa i përket të drejtave pronësore, për shkak se inkorporonin dispozita diskriminuese në kuadër të legjisllacionit vetjak.

³¹ Ligji mbi blerjen e banesave për kuadrin profesional dhe kthimin e personave të zhvendosur në Krahinën Socialiste Autonome të Kosovës dhe Metohisë (Gazeta Zyrtare e RFJ-së 24/94). Ky ligj rregullon ndarjen e banesave të cilat janë ndërtuar me fondin e Programit Yu. Në nenin 10 të këtij ligji thuhet se vetëm serbët, malazetët dhe disa kategori përkatëse të personave të cilët i takojnë kuadrin profesional kanë të drejtë që t'i posedojnë banesat të cilat janë ndërtuar në bazë të Programit Yu. Mirëpo në nenin 17 të këtij ligji thuhet se "banesat do të jepen me qira për një periudhë të pakufizuar kohore dhe askush nuk mund të fitoj të drejtën e pronësisë mbi to, e as që mund ta shkëmbej me tjetër, përpos nëse qiramarrësi ka jetuar dhe punuar në Kosovë dhe Metohi për më së paku dhjetë vite nga dita kur banesa e tillë i është ndarë." Pas konfliktit të armatosur, këto banesa janë shitur edhepse nuk i plotësojnë konditat e parapara me ligj. OSBE-ja nuk posedon me ndonjë shifër të saktë përkitazi me numrin e shitjeve joformale të banesave të cilat janë kryer gjer më tani.

³² Distrikti i banesave në Prishtinë/Prishtina.

përderisa disa të tjerë ishin okupues të paligjshëm të këtyre banesave. Gjendja e sigurisë së serbëve të Kosovës u keqësua edhe mëtej për shkak të rritjes së numrit të shitblerjeve të pronave banesore serbe, rritjes së numrit të okupimeve të paligjshme, dhe dëbimeve të paligjshme (banesat okupoheshin nga të ardhurit apo konsideroheshin se ishin të zbrazëta edhe nëse okupuesit e tyre i lëshonin ato banesa madje edhe për vetëm disa orë). OSBE-ja është duke e përcjellur për së afërmi tërë procesin dhe është duke i regjistruar të gjitha ndërrimet të cilat bëhen në marrëdhëniet qiramarrëse dhe ndan me KFOR-in të njëjta brenga sa i përket gjendjes së sigurisë së serbëve të Kosovës. Në një mbledhje të mbajtur ku merrnin pjesë agjenci të ndryshme, për herë të parë ishte thirrur edhe vetë DPÇBP-ja për të adresuar probleme të ndryshme të cilat shtjelloheshin në atë mbledhje.

Gjithashtu u arrit edhe një kompromis ndërmjet të policisë së UNMIK-ut³³, KFOR-it dhe vetë DPÇBP-së. KFOR-i dhe policia e UNMIK-ut u pajtuan që të kontrollojnë hyrjet e këtyre ndërtesave në mënyrë që të përmirësojnë situatën e sigurisë dhe lirinë e lëvizjes të serbëve të Kosovës dhe të parandalojnë dukuritë e uzurpimeve të paligjshme, respektivisht dëbimeve. Në të njëjtën kohë, DPÇBP-ja do të kryej një regjistrim të të gjitha banesave të braktisura. Të gjitha palët u pajtuan se një operacion i tillë duhet të zgjas 45 ditë. DPÇBP-ja filloi të vendos postera nëpër dyert e këtyre banesave. Teksti në këta posterë theksonte se këto banesa për momentin ishin të vendosura nën administrimin e DPÇBP-së dhe dhe me këtë u bënte thirrje okupuesve të tyre që të vijnë në zyrat e këtij institucioni dhe të prezantojnë dëshmi apo arsye të cilat tregojnë të drejtën poseduese të tyre. Për këtë qëllim, DPÇBP-ja hapi një zyrë të përkohshme në stacionin e policisë së UNMIK-ut përderisa KFOR-i ofronte përcjellje të sigurisë për të gjithë jo-shqiptarët të cilët dëshironin që të vërtetonin të drejtat e tyre të posedimit/pronësisë. Atyre individëve apo familjeve të cilët nuk ishin në gjendje të prezentonin dëshmitë për vërtetimin e të drejtës poseduese/pronësisë u jipte edhe rasti për të aplikuar për leje të përkohshme humanitare. Ata të cilët nuk prezentonin dëshmi mbi titullarin e ligjshëm të pronës dhe të cilët nuk kualifikoheshin për leje humanitare, mëpastaj do të dëboheshin. Me qëllim të mënjanimin të numrit të madh të dëbimeve, përfaqësuesit e DPÇBP-së përmendën faktin se do t'i ndihmojnë atyre individëve apo familjeve të cilët dëshirojnë të paguajnë qira pronarit të ligjshëm apo bartësit të së drejtës për banim të asaj banese. OSBE-së i mungojnë informatat e sakta mbi atë se si DPÇBP-ja do të realizoj këtë skemë mirëpo, çka me të vërtetë dihet në këtë drejtim është se kjo siguri bie në kuadër të mandatit të paraparë me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 1999/23.

Diku kah fundi i majit 2001 DPÇBP-ja raportoi mbi shpalljen e vendimit për mëse 20 dëbime plus për katër vendime për dëbim, ekzekutimi i të cilave pritej të bëhej në fillim të qershorit 2001. Në shtator 2001, OSBE-ja rishqyrtoi statusin e operacioneve të saj në Obiliq/Obilic dhe gjer më tani vetëm dy banesa janë ndarë për qëllime humanitare. DPÇBP-ja ka vendosur deri në 12 prona nën administrim të saj përderisa shtatë prej tyre presin urdhërin për dëbim. Krahas kësaj ekzistojnë 98 banesa tjera të cilat janë në proces të futjes së tyre në regjistrin e DPÇBP-së ku së pari duhet të shqyrtohet se a i plotësojnë kriteret në mënyrë që të bijnë nën jurisdikcionin e DPÇBP-së.

i.c) Regjioni i Mitrovicës

Në regjionin e Mitrovicës/Mitrovica, zyra regjionale e saj, është duke bërë regjistrimin e mëse 273 njësisive banesore edhe pse operacionet e saj janë të kufizuara vetëm në Mitrovicë/Mitrovica, Skenderaj/Srbica dhe Vushtrri/Vucitrin. DPÇBP-ja për këtë arsye ka vendosur 173 njësi banesore nën administrimin e saj dhe ka dhënë 55 leje për banim. Drejtori i kësaj zyre kishte shpjeguar arsyet për këtë shifër kaq të ulët, duke thënë se për gati tërë vitin 2001, zyra regjionale kishte poseduar vetëm një automjet me të cilin mbulonte tërë regjionin në fjalë. Zyra regjionale ka dy

³³ Policia e UNMIK-ut përbëhet nga oficer ndërkombëtar të policisë të cilët punojnë në Kosovë në kuadër të departamentit të Kombeve të Bashkuara për Operacione Paqëruajtëse (DPKO).

punëtor ndërkombëtar dhe dhjetë punëtor vendës të cilët janë punësuar nga ana e popullatës e cila jeton në tre komunat veriore të Kosovës, siç janë, Leposaviqi/Leposavic, Zubin Potoku dhe Zveçani/Zvečan.

Drejtori mendon se pa përkrahje adekuate logjistike dhe administrative si nga selia e Habitat-it në Najrobi e ashtu edhe nga UNMIK-u, është shumë vështirë që ky institucion të funksionoj në mënyrë adekuate. Krahas kësaj, OSBE-së i është raportuar se Agjencioni European për Rindërtim³⁴ ka vendosur që të zgjas përkrahjen e tij financiare për këtë zyre deri në mars të vitit 2002. Zyra në Mitrovicë/Mitrovica është thuar se më e rëndësishmja për shkak të vendit strategjik të cilin e ka dhe suksesit relativ të cilin e ka arritur. Është vërtetuar se OSBE-ja është tejet e shqetësuar përkitazi me faktin se DPÇBP-ja do të mbetet thuar se pa financim. Së fundi, Drejtori mendon se shumica e uzurpuesve të paligjshëm të banesave të cilat gjenden në pjesën veriore të qytetit janë serb shtëpitë e të cilëve janë të shkatërruara. Si rrejdhojë e gjithë kësaj, ata nuk mund të kthehen nëpër shtëpitë e tyre në mënyrë që t'i rindërtojnë ato dhe mu për këtë arsye do të jetë shumë e vështirë për DPÇBP-në që të ekzekutoj çfarëdo dëbimi. Përkundër argumentimeve të Drejtorit të Zyrës se uzurpuesit e paligjshëm të cilët kanë mjete financiare për të paguar qira duhet ta paguajnë atë apo të ballafaqohen me dëbim. Vlerësimi i nevojave në këtë rast duhet të bëhet për secilin rast përkatës.

i.d) Regjioni i Gjilanit/Gnjilane

Zyra regjionale në Gjilan/Gnjilane është themeluar në nëntor të vitit 2000, shumë shpejt pas nxjerrjes së Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/60. Në komunën e Gjilanit/Gnjilane, zyra regjionale i administron mëse 110 banesa, 474 prej tyre janë në proces të evidentimit në kuadër të DPÇBP-së dhe janë lëshuar 28leje për banim gjer më tani. Zyra regjionale ka marrë për sipër edhe lejet e përkohshme për banim të cilat autoritetet paralele komunale i kishin lëshuar para hapjes së kësaj zyre. DPÇBP-ja ka vlerësuar nevojat e uzurpuesve dhe ka zgjatur dhjetë leje për banim dhe i ka anuluar dy. Për këtë arsye DPÇBP-ja ka ekzekutuar dhjetë urdhëra për dëbim dhe Drejtori i kësaj zyre pret se do të ekzekutohen edhe njëzet prej tyre në të ardhmen. Këta numra i përgjigjen dëbimeve administrative të cilat janë kryer nga ana e DPÇBP-së dhe jo kontesteve të cilat shqyrtohen nga ana e KKPB-së.

DPÇBP-ja gjithashtu ka filluar me implementimin e skemës për ndarjen e banesave në Viti/Vitina, komunë kjo e cila gjendet në afërsi me kufirin me IRJM-në ku jetojnë përaafërsisht 3,000 serbë, 50 kroat dhe 90 rom. Kjo përbërje etnike e bën këtë komunë si një vend me tensione etnike ku kontestet pronësore janë të zakonshme dhe në mungesë të institucioneve të krijuara për këtë shkak, palët shpeshherë i kthehen dhunës si opcion për zgjidhjen e kontesteve. Zyra regjionale e DPÇBP-së ka filluar me veprimin e saj në këtë komunë mirëpo nuk ka arritur të shpërndaj informacione të sakta në lidhje me numrin e pronave të cilat janë nën administrim të saj. Siç raportohet, as UNMIK-u nuk posedon informacione në lidhje me këto shifra dhe si duket këto dy institucione nuk kishin shkëmbyer informata në lidhje me këtë çështje. E njëjta vlen edhe për listën e kërkesave pronëso- juridike të pronave të cilat janë nën hetim e sipër nga DPÇBP-ja dhe pronat e ndara dhe procesi i shpërndarjes së tyre.

Në Letnicë,³⁵ DPÇBP-ja është duke kryer një regjistrim të banesave të braktisura. Shumica e popullatës së kësaj ane ka ikur për në Kroaci gjatë dy valëve të migrimit të saj, njëra e prej tyre ndodhi gjatë muajit korrik dhe tetor 1992 dhe tjetra gjatë gushtit 1999. Në mars 2001, një

³⁴ AER kishte siguruar fondet për Zyrën e Mitrovicës për dy vite me radhë.

³⁵ Letnica është një fshat cili ndodhet në komunën e Vitisë e cila është e banuar kryesisht nga ana e kroatëve të cilët janë të konfesionit katolik. DPÇBP-ja i konsideron shtëpitë e zbrazëta të këtij fshati si shtëpi të braktisura. Krahas kësaj Letnica është seli e njëres prej vendeve kryesore të shenja katolike të këtij regjioni.

komision i formuar nga ana e banorëve të mbetur të kësaj ane, informoi DPÇBP-në se numri i shtëpive të zbrazëta në fshat është 130. Uzurpimet paligjshme të shtëpive të zbrazëta janë vërejtur si nga ana e kroatëve të Kosovës ashtu edhe nga OSBE-ja. Shumica e uzurpuesve të paligjshëm ishin shqiptarë të Kosovës të konfesionit katolik të cilët kishin ardhur nga fshatrat fqinje dhe shqiptarë nga Maqedonia të cilët kishin ikur nga konflikti i cili kishte kapluar vendlindjen e tyre. Pas kryerjes së vlerësimeve të nevojshme në shtator 2001, DPÇBP-ja i njoftoj banorët e mbetur të këtyre fshatrave dhe disa prej banorëve të cilët sapo ishin kthyer përkohësisht nga Kroacia se prej 50 deri në 60 shtëpi të zbrazëta janë vendosur nën administrimin e DPÇBP-së. Siç raportohet, arsyeja primare për kthimin e përkohshëm të atyre të cilët kishin ikur gjatë vitit 1999 ishte se ata mund t'i shitnin shtëpitë e tyre me një çmim të drejtë i cili sillte në treg. Përfaqësuesi i DPÇBP-së gjithashtu paralajmëroi se do të ekzekutohen 25 urdhëra për dëbim në këtë fshat.

Dëbimet në shumicën e rasteve do të prekin refugjatët nga Maqedonia dhe uzurpuesit e tjerë të paligjshëm të cilat nuk kanë arritur që të paraqesin dëshmi në mënyrë që të legjitimizojnë qëndrimin e tyre nëpër ato prona. Përkitazi me ekzekutimin e urdhërave për dëbim, DPÇBP-ja zakonisht i njofton edhe agjencitë e tjera relevante (Administratën Civile të KB-së, Policinë e UNMIK-ut, UNHCR-në dhe OSBE-në). Sidoqoftë, gjatë kryerjes së detyrave të tij, Drejtori i zyrës regjionale të DPÇBP-së zakonisht i përmbahet në mënyrë strikte ligjit që ka të bëjë me të drejtat pronësore dhe detyrimet të cilat dalin nga mandati i DPÇBP-së. Për këtë arsye, nuk ka lidhje se a është një person Kosovar apo refugjatë nga IRJM-ja gjatë lëshimit të urdhërit për dëbim nga ana e DPÇBP-së. Kur DPÇBP-ja të ketë informuar UNHCR-në për dëbimet të cilat ajo planifikon t'i ekzekutoj, kjo nuk duhet të ndikoj në UNHCR-në gjatë përpjekjeve të saj për të gjetur strehim alternativ për këta persona. Përfaqësuesit e fshatit e njoftuan OSBE-në për uzurpimet e paligjshme të cilat janë duke u bërë dhe dëmin i cili është duke iu bërë pronave nga ana e shqiptarëve katolik, në përpjekjet e tyre për të marrur sa më shumë prona që është e mundur. Arsyeja për këtë është sipas të gjitha gjasave interesi ekonomik të cilën e paraqet ky vend i shenjtë, për shkak të numrit të madh të pilgrimëve të cilët vijnë në këtë vend dy herë në vit.

Regjioni i Gjilanit/Gnjilane përfshinë në vete edhe pesë komuna të tjera si Shtërpce/Strpce,³⁶ Novoberdë/Novo Brdo, Kamenicë/Kamenica, Ferizaj/Urosevac dhe Kaçanik/Kacanik. Në Shtërpce/Strpce, DPÇBP-ja ka dy punëtor të përhershëm të cilët pranojnë kërkesat pronësorobanesore. Ende nuk është bërë ndonjë ndarje e banesave të zbrazëta apo ende nuk është bërë bartja e kompetencave në komunën e Shtërpces/Strpce. Në Kamenicë/Kamenica, DPÇBP-ja ka trajnuar disa prej nëpunësve të komunës duke e bartur në komunë një pjesë të kompetencave. Mirëpo, gjer më tani nuk kemi qenë dëshmitar të ndonjë procesi të ndarjes së banesave. Zyrtari për Çështje Civile i UNMIK-ut, ka informuar OSBE-në se përkundër faktit se ekipi i përbërë prej shumë departamenteve në kuadër të komunës i është nënshtuar trajnimit nga ana e DPÇBP-së me qëllim të fillimit të regjistrimit të lokaleve, Kryetari i Kuvendit Komunal, nuk i lejoi këtij ekipi që të filloi me aktivitetet e tij. Siç pohohet, ai propozoi që të krijohet një komision në kuadër të Kuvendit Komunal i cili do të filloj të shqyrtoj çështjet pronësore. Nëse një gjë e tillë vërtetohet, një veprim i tillë nga ana e Kryetarit të Kuvendit Komunal mund të cenoj dispozitat e Rregullores 2000/45, për shkak se ky veprim cenon edhe vetë dispozitat e Rregulloreve 1999/23 dhe 2000/60. Në anën tjetër, duket se edhe vetë DPÇBP-ja nuk e ka vizituar këtë komunë rregullisht gjatë periudhës në cilën kemi duke raportuar.

Regjioni	Nr. i njësive banesore të cilat gjenden në regjistër	Nr. i njësive banesore të cilat gjenden nën administrim të	Nr. i Lejeve humanitare për banim	Nr. i Aplikacioneve për leje humanitare për

³⁶ Strpce/Shtërpce është një komunë e cila ndodhet në jug të Kosovës ku serbët e Kosovës janë shumicë.

		DPÇBP-së		banim
Pejë/Pec	278	229	3	205
Prishtinë/Pristina	890	195	54	1351
Mitrovicë/ Mitrovice	271	173	55	355
Gjilan/Gnjilane	828	339	39	Nuk ka të dhëna
Prizren/Prizren	0	0	0	Nuk ka të dhëna
Gjithsejt Kosovë:	2.267	936	151	Nuk ka të dhëna
	Dëbimet Administrative (DPÇBP-ja)		Dëbimet kvazi-gjyqësore (KKPB-ja)	
Regjioni	Të cilat presin ekzekutimin	Të Ekzekutuara	Të cilat presin ekzekutimin	Të Ekzekutuara
Pejë/Pec	0	0	0	0
Prishtinë/Pristine	17	4	62	11
Mitrovicë/ Mitrovice	5	3	0	0
Gjilan/Gnjilane	7	4	0	0
Prizren/Prizren	0	0	0	0
Gjithsejt Kosovë	30	11	6	11

ii. Mungesa e DPÇBP-së në regjionin e Prizrenit

I vetmi regjion në Kosovë së cilës ende i mungon prezenca e përhershme e këtij institucioni – për shkak të mungesës së fondeve – është Prizreni. Zyra regjionale e Pejës/Pec për momentin mbulon edhe regjionin e Prizrenit. Në regjionin e Prizrenit, nuk është zhvilluar asnjë aktivitet që ka të bëjë me administrimin e pronës, edhe pse, ishte siguruar mbajtja e një trajnimi mbi mandatin e DPÇBP-së dhe autoritetit të saj. Në pranverë të vitit 2002, do të organizohet një trajnim i ri për nëpunësit civil komunal me ndihmën e OSBE-së. Trajnimi do t'i kushtohet nëpunësve civil të cilët punojnë në kuadër të departamenteve me rëndësi sa i përket çështjeve banesore dhe pronësore. Qëllimi i këtij trajnimi është që të siguroj se komunat janë duke e shfrytëzuar pushtetin i cili ju është dhënë (shih mëposhtë). Si rezultat të kësaj kemi qasje tejet të kufizuar ndaj mekanizmave ligjor të themeluar për mbrojtjen e të drejtave pronësore në provincë, përkundër faktit se zyret e DPÇBP-së mund të mbledhin kërkesat pronëso-ro-juridike për pronat, pa marrë parasysh se ku gjenden ato në Kosovë.

Regjioni i Prizrenit ka pesë komuna, disa prtej të cilave janë rëndë të shkatërruara gjatë konfliktit të armatosur. Në qytetin e Prizrenit, strukturat e mëparshme paralele komunale kishin regjistruar një numër prej 2,100 okupimeve të paligjshme dhe kishin dhënë leje për banim në bazë të

kritereve për të cilat dyshohet se janë kompatible me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Ekziston një numër i madh i pjesëtarëve të minoriteteve të cilët nuk kanë qasje në shërbimet e DPÇBP-së, edhe pse kjo deri në një masë ishte kompenzuar me mjete juridike nga përpjekjet e DPÇBP-së, OSBE-së dhe Këshillit Norvegjez për Refugjatë.

Hapja e zyrës së DPÇBP-së në regjionin e Prizrenit mbetet nevojë urgjente. Prezenca e këtij institucioni i cili i dedikohet çështjeve pronësore dhe atyre banesore do të përmirësojë kompatibilitetin e punës së administratës komunale me standarte e të drejtave pronësore.

iii. Shqetësimet përkitazi me administrimin dhe ndarjen e pronave të braktisura

DPÇBP-ja është e autorizuar që të administroj pronën e braktisur dhe t'ua ndaj atë personave të zhvendosur dhe refugjatëve të cilët kanë nevojë për strehim.³⁷ Rregullorja e UNMIK-ut 2000/60 parasheh definicionin e pronës së braktisur e cila ndryshon në masë të madhe nga ajo e cila parashihet me ligjin e zbatueshëm vendës. Definicioni i pronës së braktisur i cili parashihet me këtë Rregullore është i kufizuar për nga spektri të cilën e mbulon kjo Rregullore dhe për këtë arsye kuptimi i pronës së braktisur dhe, siç është i paraparë me ligjin e zbatueshëm vendës, është ende i vlefshëm për sa i përket llojeve të tjera të pronave, siç janë, prona bujqësore dhe ajo komerciale. Dallimi ndërmjet të këtyre dy definicioneve qëndron në shprehjen e vullnetit të lirë të pronarit për ta braktisur pronën e tij. Ligji mbi Marrëdhëniet Juridike Pronësore³⁸ parasheh se “një pronë do të konsiderohet si e braktisur kur pronari i saj në mënyrë ta pakontestueshme shpreh dëshirën e tij/saj se ai/ajo nuk dëshiron ta mbajë më të drejtën e pronësisë.” Përndryshe, në bazë të definicionit të pronës së braktisur i cila parashikohet me rregulloren e UNMIK-ut 2000/60, pronari legjitim i saj nuk ka nevojë të shpreh vullnetin e tij/saj në mënyrë që një pronë të konsiderohet si e braktisur.

Dallimet në definicionin ligjor të pronës së braktisur kanë shkaktuar konfuzion në mesin e nëpunësve civil dhe gjykatave. Ligji i zbatueshëm vendës parasheh përjashtimisht shprehjen e vullnetit të lirë për të braktisur një pronë përdërisa Rregullorja e UNMIK-ut 2000/60 i jep DPÇBP-së pushtet për të vendosur se a është një pronë e braktisur apo ajo. Në raste të caktuara, nëpunësit civil kanë përfituar nga definicioni të cilin e parashikon kjo rregullore dhe e kanë shfrytëzuar atë për të arsyetuar ekspropriimin apo keqpërdorimin e pronës. Të gjitha pronat të cilat lihen nga personat e zhvendosur dhe refugjatët, konsiderohen si të braktisura pa marrë parasysh shprehjen e vullnetit të lirë nga ana e pronarëve të ligjshëm. Një interpretim i tillë rezulton me shkelje të të drejtave pronësore.

Për shembull, DPÇBP-ja në rastet e tilla fillon të administroj atë çka konsiderohet si pronë e braktisur (e zbrazët apo e okupuar në mënyrë të paligjshme), ashtu që pronarët legjitim apo bartësit e së drejtës për banim mund të lihen *de facto* pa ndonjë mjet juridik efektiv për shkak se vendimet e DPÇBP-së nuk i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor.

OSBE-ja është e brengosur përkitazi me mënyrën se si DPÇBP-ja e vlerëson të drejtën e pronësisë/banimit dhe si i vlerëson nevojat banesore të banorëve të atyre banesave të cilat DPÇBP-ja i ka vendosur nën administrim të saj. Në veçanti, ekziston një dozë e madhe e konfuzionit sa i përket të të ashtuquajturit Program Yu.³⁹ Shumë serbë dhe malazez në Kosovë

³⁷ Për qëllime të mandatit të DPÇBP-së, prona e braktisur e nënkupton pronën e zbrazët dhe atë të uzurpuar në mënyrë të paligjshme. Shih neni 1 i Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

³⁸ Neni 46 i Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore (Gazeta Zyrtare 6/80). Përkthimi është siguruar nga Qendra Juridike e Kosovës; Përmbledhja III “Ligjet e aplikueshme mbi patundshmëritë në Kosovë më 22 mars 1989”.

³⁹ OSBE-ja ka shqyrtuar kushtet të cilat parashihen me Programin Yu. Burimi i vetëm ligjor i cili përmendet gati në të gjitha kontratat e banesave të Programit Yu, gjë që është shqyrtuar nga ana e OSBE-së është “Ligji dhe Rregullorja për ndarjen e banesave, ndërtesave dhe huave për të kthyerit në Krahinë Autonome të Kosovës dhe Metohisë”. Ky ligj është ndryshuar disa herë gjatë shtatë viteve të fundit.

janë duke banuar nëpër banesat të cilat u janë ndarë atyre në bazë të procedurave dhe kritereve të cilat i parashihte Programi Yu dhe ligjet në bazë të të cilave ky program implementohej. Disa prej tyre janë madje duke i shitur banesat e tyre shqiptarëve të Kosovës duke krijuar kështu edhe më shumë konfuzion përkitazi me të drejtat e pronësisë ndaj këtyre banesave. Në pajtim me nenin 1.1 c) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/23, DPÇBP-ja duhet të ofroj udhëzime për UNMIK-un, policinë e UNMIK-ut, KFOR-it dhe UNHCR-së, në lidhje me pronësinë dhe skemën e ndarjes së banesave të krijuar nga vetë Programi. Udhëzimet e tilla do të ri-siguronin përfituesit dhe agjencionet ndërkombëtare për vlefshmërinë dhe kufizimet e të drejtave pronësore të shfrytëzuesve të tanishëm të atyre pronave. Kjo gjithashtu do të shërbej edhe si një mesazh i fortë për komunitetin shqiptar se bashkësia ndërkombëtare nuk do t'i vë në rrezik të drejtat pronësore të fituara në mënyrë të ligjshme. E njëjta vlen edhe për komunitetin serb të veriut të Mitrovicës/Mitrovica. Bashkësia ndërkombëtare nuk do t'i lejoj grupet e ashtuquajtura “rojet e urës” apo të tjerët që të pengojnë realizimin e qëllimeve të ligjshme të parashtuara nga zyrtarët e administratës së agjencive përkatëse civile, gjë që në të njëjtën kohë shkakton edhe frustrim tek ta.

Ndjeshmëria e banesave të Programit Yu, në mesin e shqiptarëve të Kosovës është aq e madhe sa që Gjykata Komunale në Prishtinë/Pristina, ka lëshuar dy urdhëra për dëbim të dy serbëve të cilët jetojnë në ndërtesat e Programit Yu, edhe pse mirë dihet se këto banesa janë nën administrimin e DPÇBP-së. Të ashtuquajturat banesat e Programit Yu në Prishtinë/Pristina, konsiderohen si i vetmi vend i sigurtë për serbët në këtë qytet. KFOR-i i siguron këto ndërtesa dhe DPÇBP-ja ka filluar të bëjë evidencimin e këtyre banesave në mënyrë që t'ua ndaj ato personave të zhvendosur dhe refugjatëve. KFOR-i informoi OSBE-në se vetëm minoritetet janë të lejuara që të jetojnë në këto ndërtesa. Një politikë e tillë nga ana e KFOR-it ndikon tek ata njerëz të cilët nuk janë pjesëtarë të minoriteteve, mirëpo të cilët mund të kualifikohen për mërrjen e lejes humanitare për banim dhe gjithashtu edhe tek pronarët apo bartësit e së drejtës për banim, të cilët nuk do të jenë në gjendje të vendosen nëpër ato banesa, t'i lëshojnë ato me qira apo edhe t'i shesin.⁴⁰ Në bazë të jurisprondencës së KEDNJ-së ekziston e drejta për kompenzim kur një individ të jetë privuar nga e drejta e pronës.⁴¹

iv. Shqetësimet përkitazi me bartjen e kompetencave të DPÇBP-së në autoritetet komunale

OSBE-ja ka vërejtur një lloj të konfuzionit, i cili ekziston në nivelin komunal sa i përket kuptimit bartjes së kompetencave të DPÇBP-së në autoritetet komunale, me qëllim të administrimit të banesave të braktisura. Neni 15 i Rregullores së UNMIK-ut 2000/60, parasheh mundësinë e delegimit të një pushteti të tillë shërbimeve përgjegjëse komunale në një apo më shumë komuna të Kosovës. DPÇBP-ja ka lëshuar një urdhëresë me të cilën rregullohet spektri i delegimit të pushtetit në komuna.⁴² Kjo urdhëresë nuk i jep të drejtë komunave që të ndajnë banesat e braktisura apo edhe të kryejnë ndonjë regjistrim të tyre. Marrja e vendimit të prerë për dëbimin e një personi i cili nuk kualifikohet për leje humanitare për banim, mbetet në kompetencë të DPÇBP-së.

Siç raportohet shumë nëpunës civil komunal besojnë se janë të punësuar nga vetë DPÇBP-ja. Në rastet kur stafi i komunës kupton se ai nuk mund të ketë pushtet ekzekutiv, ata e ndalin punën e tyre të mbledhjes së kërkesave dhe kryerjes së regjistrimit të banesave. Komunitat tjera nuk kanë shprehur ndonjë vullnet të mirë për t'ju nënshtruar ndonjë trajnimi apo për të marrë pushtetin i cili ju delegohet duke i mohuar raportimet për problemet e mëdha bensoro pronësore të cilat

⁴⁰ Asnjë përfitues i këtij programi nuk mund të shes banesën e tij përdërisa të mos kenë kaluar dhjetë vjet nga dita e okupimit të tij. Shih nenin 17 të Ligjit dhe Rregullores mbi ndarjen e banesave, ndërtesave dhe huave për të kthyerit në Krahinë Autonome të Kosovës dhe Metohisë.

⁴¹ Lithgow kundër. MB A 102 (1986). Shih gjithashtu, Ligji i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut; faqe 532; DJ Harris, M O'Boyle dhe C Warbrick; Butterworths: Londër, Dablin, Edinburg (1995).

⁴² Shih Supra 26

ekzistojnë në kuadër të territorit të cilën e mbulon ajo komunë. Shumicës së komunave në Kosovë iu është deleguar pushteti në fjalë në pajtim me konditat e parapara me Urdhëresën Administrative të DPÇBP-së mirëpo gjer më tani një gjë e tillë nuk ka dhënë rezultate të duhura (prekshme).

Në të njëjtën kohë, ekziston një numër i rasteve të uzurpimit të paligjshëm, ndarjes së paligjshme të banesave dhe rasteve kur autoritetet përkatëse kanë vepruar tej pushtetit të tyre përkitazi me pronën banesore. Për dhembull, Administratori Komunal i UNMIK-ut për komunën e Prizrenit në korrik të vitit 2000 ka nënshkruar ndarjen e 41 banesave për pjesëtarët e TMK-së (Trupave të Mbrojtjes së Kosovës) pas rekomandimit të bërë nga ana e Bordit Administrativ Parazgjedhor.⁴³ Banerat në fjalë janë ndërtuar në bazë të programit Yu të cilat mëpastaj menjëherë ishin okupuar nga ana e pjesëtarëve të TMK-së, dhe familjet e veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe familjet e dëshmorëve. Këto banesa gjenden në të njëjtin kompleks së bashku me banerat të cilat janë në pronësi të ligjshme apo janë të okupuara në mënyrë të ligjshme nga ana e institucioneve dhe individëve tjerë. Disa individë tjerë ishin dëbuar nga aty gjatë së cilës ishin bërë persona të zhvendosur gjatë verës së vitit 1999 dhe siç i është raportuar OSBE-së dhe Administratës Civile të Kombeve të Bashkuara, ata kanë qenë të kërcënuar me qëllim që t'i lëshojnë ato banesa. Një raport më i hershëm paralajmërues i përpiluar nga ana e OSBE-së i është dorëzuar Administratës Civile të Kombeve të Bashkuara dhe Policisë së UNMIK-ut kishte parandaluar dëbimet e mëtutjeshme të paligjshme. Gjithashtu DPÇBP-ja ia dërgoi një letër Administratorit Komunal të UNMIK-ut duke i shpjeguar atij për mungesën e bazave ligjore për vendimin e marrë nga ai për ndarjen e banesave për pjesëtarët e TMK-së. Dhe në fund, Bordi i Drejtorëve të komunës së Prizrenit shpalli vendimin e Bordit Parazgjedhor Administrativ si të pavlefshëm. Me dhjetra lokale komerciale të cilat gjenden në katin e parë të asaj ndërtese janë okupuar në mënyrë të paligjshme që nga viti 1999 dhe gjer më tani autoritetet përkatëse nuk kanë parashtruar padi për mbrojtjen e të drejtave pronësore. Duhet të ceket fakti se komuna e Prizrenit tanimë e gëzon pushtetin i cili është deleguar nga ana e DPÇBP-së.

Komuna e Gjakovës/Djakovice dhe ajo e Deçanit/Decani, kanë ndarë pronat banesore të braktisura për familjet e dëshmorëve dhe ish ushtarët e UÇK-së. DPÇBP-ja ka themeluar një prezencë të veten në Gjakovë/Djakovica, me qëllim që të punoj së bashku me zyrtarët komunal të cilët i janë nënshtruar trajnimit përkatës. Gjer më tani Drejtori i DPÇBP-së për këtë komunë nuk ka qenë në gjendje që të ndaj banesa për çfarëdo lloji të përfituesve të cilët janë zgjedhur nga ana e nëpunësve civil të komunës, për shkak të mungesës së kompatibilitetit të zgjedhjes së tyre më kriterin për pranim të lejes për banim. Komuna e Prishtinës/Pristina ka bërë përpjekje që të fillojë një regjistrim të banesave të braktisura dhe pronave banesore të cilat i kanë takuar mëparë komunës me qëllim të plotësimit të nevojave banesore të rasteve sociale, mirëpo kërcënimet të cilat u janë drejtuar nëpunësve të komunës kanë bërë që ky proces të ndalet tërësisht. Sidoqoftë, DPÇBP-ja edhe ashtu e ndali këtë proces duke deklaruar se komuna nuk ka kompetenca për të ndarë çfarëdo prone banesore.

Kuvendi Komunal i Fushë Kosovës/Kosovo Polje u përpoq që të formoj një komision komunal i cili do të kishte kompetenca të cilat do të tejkalonin kompetencat të cilat i janë dhënë nga ana e DPÇBP-së. OSBE-ja ishte ajo e cila arriti që t'ja tërheq vëmendjen administratorit komunal dhe DPÇBP-së përsa i përket projektit të ndërmarrë nga ana e komunës, të cilët morrën pastaj masa për ta parandaluar implementimin e këtij projekti. Sidoqoftë, në një rast tjetër Kryetari i Kuvendit Komunal e udhëzoi një familje shqiptare të Kosovës që të dejoj një familje tjetër serbe duke qenë të bazuar një vendimin e gjykatat përkitazi me pronësinë. Përsëri, OSBE-ja ia raportoi rastin

⁴³ Në pajtim me të ashtuquajturën "Marrëveshje të 12 dhjetorit" dhe "Rregullores së UNMIK-ut 1999/14 mbi emërimin e Administratorëve Komunal dhe Regjional" dhe "Rregullores së UNMIK-ut 2000/1 mbi miratimin e Strukturave të Përbashkëta të Përkohshme Administrative", Bordet Administrative Komunale janë emëruar me qëllim të kryerjes së funksioneve të përkohshme administrative deri në mbajtjen e zgjedhjeve.

policisë së UNMIK-ut e cila pastaj morri masa për ta parandaluar një dëbim të tillë. Në Ferizaj/Urosevac, komuna filloj të ndaj prona pasi që DPÇBP-ja i kishte deleguar një pjesë të pushtetit të saj komunës në fjalë. Edhe pse këto raste paraqesin rastet më të dukshme, OSBE-ja ka pranuar raporte përsa i përket keqinterpretimeve të rolit të DPÇBP-së dhe pushtetit të deleguar nga ana e saj në komuna.

Nuk është e qartë nëse një delegim i pushtetit në komuna i referohet pushtetit për të kryer regjistrimin dhe për bërjen e vlerësimeve paraprake për banesat e braktisura në bazë të pushtetit i cili i mveshet Drejtoratit sipas nenit 12.2(d), apo i referohet vetëm nenit 12.2 paragrafeve a, b, c, apo e⁴⁴. Sidoqoftë, është mëse e qartë se në bazë të pushtetit të deleguar në komuna, ato nuk kanë pushtet ekzekutiv dhe se ajo çka mund të bëjnë është vetëm që të mbledhin informata. Ato nuk mund të ndajnë prona apo edhe të kryejnë dëbime. Megjithatë, nëpunësit civil komunal besojnë se pasi që atyre tu jetë besuar pushteti nga ana e DPÇBP-së ata kanë të drejtë të hedhin poshtë kompetencat e DPÇBP-së dhe të marrin kompetencat sa i përket kryerjes së dëbimeve dhe ndarjes së pronave. Në gjendjen e tanishme, ashtu se si tani rrjedhin punët, këtë delegim të pushtetit OSBE-ja e percepton më shumë si të metë se si përparësi.

OSBE-ja beson se skema për ndarjen e banesave mund të jetë një mekanizëm i përshtatshëm me qëllim të pruarjes së procedurave të standartizuara për komunat të cilat merren me çështje banesore. Me qëllim që të arrihet një gjë e tillë, është i nevojshëm një kuptim i përgjithshëm mbi atë se çka në të vërtetë nënkupton delegimi i pushtetit. Si duket komunat janë duke dërguar nëpunësit e tyre të trajnuar, që të punojnë në kuadër të departamenteve të cilat nuk kanë lidhje me çështjet pronësore, apo kanë dërguar anëtarët e Kuvendeve të tyre Komonale që t'i nënshtrohen trajnimeve përkatëse. Departamenti i Administratës Lokale të Ministrisë së Shërbimeve Publike, duhet të përfshihet më shumë në procesin i cili kërkon nga administratorët komunal të UNMIK-ut të implementojnë delegimin e pushtetit nga ana e DPÇBP-së. DPÇBP-së duhet të kërkojë që drejtoratet komunale të cilat kanë përgjegjësi ndaj çështjeve pronësore dhe staf i tyre të trajnohet dhe që ai trajnim të konsiderohet si obligativ. Kjo duhet të ndodhë në tërë Kosovën, sidomos tani kur DPÇBP-ja ka katër zyre të hapura në territorin e Kosovës. DPÇBP-ja duhet të zhvillojë një marrëdhënie ndërveprimi me departamentet në fjalë. Departamenti i Administratës Lokale duhet të sigurojë që, nëpërmjet të udhëzimeve administrative, që çështja e delegimit të pushtetit dhe marrëdhënia e departamenteve të komunës me DPÇBP-në të qartësohet dhe formalizohet më tutje. Administratori komunal i UNMIK-ut nuk duhet të jetë vetëm proaktiv në gjetjen e zgjidhjeve për problemet banesore dhe pronësore të cilat mund të lindin në komunat e tyre, por gjithashtu të ushtrojnë pushtetin e tyre në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/45 mbi vetëqeverisjen e komunave në Kosovë.

v. Qasja e minoriteteve dhe grupeve tjera të rrezikuara në Kosovë në DPÇBP-së

Mungesa e resurseve të DPÇBP-së, së pari do të ndikojë në minoritetet. Zyret regjionale zakonisht janë të vendosura nëpër hapësirat urbane të banuara kryesisht me popullatën shqipëtare. Për shembull, serbët dhe romët e Kosovës nuk kanë qasje adekuate në mekanizmat e duhur për të parqitur kërkesat apo kërkuar banim humanitarë, për shkak të shqetësimeve të tyre mbi sigurinë. DPÇBP-ja, duke qenë e vetëdijshme për këtë vështirësi, ka vënë në shërbim zyret satelite dhe ekipet mobile, për t'i vënë në dispozicion shërbimet e tyre për grupet dhe minoritetet e rrezikuara. Sidoqoftë, ekzistojnë arsyet për të besuar se, për shkak të kufizimeve operacionale, ekipet mobile të DPÇBP-së nuk janë të pranishme në mënyrë të mjaftueshme, ndërsa ankuesit potencial mund të gjejnë vetën në vështirësi për t'i parashtruar kërkesat e tyre.

⁴⁴ Shih supra 23.

Në Gjilan/Gnjilane, vizitat e ekipeve mobile të DPÇBP-së janë të rralla dhe zakonisht popullata e kësaj ane nuk është në dijeni paraprakisht në lidhje me vizitat. Arsyet për këtë gjë janë të dyfishta. Së pari, territori i regjionit të Gjilanit/Gnjilane është tejet i madh sa për të pasur vetëm një zyre e cila merret me mbledhjen e kërkesave pronësoro-juridike, administrimit të banesave dhe trajnimin e nëpunësve civil komunal dhe ka vetëm një automjet për të mbuluar atë zonë. Izolimi relativ i DPÇBP-së nga pjesa tjetër e UNMIK-ut, e bën edhe më të vështirë të organizoj bashkëpunimin për të mbuluar të gjitha enklavat. Në anën tjetër, bashkëpunimi i mirë në mes të zyreve regionale të DPÇBP-së në Pejë/Pec, OSBE-së, zyrtarëve të UNMIK-ut për komunitetet vendëse dhe Këshillit Norvegjez për Refugjatë, kanë lehtësuar qasjen e minoriteteve në shërbimet e DPÇBP-së në regjionin e Prizrenit, regjion ky i banuar nga minoritetet etnike (Lugina e Zhupës, Rahoveci/Orahovac dhe Dragashi/Drugas).

Për shumicën e presonave të cilët i përkasin pakicave kombëtare, nuk është e sigurtë për ta që të udhëtojnë nëpër Kosovë me qëllim që të parashtrinë kërkesë. Në Mitrovicë/Mitrovica, zyra e DPÇBP-së ka dy hyrje të veçanta, një për parashtruesit serb të kërkesave të cilët vijnë nga veriu i qytetit, dhe tjetra për shqiptarët e Kosovës dhe parashtruesit e tjerë të cilët vijnë nga jugu i qytetit. KFOR-i francez ofron siguri për të gjithë ata të cilët vijnë nga veriu. Riparimi i një rruge të rrëshqitshme ka përmirësuar në masë qasjen e popullatës serbe e cila jeton në veri të Mitrovicës/Mitrovica në shërbimet të cilat i ofron DPÇBP-ja. Ende raportohet për raste të frikësimit të atyre personave të veriut të qytetit të cilët vijnë në DPÇBP për të parashtruar kërkesë.

vi. Vendosja e DPÇBP-së jashtë Kosovës: Serbi, Mal të Zi dhe Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë (IRJM)

Në bazë të shifrave të publikuara në dokumentin e Kornizës për Kthim (2001), UNHCR-ja ka regjistruar se gjithsej 187,000 persona të zhvendosur që jetojnë në Serbi përdërisa 28, 104 prej tyre jetojnë në Mal të Zi.⁴⁵ Edhe pse zyret e DPÇBP-së pranojnë kërkesat për pronat të cilat gjenden diku në Kosovë, është tejet e vështirë, mos të themi ndoshta edhe e pamundur për personat e zhvendosur që të vijnë në zyret e DPÇBP-së dhe të parashtrinë kërkesë. Gjithashtu edhe kufizimet logjistike dhe mungesa e sigurisë nëpër të cilën kalojnë personat e zhvendosur (gjë që i raportohet në mënyrë të vazhdueshme OSBE-së) ndikon në mënyrë të rëndë në lirinë e lëvizjes së tyre. Kjo i dekurajon personat e zhvendosur që të ushtrojnë të drejtën e tyre për të parashtruar kërkesë pronësoro-juridike për pronën e tyre. Krahas kësaj, personat e zhvendosur dhe refugjatët me siguri se kanë pak njohuri për vetë DPÇBP-në dhe KKPB-në dhe makinerinë e tyre komplekse ligjore.

Marrëveshja për Bashkëpunim e arritur më 5 nëntor 2001 ndërmjet të Republikës Federative të Jugosllavisë dhe UNMIK-ut përfshin në vete edhe një dispozitë themelore mbi të drejtat pronësore, me të cilën UNMIK-u zotohet se do të hap zyret në Serbi deri në fund të vitit 2001 dhe në Mal të Zi në fillim të vitit 2002. Agjencia e cila e sponsoron DPÇBP-në, që është UNCHS-ja apo HABITAT-i gjithashtu ka arritur një marrëveshje me Republikën Federative të Jugosllavisë duke krijuar bazat për hapjen e zyreve në Serbi dhe Mal të Zi. DPÇBP-ja i deklaroi OSBE-së se se ekipet mobile të saj janë tanimë duke vepruar nga Mitrovicë/Mitrovica në Novi Pazar, nga Prishtina/Pristina në Kursumli dhe nga Gjilani/Gnjilane në Vranjë. Para përfundimit të vitit 2001, DPÇBP-ja hapi zyret e saj në edhe në Kraljeve, Nish dhe Beograd. Kjo vendosje e shpejtë e zyreve për mbledhjen e kërkesave pronësoro-banesore jashtë Kosovës, dallohet me një mungesë të fondeve përsa i përket aspekteve të tjera, siç janë, procesimi i kërkesave dhe mbajtja e mbledhjeve të KKPB-së⁴⁶. Përparimi i bërë në Serbi nga DPÇBP-ja është i paraqitur edhe në tabelën si

⁴⁵ Korniza për Kthim 2001-Komiteti i Përbashkët për Kthimin e serbëve të Kosovës.

⁴⁶ DPÇBP, ka deklaruar se mjetet materiale janë transferuar nëpër zyrat jashtë Kosovës dhe nuk është punësuar personeli për të kryer operacionet në Serbi. Për më tepër, DPÇBP, ka deklaruar se personeli ndërkombëtar dhe ai kombëtarë duhet të paguajnë me avanc për objektet në Serbi duke pranuar që më vonë të kompenzohen nga Habitat.

mëposhtë. Shifrat e paraqitura aty i përgjigjen atij numri të kërkesave të mbledhura nga secila zyre e përhershme në Serbi dhe nga ekipet mobile të cilat shkojnë në terren nga zyret e tyre të vendosura në Kosovë.⁴⁷

Regjioni/Zyrja	Gjithsejt	A	B	C
Mitrovicë/Mitrovica Novi Pazar	696	0-	0	696
Prishtinë/Pristina Kursulmja	268	0	0	268
Gjilan/Gnjilane Vranje	114	0	0	114
Beograd	100	0	0	100
Kraljevë	610	0	0	610
Nish	130	0	0	130
Gjithsejt:	1.918	0	0	1.918

Shkupi dhe Podgorica janë të ranguar në pozitën e dytë në listën e prioriteteve për aktivitetet e DPÇBP-së, duke pasur parasysh se numri i të zhvendosurve/refugjatëve është shumë më i vogël në territorin i cili mbulohet nga zyret gjegjëse nëpër këto lokalitete. Diskutimet në mes të DPÇBP-së dhe UNHCR-së zhvillohen drejt gjetjes së mënyrave më të mira të lehtësimit të qasjes së refugjatëve në IRMJ, të cilët të gjithë janë romë, në mekanizmat e DPÇBP/KKPB-së. Këta refugjatë nuk mund të hyjnë në Kosovë për të parashtruar kërkesat pronësore juridike pranë zyrave ekzistuese të DPÇBP-së, për shkak të se rrezikohen të humbin statusin e refugjatit në IRMJ. Zyrat e UNMIK-ut dhe UNHCR-së kanë marrë parasysh dhe kanë përkrahur çështjen e ekipeve mobile për mbledhjen e kërkesave, por deri më tani, nuk është ndërmarrë asnjë hap në këtë drejtim. Zyrarët e DPÇBP-së kanë deklaruar se zyra në Podgoricë do të hapet e fundit.

vii. Bashkëpunimi në fushën juridike dhe gjyqësore në mes të administratave të regjionit: UNMIK-ut, RFJ-së dhe IRMJ.

Që DPÇBP-ja t'i kryej aktivitetet e veta, është mëse i nevojshëm, normalizimi dhe harmonizimi i raporteve në mes të administratave legjitime në kuadër të regjionit. Ky gjykim bazohet në faktin se, DPÇBP/KKPB, mund të merr vendime mbi pasurinë e cila gjindet në Kosovë, që mund të shkaktoj efekte juridiko-civile (të drejta dhe obligime) dhe trashëgimore mbi palët të cilat gjinden nën jurisdikcionin e organeve dhe ligjeve të FRJ-së. Ky problem nuk është i kufizuar vetëm në pronën banesore, por ka të bëjë edhe me të gjitha aktivitetet e kryera në territorin e Kosovës nga ana e institucioneve të përkohshme të vetqeverisjes. Për shembull, duhet marrë vendim përkatës lidhur me pasurinë, pronë e së cilës është armata jugosllave, e cila pohohet se është privatizuar para dhe pas 12 qershorit 1999. UNMIK-u është instaluar me 12 qershor 1999, kështu që e drejta e

⁴⁷ Statistikat sa i përket mbledhjes së kërkesave pronësoro-banesore nga ana e ekipeve mobile të cilat janë dërguar në terren nga zyret e tyre në Kosovë janë të datës 16 dhjetor 2001 të cilat i janë siguruar OSBE-së më 18 janar 2002.

armatës jugosllave të privatizoj pronën pas kësaj date është shumë kontestuese. Sidoçoftë, pronarët ekzistues legjitim apo jolegjitim të këtyre banesave vazhdojnë t'i shesin ato palëve të treta duke bërë kështu problemin edhe më të madh. Memorandumi i mirëkuptimit i nënshkruar në mes të qeverisë së FRJ-së, qeverisë së Republikës së Serbisë dhe qendrës koordinuese për Kosovë dhe Metohi dhe UNCHS – Habitat, në kuadër të objektivave të parapra, parashikon edhe implementimin e bashkëpunimit teknik dhe hapjen e zyrave të DPÇBP-së në tërë territorin e FRJ-së. Prania permanente e DPÇBP-së në Serbi dhe Mal të Zi, mund të stabilizoj mangësinë e barazpeshës në instancën legjislative dhe gjyqësore në mes të dy administrave, të asaj ndërkombëtare dhe jugosllave. Harmonizimi i raporteve në mes këtyre dy strukturave administrative, është i rëndësishëm së madhe për çështjet e kontesteve pronësore juridike, pasi që një numër i madh i regjistrave të pronës dhe dokumenteve tjera relevante, janë bartur në Serbi gjatë kohës së përfundimit të konfliktit të armatosur në qershor të vitit 1999. OSBE-ja mund të luaj një rol të rëndësishëm në lehtësimin e harmonizimit legjislativ.

viii. Dëbimet dhe e drejta në banim adekuat⁴⁸

OSBE-ja gjithashtu brengoset për të drejtat e palës përgjegjëse (uzurpuesin e tanishëm) në strehim, pasi që Rregullorja e UNMIK-ut, nr. 2000/60, nuk parashikon ndonjë kriter për t'u bazuar gjatë vendosjes së shtyerjes apo ekzekutimit të vendimit për dëbim, i cili merret nga KKPb.⁴⁹ Mungesa e kriterit në kuadër të tekstit të Rregullores, i lejon DPÇBP-së një shkallë të gjërë të të drejtës diskrecionale gjatë vendosjes, nëse palës përgjegjëse i nevojitet strehimi apo jo. Kjo paraqet brengosje të posaçme, duke pasur parasysh se vendimet e KKPb-së, janë të formës së prerë, obligative dhe nuk i nënshtrohen rishqyrtimit nga ndonjë organ gjyqësor apo administrativ.⁵⁰

Këto shqetësime lidhur me qartësinë, kanë të bëjnë edhe me të drejtat e uzurpuesit të paligjshëm, atëherë kur DPÇBP-ja bjen vendim administrativ për dëbim, dhe të bazuar në nenin 12 të Rregullores 2000/60. Prap, nuk ka kritere të caktuara në Rregullore të cilat definojnë kuptimin e “nevojave(ës) për strehim” për nevoja të DPÇBP-së. Pasi që, kriteret për vlerësimin e nevojës për strehim nuk janë të definuara me ligj, të dy palët, si ato të cilat janë uzurpues të paligjshëm e gjithashtu pala e cila kërkon lejen në baza humanitare, mund të kontestojnë vendimet e tilla si arbitrare. Për dallim nga vendimet e KKPb-së Rregullorja nuk përjashton shqyrtimin e lëndëve nga një organ i pavarur gjyqësor. Së këndejmi, ligji i zbatueshëm mbi procedurën administrative duhet të zbatohet në këtë rast.

DPÇBP-ja do të ketë shumë shpejt një mekanizëm tejet të madh administrativ me të cilin do të mbuloj një territor mjaft të gjerë dhe një numër mjaft të madh të kërkesave dhe dëbimeve të mundshme. OSBE-ja beson se ekziston nevoja për instrumente më të sakta juridike të karakterit administrativ të cilat mundësojnë rishqyrtimin e vendimeve për dëbim dhe ofrojnë kritere të sakta për atë se çka konsiderohet si standard adekuat i banimit në Kosovë. Gjithashtu është e nevojshme të kemi një proces, në bazë të të cilit, të gjithë personat e prekur nga dëbimi të ri-strehohen diku tjetër. Përndryshe, nëpërmjet të procesit i cili aplikohet për momentin, ata mund të mbeten të pa strehë, apo t'i drejtohen okupimit të paligjshëm të ndonjë prone tjetër. Rrjedhja adekuate e

⁴⁸ PNDESK Komentet e përgjithshme 7. “16. Dëbimet nuk duhet të rezultojnë që individët të përfundojnë në situatë të pa strehë apo në pozitë të rrezikuar për t'ju shkelur të drejtat tjera të njeriut. Atëherë kur personat e prekur nga kjo nuk mund ti realizojnë këto të drejta, shteti palë, duhet të ndërmer masat e duhuara dhe të shfrytëzoj në maksimum resurset që disponon, që të siguroj strehim alternativ adekuat, rivendosje apo qasje në tokë të pleshme nëse disponon me të.”

⁴⁹ Rregullorja e UNMIK-ut 60, neni 13.2 thotë “Drejtorati ia dorëzon shfrytëzuesit aktual që ka pretendime për atë prone një urdhër të lëshuar nga Komisioni për largim nga ajo pronë. Drejtorati, nëse e sheh të arsyeshme, mund ta prolongojë përmbarrimin e urdhërit për largim banesa deri në 6 muaj, deri sa banuesi aktual ta zgjidhë çështjen e banimit, ose në varësi të rrethanave të tjera që Drejtorati i sheh të arsyeshme. Drejtorati e njofton banuesin aktual si dhe kërkuesin për arsyen e prolongimit”.

⁵⁰ Rregullorja e UNMIK-ut 1999/23, neni 2.7 thotë “Vendimet përfundimtare të Komisionit janë obliguese dhe detyruese dhe nuk i nënshtrohen rishqyrtimit të asnjë autoriteti gjyqësor apo administrativ në Kosovë”.

informatave dhe marrëdhëniet e vendosura mirë ndërmjet të organeve të UNMIK-ut të cilat kanë përgjegjësi për të drejtat banesore (DPÇBP-ja, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministria e Shërbimeve Publike) janë mëse të nevojshme për të mënjeluar shkeljet e të drejtës për banim adekuat. Komenti i përgjithshëm nr. 7 duhet që, në dritën e komentit të përgjithshëm nr. 3 të Komisionit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, të jepë indikacione të sakta në lidhje me atë se si autoritetet, të cilat kryejnë funksione shtetërore, duhet të njohin obligimet e tyre në raport me të drejtat e njeriut në fushën e çështjeve banesore.

ix. Përfshirja e organeve të rendit publik në dëbime

Gjatë ekzekutimit të urdhërave për dëbim, është përgjegjësi e organeve të rendit publik, e në veçanti policisë, që të largojnë cilindo person i cili dështon që t'i përmbahet udhëzimeve të oficerit përgjegjës për të lëshuar atë ndërtesë.⁵¹ Përfaqësuesit e DPÇBP-së raportuan për një mungesë të përkrahjes policore gjatë ekzekutimit të urdhërave për dëbim në pranverën e vitit 2001. Një Memorandum i Mirëkuptimit i nënshkruar në shtator të vitit 2001, ndërmjet të DPÇBP-së dhe policisë së UNMIK-ut, arriti që ti zgjidhë këto probleme duke parashtruar para vetes detyrat të cilat duhet ndërmarrur policia gjatë ekzekutimit të urdhërave për dëbim, e të lëshuara nga DPÇBP-ja. Sidoqoftë, mënyra nëpërmjet të së cilës policia e UNMIK-ut jep përkrahje për ekzekutimin e urdhërave për dëbim të lëshuar nga DPÇBP-ja, në një anë, dhe urdhërave të lëshuar nga gjykatat e ndryshme apo komunat, në anën tjetër, nuk janë të harmonizuara. Si gjykatat ashtu edhe komunat mundet të japin urdhëra për dëbim. Për shembull, komuna mund të jep urdhër për dëbim nga një strehimore e përkohshme për komunitetet. Për më tepër, gjykata mund të japë urdhër për dëbim me qëllim të zgjidhjes së një kontesti pronësoro-banesor, nëse një kontest i tillë nuk i takon asnjërës nga tre kategoritë e kërkesave të cilat bijnë nën juridikcionin ekskluziv të KKPB-së. Përderisa të mos harmonizohen procedurat standarde operuese, konfuzionet në lidhje me dëbimet mund të rezultojnë me shkeljen e të drejtave banesore. Memorandumi i Mirëkuptimit (MM) parasheh bazat solide për harmonizimin e procedurave për dëbim edhe pse numri i vogël i ekzekutimit të vendimeve për dëbim nga ana e DPÇBP-së gjer më tani nuk na lejon që të nxjerrim çfarëdo përfundimi përkitazi me efikasitetin e saj.

Udhëzimet e mëtutjeshme të detajuara duhet t'i dërgohen komandantëve të stacioneve të policisë së UNMIK-ut, duke iu shpjeguar atyre për procedurat e DPÇBP-së përkitazi me dëbimin dhe gjithashtu oficerët e policisë së UNMIK-ut duhet t'i nënshtrohen një trajnimit sa i përket vetë procesit të dëbimit.

4. Rekomandimet

Përkitazi me resurset e ndara DPÇBP-së dhe KKPB-së:

- **Duhet t'i jipet një prioritet më i madh nga ana e HABITAT-it dhe UNMIK-ut ndarjes së resurseve për DPÇBP-në dhe KKPB-në. Resurset duhet patjetër të ndahen në mënyrë të qëndrueshme ashtu që institucionet në fjalë të jenë në gjendje të kryejnë mandatin e tyre në mënyrë adekuate. Në bazë të vlerësimeve vetanake të DPÇBP-së, do të nevojiten rreth 8.5 milion dollarë. Që nga nëntori i vitit 2001, DPÇBP-ja ka deklaruar se që nga janari 2001, vetëm 27% e buxhetit të nevojitur është siguruar për vitin 2002.**

⁵¹ Rregullorja e UNMIK-ut 60, neni 13.5 thotë: "Gjatë ekzekutimit të urdhërit për largim nga banesa, çdo person që nuk i bindet udhëzimeve të nëpunësit përgjegjës për ta lëshuar pronën, mund të largohet nga organet e rendit. Në rast se edhe pasuria e tundshme largohet, Drejtorati do të bëjë përpjekje të arsyeshme për ta minimizuar rrezikun e dëmtimit ose të humbjes së kësaj pasurie. Drejtorati nuk mban asnjë përgjegjësi për asnjë dëmtim a humbje të pasurisë së larguar."

- Resurset duhet të administrohen direkt nga DPÇBP-ja. Donatorët duhet të jenë më fleksibil në qasjen e tyre dhe nuk duhet të insistojnë në financimin e programeve përkatëse të përqëndruara në zona të caktuara gjeografike në kuadër të DPÇBP-së me qëllim që të sigurohet një konsistencë në qasjen e tyre.
- UNMIK-u duhet të siguroj që DPÇBP-ja dhe KKPB-ja të funksionojnë në kuadër të kornizës institucionale të UNMIK-ut dhe të shqyrtojë mënyrat për të shtuar bashkëpunimin dhe integrimin e tyre. DPÇBP-ja dhe KKPB-ja nuk mund të kryejnë mandatin e tyre në mënyrë të plotë në qoftëse janë të izoluar nga ana e degëve dhe organeve tjera të UNMIK-ut.

Përkitazi me aktivitetet e KKPB-së:

- KKPB-ja duhet të bëj përpjekje për të shtuar numrin e vendimeve të marra për një mbledhje të saj dhe gjithashtu të rrisë numrin e mbledhjeve. Një shpejtim i tillë në procesin e vendim-marrjes nuk duhet të shkoj në dëm të palëve të atij procesi të mirëfilltë.
- Vendimet e KKPB-së duhet të jenë transparente, publike dhe të disponueshme. Kurdo që konfidencialiteti përkitazi me identitetin e palëve duhet të respektohet, interpretimi ligjor i fakteve dhe i ligjit nga ana e KKPB-së duhet të jenë të disponueshme dhe publike. Komentet mbi jurisprudencën e KKPB-së duhet të jenë të mirëseardhura.
- OSBE-ja konsideron se pranimi i kërkesave duhet t'i nënshtrohet një shkalle të caktuar të arbitraritetit për shkak se DPÇBP-ja nuk mohon juridikcionin mbi një kërkesë në formë të shkruar. Vendimet mbi marrjen e kërkesave duhet t'i lihen punëtorëve të administratës. Kurdo që një parashtrues i kërkesës të jetë refuzuar në shkallën e marrjes së kërkesave, refuzimi i tillë duhet të bëhet me shkrim, i cili jep arsyet, kohën, datën dhe vendin ku ajo kërkesë është refuzuar.

Përkitazi me vendosjen e gjithëmbarshme dhe aktivitetet e DPÇBP-së:

- Zyret e DPÇBP-së të hapura në Serbi dhe Mal të Zi për mbledhjen e kërkesave DPÇBP duhet t'i plotësojnë disa kërkesa të cilat janë të parapara me Marrëveshjen për Bashkëpunim të nënshkruar ndërmjet të UNMIK-ut dhe RFJ-së më 5 nëntor 2001. Resurset duhet të ndahen mëpastaj.
- Sa më shpejtë që është e mundur duhet të hapet një zyre në regjionin e Prizrenit e cila është mëse e nevojshme për normalizimin e të drejtave pronësore dhe banesore në Kosovën jugore.
- Duhet të ndërmerret gjithashtu një fushatë informative mbi aktivitetet e DPÇBP-së dhe dobitë e administrimit dhe ndarjes së banesave për pronarët e ligjshëm dhe bartësit e së drejtës për banim. Një fushatë e tillë duhet të ketë nën shënjestër të vet edhe akterët tjerë vendim-marrës pas përfundimit të procesit zgjedhor. OSBE-ja dhe Administrata Civile e Kombeve të Bashkuara duhet të shiqojnë që të gjejnë mundësi për ofrimin e ndihmës së tyre. DPÇBP-ja duhet të siguroj që informatat përkitazi me administrimin e banesave të braktisura të jenë të disponueshme në kuadër të nivelit komunal.
- Gjithashtu është e nevojshme që të bëhet një analizë e arsyeve të cilat qëndrojnë pas numrit të vogël të kërkesave të cilat i takojnë kategorisë A të kërkesave. Arsyeja primare e cila qëndron pas krijimit të DPÇBP-së dhe KKPB-së është që të kompenzoj dëmin përsa i përket diskriminimit në lidhje me të drejtat pronësore i cili kishte ndodhur gjatë viteve të nëntëdhjeta.

- Një shqyrtim i rregullave dhe procedurave të DPÇBP-së nëpërmjet të miratimit të urdhëresave të mëtutjeshme administrative apo edhe masave tjera praktike duhet të kryhet me qëllim të mbushjes së vakumeve juridike ekzistuese, veçanërisht me qëllim që të mënjanojmë çfarëdo lloj të arbitraritetit në procesin e marrjes së kërkesave dhe mbi kriteret dhe procedurat për ndarjen e banesave të braktisura.
- Dëbimet duhet të kryhen në pajtim me standartet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, në veçanti me nenin 6 dhe 8 të KEDNJ-së, dhe nenin 11 të MNDESK-së.
- Policia e UNMIK-ut duhet të siguroj që të gjitha stacionet policore të saj janë të vetëdijshme dhe të jenë në gjendje të implementojnë marrëveshjen e arritur me DPÇBP-në përkritazi me dëbimet dhe mandatin e gjykatave të rregullta mbi atë çështje.
- Duhet të rregullohet patjetër një procedurë e unifikuar për vendimet e marra mbi dëbimet të cilat biejnë në kuadër të mandatit të gjykatave të rregullta dhe DPÇBP-së/KKPB-së.

Përkritazi me delegimin e pushtetit të DPÇBP-së autoriteteve komunale:

- Të gjitha departamentet dhe ministritë përkatëse të nivelit qendror (Departamenti i Administratës Lokale dhe Ministrisë së Shërbimeve Publike dhe DPÇBP-së) duhet të kenë një kuptim uniform sa i përket delegimit të pushtetit dhe implementimit të tij. Nga ana e Departamenteve dhe Ministrive të cilat janë përgjegjëse për pronën banesore, duhet të lëshohen udhëzime të qarta administrative për administratorët komunal të UNMIK-ut dhe nëpunësit civil komunal të cilët janë përgjegjës për çështjet pronësore dhe banesore
- Të gjitha komunat duhet të formojnë zyret e tyre mbi çështjet banesore. Përbërja, kompetencat dhe kushtet e punës të secilës zyrë, duhet të jenë uniforme në të gjithë Kosovën. Me qëllim që të mënjanohet dyfishimi, departamentet apo komisionet ekzistuese duhet të marrin përgjegjësi për çështjet banesore. Trajnimi i paraparë për nëpunësit kompetent kmunal duhet të jetë obligativ.
- Duhet të themelohet instituti i përgjegjësishë për nëpunësit civil komunal të cilët janë përgjegjës për çështjet banesore.
- Të gjitha aktivitetet e kundërligjshme, siç janë, uzurpimet dhe ndarja joligjore e ndërtesave nga ana e komunave, paraqesin tejkalim të kompetencave të cilat i u janë bartur nga DPÇBP-ja. Aktivitetet e tilla të kundërligjshme ngërthejnë përgjegjësinë ligjore të komunave për marrjen e tyre si të përgjegjëshme për zhdëmtimin apo kompenzimin e personave të cilëve u shkilen të drejtat e tyre pronësore.
- Me qëllim të mënjanim të konfuzionit përkritazi me kontestet kontraverze, siç janë, banesat e njohura si Programi Yu apo banesat të cilat ishin në pronësi të ushtrisë jugosllave, DPÇBP-ja duhet të qartësoj regjimin ligjor i cili administron këto ndërtesa. Kjo do të eliminoj veprimet e marra nga ana e zyrtarëve komunal të cilët kanë prirje që të shpallin ato banesa si pronë e komunës dhe t'ua ndajnë ato individëve të cilët nuk kualifikohen në bazë të kriterit të DPÇBP-së për dhënien e banesave për qëllime humanitare.

III. Gjykatat e rregullta në Kosovë: Gjykimi i lëndëve që kanë të bëjnë me të drejtat pronësore dhe e drejta në proces të rregullt gjyqësor

1. Mandati i institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes në Kornizën Kushtetuese përkritazi me çështjet gjyqësore.

Kapitulli 5 neni 3 i Kornizës Kushtetuese paraqet një listë të obligimeve të cilat institucionet e përkohshme i kanë në fushën e çështjeve gjyqësore.⁵² Në Kosovë, gjykatat e rregullta ekzistuese, DPÇBP-ja dhe KKPB-ja janë organe të cilat janë të caktuara të zgjidhin kontestet pronësore. Këto institucione merren gjithashtu edhe me aktivitete administrative dhe gjyqësore. Ky nen analizon kompatibilitetin e aktiviteteve të gjykatave të rregullta në Kosovë me të drejtën për pronë dhe të drejtën për proces të rregullt gjyqësor.

2. Jurisdikcioni i gjykatave të rregullta në ligjin e zbatueshëm për pronën

Ligji i zbatueshëm i jep gjykatave të rregullta një mandat të gjerë për të gjykuar lëndët pronësoro-juridike. Ligji mbi Gjykatat e Rregullta⁵³ në nenin 26, 29 dhe 31 parasheh kompetencat e Gjykatës Komunale, Gjykatës së Qarkut dhe Gjykatës Supreme përkitazi me pronën.⁵⁴ Në bazë të ligjit të zbatueshëm, KKPB-ja ka jurisdikcion ekskluziv për të zgjidhur disa kategori përkatëse të kontesteve pronësoro-banesore.⁵⁵ Vendimet e marra nga Gjykatat e rregullta përkitazi me kërkesat pronësoro-juridike të cilat i takojnë njërës prej këtyre kategorive janë të pavlefshme. Sidoqoftë, Komisioni mund t'i referoj "pjesët përkatëse të kërkesave të tilla gjykatave vendëse dhe organeve tjera administrative".⁵⁶

3. Konflikti i kompetencave⁵⁷ ndërmjet KKPB-së dhe gjykatave të rregullta

KKPB-ja është një organ kuazi-gjyqësor i krijuar për të siguruar që kategoritë e caktuara të kontesteve pronësoro-juridike të zgjidhen nga ana e mekanizmave të cilët i plotësojnë konditat e procesit të rregullt, në pajtim me standartet e të drejtave të njeriut. Futja e një institucioni të huaj

⁵² Kreu 5.3 b) i Kornizës Kushtetuese thotë: "Institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes kanë gjithashtu përgjegjësitë e mëposhtme në fushën e çështjeve juridike: [...]Të ushtrojnë përgjegjësi në lidhje me organizimin dhe funksionimin e rregullt të gjykatave, brenda strukturave ekzistuese të gjykatave; [...]"

⁵³ Gazeta Zyrtare e KSAK 21/78

⁵⁴ Gjykatat komunale (neni 26 i Ligjit mbi gjykatat e rregullta) kanë kompetencë:

"6) që të gjykojnë kontestet mbi kërkesat pasurore-juridike, kur vlefata e kontestit nuk kalon shumë prej 100.000 dinarësh (tani marka gjermane), nëse me këtë ligj nuk është caktuar kompetenca e gjykatës tjetër të rregullt.

11) të gjykojnë kontestet për shkak të pengimit të posedimit; 13) lokaleve afariste si dhe kontestet nga marrëdhëniet banesore, po qe se janë në kompetencën e gjykatave të rregullta;

14) të vendosin mbi procedurën e trashëgimisë, në procedurën e ekzekutimit, në procedurën e regjistrimit të të drejtave dhe mbi sendet të paluajtshme, në lëndët e pjesëtimeve fizike, rregullimit të megjave, legalizimit të kopjeve, të dorëshkrimeve të nënshkrimeve, si dhe në çështjet e tjera jashtëkontestimore që me ligj janë lënë në kompetencën gjyqësore;

16) të kryejnë punët e ndihmës juridike;

Gjykatat e Qarkut (neni 29 i Ligjit mbi gjykatat e rregullta) janë kompetente:

1) të vendosin mbi ankesat kundër vendimeve të gjykatave komunale të nxjerra në shkallë të parë;

2) të gjykojnë në shkallën e parë: kontestet mbi kërkesat pasurore-juridike kur vlefata e kontestit kalon vlerën prej 100.000 dinarësh, kurse kontestet për kompenzimin e dëmit të personave të dënuar në mënyrë të papërligjshme dhe personave që u është hequr liria në mënyrë të kundërligjshme pa marrë parasysh vlerën.

9) të vendosin konfliktet për kompetencë midis gjykatave komunale në territoret e veta;

10) të kryejnë edhe punët e tjera të caktuara me ligj.

Gjykata Supreme e Kosovës vendos në kuadër të kompetencës së përcaktuar me ligj, mbi ankesat kundër aktgjykimeve dhe vendimeve të tjera të gjykatave në territorin e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës;

6) u jep udhëzime gjykatave mbi mënyrën e mbajtjes së evidencave, mbi studimin e praktikës gjyqësore dhe të marrëdhënieve shoqërore dhe dukurive shoqërore të cilat janë vërejtur në punën e gjykatave;

7) përcakton qëndrimet parimore dhe mendimeve juridike mbi çështjet që kanë rëndësi për zbatimin unik të ligjeve nga ana e gjykatave në territorin e Krahinës;

8) vendos konfliktet për kompetencë midis gjykatave të rregullta, konfliktet për kompetencë midis gjykatave të rregullta dhe gjykatave të punës së bashkuar dhe konfliktet për kompetencë midis gjykatave të rregullta dhe gjykatave të tjera vetëqeverisëse në territorin e Krahinës;

9) vendos mbi çështjet e tjera kur një gjë e tillë është e caktuar me ligj;

10) kryen dhe punët e tjera të caktuara me ligj".

⁵⁵ Shih nenin 1.2 (a), (b) dhe (c) të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23

⁵⁶ Neni 2.5 i Rregullores së UNMIK-ut 1999/23

⁵⁷ Termi "Konflikt i kompetencave" nuk është shfrytëzuar si nocion ligjor dhe në kuptimin juridik të mosmarrëveshjes në mes të KKPB-së dhe gjykatave të rregullta. Por, ky term shpreh de facto konfliktin i cili rrjedh nga ndërhyrja e gjykatave të rregullta në kompetencën legjitime të KKPB-së për shkak të hutisë vis-a-vi ligjit në fuqi.

në sistemin juridik vendës nuk parashihte konfliktet e mundshme të kompetencave dhe mënyrën se si duhej zgjidhur ato. Rregullorja e UNMIK-ut 1999/23 dhe 2000/60 nuk japin ndonjë indikacion në lidhje me atë se si ndërlihdhen ato me gjyqësinë vendëse. Gjer më tani, nuk ekziston ndonjë bashkëpunim formal ndërmjet gjykatave të rregullta dhe KKPB-së, situatë kjo e cila mund të shpije drejt shkeljes së të drejtës proces të rregullt, për shkak se përcaktimi i pronës individuale mund të pësoj zvarritje të panevojshme apo të përcaktohet nga një organ i cili në bazë të ligjit nuk është kompetent për t'i gjykuar kërkesat e tilla pronëso-ro-juridike.

i. Rregullimi i konfliktit të kompetencave me ligjin e zbatueshëm

Ligji i zbatueshëm vendës e rregullon çështjen e konfliktit të kompetencave, mirëpo për arsye të njohura, aty nuk ekziston ndonjë referim i cili i bëhet KKPB-së. Kreu 2 i Ligjit të Procedurës Civile (Gazeta Zyrtare 69/82-1596) rregullon kompetencat dhe përbërjen e gjykatave. Neni 15⁵⁸ i obligon gjykatat që të vlerësojnë kompetencat e tyre pas pranimit të lutjes dhe neni 16⁵⁹ thotë se një gjykatë duhet të shpall veten jo kompetente kur lënda të bie në kompetencat e një organi tjetër. Neni 21 i obligon gjykatat të caktojnë lëndët përkatëse për tu zgjidhur nga ndonjë gjykatë tjetër nëse kompetencat e asaj gjykate nuk e lejojnë një gjë të tillë edhe procedurat e kryera konsiderohen të jenë të vlefshme.⁶⁰ Në bazë të nenit 282⁶¹ të Ligjit të Procedurës Civile, palët kanë të drejtë të marrin një urdhër me shkrim nga ana e gjykatësit i cili e shpall gjykatën përkatëse jo kompetente për ta gjykuar lëndën. Ai gjithashtu garanton se në një lëndë përkatëse pronëso-ro-juridike ku njëra palë parashtron ankesë kundër vendimit të Gjykatës Komunale përkitazi me një kontest pronëso-ro-juridik (për shembull në ato baza se lënda bie nën jurisdikcionin e DPÇBP-së), vendimi i gjykatës duhet të përfshijë deklaratën e cila tregon se një gjë e tillë ka ndodhur. Për më tepër, vendimi i gjykatës duhet të përmbajë edhe arsyetimin me shkrim.⁶²

Rregullorja mbi punën e gjykatave të rregullta përmban disa dispozita të cilat rregullojnë komunikimin me organet dhe palët e tjera, dorëzimin e dokumenteve dhe komunikimeve *inter se* me organet e tjera administrative.⁶³ Njëri nga parimet e Rregullores së Punës, është ai se gjykata

⁵⁸ Neni 15 i Ligjit të Procedurës Civile thotë: “Menjëherë pas pranimit të lutjes, gjykata do të vlerësoj ex-officio se a bie ajo lëndë në kompetencë të atij gjykatësi apo jo, dhe në cilën përbërje. [...]”

⁵⁹ Neni 16 i Ligjit të Procedurës Civile thotë se “... kur një lëndë bie në kompetencën e një organi tjetër vendës apo të huaj, gjykata do ta shpall veten si jokompetente...”

⁶⁰ Neni 301 i Ligjit të Procedurës Civile thotë: “Nëse një palë bën lutje duke deklaruar se pruarja e aktgjykimit në lidhje me një kërkesë nuk bie në kompetencat e një gjykate, atëherë ajo gjykatë nuk është territorialisht kompetente, se ekziston edhe një kërkesë padi e cila edhe nuk është zgjidhur (ius pendens), se aktgjykimi i formës së prerë është pruar mbi atë lëndë, ose se paditësi privat ka hequr dorë nga padia, se zgjidhja e çështjes veç është arritur në gjykatë, gjykata do të vendos se a të zgjidh këtë lëndë ndaras apo së bashku me lëndën kryesore [...] Nëse gjykata nuk pranon vërejtjen e parashtruar në bazë të paragrafit 1 të këtij neni e cila është shqyrtuar së bashku me lëndën kryesore, apo nëse gjykata, pas shqyrtimit të veçantë të vërejtjes merr vendim që të mos e pranoj një vërejtje të tillë dhe vendos të vazhdoj me procedurat kryesore menjëherë, vendimi mbi vërejtjen e parashtruar duhet të përfshihet në vendimin mbi lëndën kryesore.”

⁶¹ Neni 282 i Ligjit të Procedurës Civile thotë se: “Pas shqyrtimit paraprak të deklaratave të kërkesave pronëso-ro-juridike, Kryetari i Kolegjit është i autorizuar që të bie vendime ashtu siç janë të parapara me nenin 278 të këtij ligji, përpos nëse lëndët në fjalë janë të aso natyre dhe se në bazë të dispozitave të këtij ligji vendimi mund të bihet vetëm në fazat e mëvonshme të procedurës.”

⁶² Neni 338 i Ligjit të Procedurës Civile thotë se: “[...] Kushtet e prarjes së një aktgjykimi duhet të përmbajnë edhe vendimin e gjykatat për pranimin apo refuzimin e një kërkesë të veçantë pronëso-ro-juridike dhe vendimin mbi mbi ekzistencën apo mosekzistencën e kërkesave të parashtruara për qëllime të larjes së borxheve”.

⁶³ Nenet e rregullores për organizim të brendshme të gjykatave të paraqitura si mëposhtë citojnë

Neni 85. Kryetari i gjykatës do të komunikoj, me rregull, me organet dhe organizatat tjera. Në procedurën e tillë një gjyqtar i lëndës i cili punon në një lëndë përkatëse do të komunikoj në mënyrë të drejtpërdrejt me organet dhe organizatat tjera kur të ketë autorizim për të bërë një gjë të tillë. Komunikimi me ambasadën e vendit tonë nëpër vendet e huaja apo me ambasadat e huaja në vendin tonë, gjykata do ta bëjë nëpërmjet të Sekretariatit Krahinor përpos nëse marrëveshjet ndërkombëtare apo dispozitat në fuqi nuk parashohin diçka tjetër.

Neni 109. Kryetari i gjykatës apo gjyqtari i cili e zëvendëson atë duhet t'i nënshkruajnë të gjitha aktet administrative.

Neni 158 Punëtori i cili shpërndan dokumentet zyrtare drejtpërdrejt apo nga një palë tjetër, nuk mundet të refuzoj të shpërndaj një dokument zyrtar e cila i dërgohet gjykatës. Nëse dokumenti zyrtar përmban një defekt normal (nuk është e nënshkruar, nuk ka shtojcën e saj etj.) apo nëse gjykata nuk ka kompetenca të veprj në lidhje me këtë çështje, punëtori do të paralajmëroj palën se dokumenti zyrtar nuk është komplet dhe se ka defekte dhe se do t'i shpjegoj palës se si t'i korrigjoj ato, respektivisht t'i dërgoj ato në organin kompetent. Nëse pala insiston që dokumenti përkatës zyrtar duhet të shpërndahet/dërgohet punëtori do ta pranoj atë dokument duke e

nuk duhet t'ju shkaktojë palëve dëm të panevojshëm, siç janë zvarritjet e panevojshme.⁶⁴ Nga teksti i ligjit vendës, duket se dispozitat për zgjidhjen e konfliktit të kompetencave janë të rregulluara në mënyrë adekuate për institucionet e mëparshme të Kosovës. Për këtë arsye, dështimet sipas të gjitha gjasave ndodhin për shkak të mungesës së administrimit dhe implementimit.

ii. Gjetjet e OSBE-së përkitazi me konfliktin e kompetencave ndërmjet të KKPB-së dhe gjykatave të rregullta

OSBE-ja ka bërë një anketë gjatë shtatorit të vitit 2001 me gjykatësit e gjykatave komunale të cilët merren me çështjet pronëso-ro-juridike, për të kuptuar se si dhe, a janë duke e aplikuar në praktikë ligjin e aplikueshëm. Në disa raste, OSBE-ja kishte intervistuar drejtpërdrejtë Kryetarin e Gjykatës, përderisa në rastet tjera kishte intervistuar gjyqtarë të zakonshëm. Anketa ishte kryer praktikisht në të gjitha komunat e Kosovës të cilat kanë gjykata komunale. Krahas kësaj (dhe për shkak) të problemeve të cilat dalin nga transplantimi inorganik i KKPB-së në vetë sistemin juridik, disa gjyqtarë komunal, nuk duket se kanë dijeni përkitazi me dispozitat të cilat rregullojnë çështjen e kompetencave dhe jurisdikcionit. Zbulimet e OSBE-së në këtë çështje janë të paraqitura si në vijim:

- Ekziston një laramani në mesin e përgjigjeve të dhëna nga ana e gjykatësve komunal përkitazi me dispozitat ligjore të aplikueshme në lëndët në të cilat gjykata nuk ka kompetencë. Përgjigjet shpesh ishin edhe jo specifike dhe thjeshtë i referoheshin ligjit të zbatueshëm para 23 marsit 1989 apo Rregulloreve të UNMIK-ut 1999/23 dhe 2000/60 mbi mandatin e DPÇBP-së/KKPB-së, mirëpo, jo edhe aq shpesh dispozitave të posaçme të Ligjit të Procedurës Civile dhe Ligjit mbi Gjykatat e Rregullta.
- OSBE-ka ka vërejtur një shkallë më të lartë të saktësisë sa i përket njohurive të treguara nga ana e gjyqtarëve të cilët punojnë në kuadër të gjykatave komunale në qytetet e mëdha se sa ata që punojnë nëpër zona rurale.
- OSBE-ka ka vërejtur se disa kopje të përmbledhjeve të teksteve ligjore të publikuara nga Qendra Juridike e Kosovës (të publikuara në gjuhën angleze, shqipe dhe atë serbe) ishin të pashfrytëzuara nga gjykatat komunale.
- Përkundër pikave të paraqitura paraprakisht, refuzimi i lëndës në bazë të mungesës së jurisdikcionit i kumtohet me shkrim parashtruesit të kërkesës. Vendimi nuk ka ndonjë arsyetim të përshtatshëm, i cili dështon të merret me bazat e marrjes së vendimit të tillë dhe me faktet e veçanta të lëndës. Shpeshherë kemi rastet e refuzimit *ex-officio* të kompetencave që bëhet në favor të DPÇBP-së apo KKPB-së. Disa gjyqtarë deklaruan se ata i kanë përcjellur shumë lëndë në mënyrë *ex-officio* DPÇBP-së/KKPB-së mirëpo kjo ishte refuzuar mëpastaj nga DPÇBP-ja/KKPB-ja. Sipas DPÇBP-së, gjykatat kanë dërguar letra me të cilat kanë kërkuar vërtetimin e mandatit të gjykatës përkitazi me kontestet pronëso-ro-banësore, por nuk ekziston ndonjë dosje e cila tregon për referimin *ex officio* të lëndëve në fjalë. Pa marrë parasysh këtë, DPÇBP-ja kishte deklaruar se personat e interesuar, duhet të parashtrorjnë

shkruar me laps të kuq se cila është parregullsia dhe se ai e ka paralajmëruar palën paraprakisht. Me kërkesë të palës, punëtori i autorizuar gjatë marrjes së dokumentit për ta dorëzuar ai i lëshon palës përkatëse një dëftesë me të cilën tregohet se ai e ka marrë dokumentin për ta dorëzuar.

⁶⁴ Neni 3 i Rregullave për aktivitetet e brendshme të gjykatave 7/81

Aktivitetet e brendshme të gjykatave do të organizohen në mënyrën të cilën gjykata e konsideron si të ligjshme, në kohë të duhur dhe në mënyrë efikase, dhe me qëllim të lehtësimit të palëve për të kryer detyrat e tyre nëpër gjykata dhe t'ua bëjë të mundshme atyre që të kryejnë detyrat e tyre të cilat parashihen me ligj në kohë të duhur dhe me shpenzime minimale.

kërkesë fromale në mënyrë që të merren parasysh ato në bazë të procedurave të DPÇBP-së. Ishte e pamundshme për OSBE-në të përcaktoj se sa lëndë janë refuzuar nga gjykatat e rregullta për shkak të mungesës së jurisdikcionit, për arsye se nuk janë mbledhur statistika të veçanta mbi këtë çështje.

iii. Rastet e hutisë dhe konfliktit të kompetencave ndërmjet KKPB-së dhe gjykatave të rregullta

Gjatë kryerjes së anketës të përmendur si mëlartë, në mesin e pjesëtarëve të gjyqësisë, OSBE-ja kishte pyetur gjykatësit e gjykatës komunale se a kanë marrë ndonjëherë vendim i cila ishte në kundërshtim me ndonjë vendim apo procedurë të DPÇBP-së/KKPB-së. Gjykatësit, të cilët ishin intervistuar nga ana e OSBE-së mohuan se një gjë e tillë kishte ndodhur mëparë. Sidoqoftë, në Prishtinë gjykata komunale ka lëshuar vendime për dëbim nga ndërtesat të cilat janë nën administrim të DPÇBP-së. Siç pohohet, një serb i Kosovës i kishte shitur banesën e tij një shqiptari të Kosovës, banesë kjo e cila ndodhej në ndërtesat të cilat i ruan KFOR-i për shkak se individët të cilët jetojnë aty janë pjesëtarë të pakicave. Ndërtesa ishte subjekt i një ligji të posaçësm i cili u jepte të drejtën për banim jo-shqiptarëve gjatë viteve të nëntëdhjeta. Kushti për fitimin e një banese e cila ndodhej në atë ndërtesë ishte, që ajo banesë nuk mund të shitej përdërisa të skadonte periudha prej dhjetë viteve të shfrytëzimit të pandërprerë. Shqiptari i Kosovës i cili e kishte blerë banesën e kuptoj se banesa të cilën e kishte blerë ishte e okupuar nga një serb tjetër dhe si rezultat i kësaj ai inicoi procedurën për urdhër për dëbim në kuadrë të gjykatat. Gjykata, pa shqyrtuar se a janë plotësuar kushtet e shitblerjes, e jep urdhërin për dëbim. KFOR-i, siç pohohet për shkak të problemeve të sigurisë, parandaloi ekzekutimin e urdhërit të tillë për dëbim. Pastaj serbi i Kosovës i cili e kishte shitur banesën parashtrroi kërkesë pronëso- juridike pranë DPÇBP-së për rikthimin e të drejtës së posedimit të banesës së tij.

Një rast tjetër ilustron për problemet të cilat kanë lindur për shkak të një konflikti negativ të kompetencave ndërmjet të KKPB-së dhe gjykatave të rregullta i cili është duke ndodhur edhe sot e kësaj dite në Suharekë/Suha Reka. Menaxhmenti i ndërmarrjes (e cila mëparë ishte në pronësi shoqërore) gjatë viteve të nëntëdhjeta privatizoj nëntë banesa dhe atë në favor të serbëve të Kosovës. Menaxhmenti i tillë i ndërmarrjes e kishte marrur përsipër udhëheqjen e ndërmarrjes pas largimit nga puna të punëtorëve shqiptar në vitin 1990. Procesi i privatizimit ndodhi gjatë regjimit të Millosheviqit, mirëpo, nuk kemi informata në lidhje me atë se a ka qenë procesi i privatizimit në të vërtetë diskriminues apo i kundërligjshëm. Sidoqoftë për shkak se gati të gjithë punëtorët shqiptar ishin larguar nga puna në vitin 1990, ata nuk mundën të marrin pjesë në procesin e privatizimit i cili në masë të madhe kishte prekur ata punëtorë të cilët ishin duke punuar në atë fabrikë. Në vitin 1999, personat të cilët pohonin se kishin qenë menaxhmenti i ndërmarrjes e cila ishte në pronësi shoqërore para vitit 1989, kishin marrë përsipër udhëheqjen e ndërmarrjes. Menaxhmenti, i cili ishte legjitimizuar nga UNMIK-u, vendosi në mënyrë unilaterale se privatizimi i nëntë banesave të okupuara në mënyrë të paligjshme është i pavlefshëm dhe kishte paraqitur kërkesë pronëso- juridike duke kërkuar rikthimin e të drejtës për posedim.

Gjykata refuzoj të merret me lëndën në fjalë duke vendosur në favor të KKPB-së mirëpo vendimit të marrë i mungonte arsyetimi. Në vendimin e marrë, gjykata kishte përfshirë edhe mundësinë për ankesë në gjykatën e qarkut dhe atë brenda 15 ditëve pas marrjes së vendimit në fjalë. Ndërmarrja e cila ishte pronë shoqërore parashtrroi ankesë në gjykatës së qarkut i cili e kishte kthyer lëndën prapa në gjykatën komunale. Gjykata i qarkut vendosi se sipas Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 personat juridik nuk mund të parashtrrojnë ankesë pranë KKPB-së, andaj gjykata komunale është kompetente për një gjë të tillë. Lënda i është referuar më pastaj gjykatës komunale e cila përsëri refuzoi jurisdikcionin ndaj lëndës në fjalë në favor të KKPB-së. Pas parashtrimit të ankesës lënda në fjalë pret zgjidhje në gjykatën e qarkut.

Një rast tjetër i cili ilustron konfuzionin ekzistues përkitazi me jurisdikcionin e KKPB-së ndodhi ndërmjet palëve private dhe Kishës Ortodoke në Deçan. Ish drejtorët e pronave shoqërore të cilat siç pohohet u janë dhënë Kishës Ortodokse gjatë viteve të nëntëdhjeta parashtuan kërkesë pronësoro-juridike pranë gjykatës komunale. Sipas informatave të pranuara gjykata komunale ia referoi lëndën në mënyrë *ex-officio* gjykatës së qarkut dhe DPÇBP-së, mirëpo lënda mëpastaj u kthye prapa nga gjykata e qarkut. Krahas kësaj, PSSP-ja i mëhershëm, Bernard Kushner e kishte shkruar një letër me të cilën theksonte se kontesti duhet të zgjidhet nga ana e DPÇBP-së brenda një afati të rregullt kohor, edhe pse kjo kishte një efekt të cenimit të pavarësisë së gjykatave dhe nuk merrte fare në konsideratë jurisdikcionin ekskluziv të KKPB-së përkitazi me kategoritë përkatëse të kërkesave pronësoro-banesore. Për shkak se prona në fjalë nuk është banesore dhe për shkak se personi fizik nuk e ka parashtuar kërkesën pronësoro-juridike, dhe për këtë arsye KKPB-ja nuk është kompetente për të zgjidhur rastin në fjalë. Krahas kësaj, aplikimi joadekuat i mandatit të KKPB-së ka rezultuar me shtyerje të panevojshme të procedurave të KKPB-së.

Nga të gjithë shembujt e sipër përmendur duket se procedura civile dhe instrumentet ligjore subsidiare në kuadër të ligjit të zbatueshëm vendës parashtojnë rregulla adekuate dhe konsistente për parandalimin e konfliktit të kompetencave. Me qëllim që të sigurohet se gjykata nuk do të ndërhyjë në kompetencat dhe jurisdikcionin e KKPB-së, UNMIK-ut duhet të ndryshoj këto rregulla me qëllim të përfshirjes së KKPB-së në kuadër të sistemit të tërë juridik dhe me qëllim të mënjanimin të vakumit juridik. KKPB-ja paraqet një organ të huaj për sistemin juridik civil të Kosovës. Në bazë të karakterit të përjashtueshëm të mandatit të KKPB-së, OSBE-ja nuk beson se një analogji e tillë duhet të aplikohet në rastin e rregullave të procedurës të KKPB-së. Me fjalë të tjera, neni 21 i Ligjit të Procedurës Civile, si i tillë, nuk duhet të obligoj KKPB-në ose sistemi përndryshe do të jetë i mbushur me referime të lëndëve. Në anën tjetër, ligji dhe praktika e gjykatave në Kosovë, duhet të merret në konsideratë kur të gjinden zgjidhjet adekuate, dhe përderisa KKPB-ja nuk mund të mbetet e izoluar nga realiteti ligjor dhe procedural, ne kemi të bëjmë me një numër në rritje të rasteve të konfliktit të kompetencave, si pozitive ashtu edhe negative. Duhet të formohet një procedure për referimin e lëndëve ndërmjet institucioneve përkatëse. Prej të gjitha rasteve të cilat i ka vërejtur OSBE-ja gjer më tani, konflikti i tillë i kompetencave mund të rezultoj me probleme serioze për sistemin e tërësishëm nëse nuk zgjidhet në mënyrë adekuate. Dhe në përmbledhje të gjithë kësaj, zbratësitë strukturore dhe trans-institucionale janë duke rezultuar me shkeljen e të drejtës për proces të rregullt.

Krahas problemeve të brendshme të sistemit, gjyqësia duhet të siguroj, ashtu si është, zbatimin e ligjit në fuqi. Ligji i Procedurës Civile dhe Rregullorja e Punës, përcaktojnë rregulla mjaft të qarta në lidhje me kompetencat, jurisdikcionin dhe administrimin e lëndëve pronësoro-juridike të cilat vijnë në gjykatë. Në këtë fazë të zhvillimit të gjyqësisë është vështirë të kuptohet se pse një gjyqtar ia referon kërkesën e cila ka të bëjë me pronën jo banesore KKPB-së. Në përgjithësi, KKPB-ja është duke u flijuar, për këtë arsye dhe palët shpeshherë janë të detyruara që të presin më shumë se që nevojitet në mënyrë që të shohin se si të drejtat e tyre pronësore janë duke u përcaktuar nga një tribunal i paanshëm.

iv. Iniciativat për zgjidhjen e problemeve

Në prill të vitit 2001, PSSP-ja lëshoi një sqarim mbi jurisdikcionin e KKPB-së dhe gjykatave të rregullta.⁶⁵ Edhe pse qëllimi i një sqarimi të tillë ishte ofrimi i udhëzimeve, nuk ekziston ndonjë referim i cili i është bërë procedurave konkrete për shmangjen e konfliktit të kompetencave ndërmjet të KKPB-së dhe gjykatave të rregullta. Në këtë sqarim nuk ekziston madje asnjë referim i cili i është bërë ligjit të zbatueshëm vendës të procedurës administrative apo asaj civile dhe në faktin se si aktet dhe vendimet administrative duhet të procesohen në rradhë të parë. Në rast se

⁶⁵ Lexo sqarimet e PSSP-së për rregullren e UNMIK-ut, nr. 2000/60 të datës 12 prill 2001.

KKPB-ja apo gjykatat e rregullta gjejnë ndonjë dispozitë të ligjit të zbatueshëm e cila është e paqartë apo e dykuptimtë, KKPB-ja apo gjykatat e rregullta mund t'i referohen sqarimit të lëshuar nga PSSP-ja për të përcaktuar se cili ka qenë qëllimi i vërtetë i "ligjvënësit". Sqarimi nuk është detyrues (obligativ).

Ish Departamenti Administrativ i Drejtësisë kishte marrë një iniciativë për formimin e një grupi punues i cili do të merrej me këtë çështje. Mbledhja e parë u mbajt më 28 shtator 2001 në të cilën morrën pjesë përfaqësuesit e Departamentit të Drejtësisë, Departamentit të Shërbimeve Publike, DPÇBP-së, Gjykatës Supreme dhe OSBE-së. Kjo nisativë është e mirëpritur, por tani është heret të pritet ndonjë rezultat. Grupi punues do të shiqojë natyrën dhe volumin e problemeve, pasi që, të dhënat e sakta janë akoma të kufizuara. Së bashku me gjyqësinë vendëse dhe DPÇBP-në, grupi punues do të mundohet të zhvilloj dhe të formalizoj bashkëpunimin në mes të dy institucioneve dhe të hartojnë një mekanizëm ligjor për të plotësuar zbrastësirën e cila ka buruar me krijimin e KKPB-së.

OSBE, beson se zgjidhja e problemit kërkon një qasje legjislative dhe operationale. Edhe pse, KKPB, është një organ i ri, mandati i tij mund të evoluoj drejt funksionimit, krahe për krahe, me sistemin juridike vendës. Së këndejmi, sipas Rregullores 2000/59, instrumentet subsidiare, mbizotërojnë ndaj ligjeve vendëse në fuqi, ndërsa rruga për reformën e të drejtës procedurale është e hapur. Për këtë arsye, PSSP, do të mund të miratonte një rregullore apo një udhëzim administrativ⁶⁶, duke mundësuar në këtë mënyrë sistemin që ai të përqafoj institucionet e reja dhe pasjen e një sistemi civil i cili respekton të drejtën e një procesi të rregullt. Krijimi i procedurave moderne dhe efektive të komunikimit në mes të këtyre organeve gjithashtu është mëse e rëndësishme. Por, këto përpjekje do të kenë vlera të kufizuara, nëse gjyqësia tregohet si e paaftë për të zbatuar ligjin sipas sistemit juridik.

Instituti gjyqësor i Kosovës, ka organizuar trajnime me DPÇBP-në mbi kompetencën ekskluzive të KKPB-së, por të njëjtat kanë qenë të kufizuara në spjegimet formale të kategorive të kompetencave ekskluzive të KKPB-së. Mirëpo, asnjë referencë nuk është bërë lidhur me çështjet praktike si në vijim:

- Cilat dispozita ligjore i zbaton gjyqtari kur atij/asaj i mungon kompetenca për të vendosur?
- Si do t'ia bartë ai/ajo lëndën, organit i cili nuk është i parashikuar me legjislacion vendës dhe me të cilin nuk ka raporte zyrtare?

OSBE, ekziston nevoja e gjurmimit dhe spjegimit të mekanizmave formal të parashikuar me ligjin në fuqi për çështjet e jokompetencës dhe kërkimit të spjegimeve nga organet më të larta lidhur me kompetencën ndaj rastit konkret. Gjithashtu ka nevojë edhe për trajnime shtesë siç është përmendur edhe në paragrafin e fundit.

4. Ngecja në zgjidhjen e kontesteve pronësore juridike pranë gjykatave të rregullta të Kosovës

Neni 6 i KEDNJ kërkon që "gjatë përcaktimit të të drejtave dhe detyrimeve civile juridike [...] secili gëzon të drejtën e gjykimit publik dhe të drejtë dhe në një kohë të arsyeshme". Koncepti i "kohës së arsyeshme për qasje në një gjykim të drejtë dhe publik" varet nga shumë faktorë. KEDNJ, nuk konsideron se shteti shkelë të drejtën në proces të rregullt për shkak se ekziston ngecje e madhe në zgjidhjen e lëndëve, për shkak se kjo merr kohë të gjatë për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të dikujt. Gjykata vlerëson rrethanat për secilin rast në veçanti, në përcaktimin nëse është shkelur apo jo e drejta në një proces të rregullt.

⁶⁶ Sipas rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/60, neni 27 mbi zbatimin e saj: "Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të lëshojë udhëzime administrative për zbatimin e kësaj rregulloreje".

Sidoçoftë, akoma nuk është bërë mbledhja e të dhënave të mjaftueshme për lëndët konkrete, për të vërtetuar nëse është apo nuk është bërë shkelje sistematike e të drejtës në një proces të rregullt. OSBE, është përpjekur të mbledhë të dhëna mbi numrin e përgjithshëm të lëndëve të kontesteve pronësore juridike nëpër gjykatat komunale të Kosovës. Efektivisht, OSBE, ka intervistuar personelin e gjykatave komunale të Kosovës (kryetarët e gjykatave, gjykatësit civil dhe nëpunësit tjerë). OSBE, duke qenë e vetëdijshme për problemet të cilat mund të paraqiteshin gjatë përpjekjeve për të mbledhur të dhënat e tilla, u kufizua në kohë dhe vetëm në pyetjet për çështje të përgjithshme. Asnjë e dhënë nuk është marrur lidhur me numrin e lëndëve në gjykim e sipër nëpër gjykatat e qarkut. Krahas kësaj, sistemi i arkivave gjyqësore nuk mundëson nxjerrjen e statistikave të sakta. Për shembull, gjykata komunale në Prishtinë/Pristina, e cila gjithashtu mbulon komunën e Fushë Kosovës/Kosovo Polje dhe të Obiliqit/Obilic, nuk i ka dhënë asnjë shënim OSBE-së, duke spjeguar se mbledhja e këtyre të dhënave është e vështirë dhe merr kohë të gjatë. Sidoçoftë, mund të thuhet se disa lëndë janë në gjykim e sipër (apo të injoruara) me vite të tëra, e posaçërisht ato të cilat kanë filluar para vitit 1999.

Së pari, OSBE, kishte pyetur për numrin e lëndëve pronësore juridike të parashtruara para themelimit të UNMIK-ut në qershor të vitit 1999. Për befasi, në disa komuna nuk ka konteste të papërfunduara që nga ajo kohë (Gjilan/Gnjilane dhe Mitrovicë/Mitrovica), të tjerat kanë deklaruar se nuk kanë të dhëna, ndërsa disa prej tyre (të gjitha gjykatat komunale në regjionin e Prizrenit) kanë pranuar se ekziston një numër i madh i lëndëve të papërfunduara para ardhjes së UNMIK-ut.⁶⁷

Gjykatat kishin mundësi të ofronin të dhëna mbi numrin e kontesteve pronësore në mes të palëve private të pranuar që nga viti 1999 (apo prej kur gjykatat kanë filluar ti gjykojnë lëndët civile aty kah pranvera e vitit 2000). Është posaçërisht interesante se numri i kontesteve të pranuar që nga viti 1999 në regjionin e Prizrenit është 6000⁶⁸, përdërisa në Gjilan/Gnjilane, vetëm 360, 271 në Pejë/Pec dhe 171 në Mitrovicë/Mitrovica.⁶⁹ OSBE, nuk ka fare numra për regjionin e Prishtinës/Pristina.⁷⁰

OSBE, gjithashtu ka hulumtuar për numrin e lëndëve ku njëra praj palëve në kontest është institucioni i cili ushtron funksione shtetërore. Numri i përgjithshëm i këtyre lëndëve është 358, edhe pse nuk janë mbuluar të gjitha gjykatat komunale.⁷¹ Çështja e cila ka ndikuar para dhe pas qeshorit 1999 në kontestet në mes të palëve private, ka qenë mungesa e avokatit publik. Sipas ligjit avokati publik mbronë intersat e shtetit në nivelin komunal dhe të krahinës. Përkundër rregullores së UNMIK-ut, nr. 2000/45, e cila i lejon komunës cilësinë e personit juridik dhe mundësin që të padis dhe të jetë e paditur në gjykatë⁷², UNMIK-u nuk ka emëruar në mënyrë sistematike avokatët publik. Sipas ligjit, të vetmit janë këta, të cilët janë të autorizuar të mbrojnë intersat publike në gjyqet e rregullta. Kjo situatë u lejon gjykatave dy opsione: të refuzojnë procedimin nëse interesi publik nuk përfaqësohet në mënyrë të duhur, duke shkelur të drejtën e

⁶⁷ Në regjionin e Prishtinës/Pristina, Lipjanit/Lipljane, janë deklaruar 15 lëndë të pa përfunduara ndërsa në Shtime, një lëndë. Gjykata komunale e Podujevës ka deklaruar se nuk ka lëndë të pa përfunduara para qeshorit 1999. Gjykata në Prizren ka deklaruar se përafërsisht 1000 lëndë janë të pa përfunduara, në Suha Rejë/Suva Reka 41, në Dragas/Drageash 30 dhe në Rahovec/Orahovac 326. Së fundi në regjionin e Pejës/Pec të vetmet shënime në disponim për këtë periudhë kohore vijnë nga gjykata komunale dhe ajo e qarkut të Pejës/Pec, 134 respektivisht 131.

⁶⁸ Në regjionin e Prizrenit, gjykatat kanë pranuar 3916 lëndë civile prej të cilave, përafërsisht, 15% janë pronësoro-juridike. Gadi 3000 lëndë janë parashtruar gjykatës komunale të Prizrenit.

⁶⁹ Këta numra nuk kanë të bëjnë me Mitrovicën/Mitrovica, Zveqanin, Zubin Potokun dhe Leposaviqin.

⁷⁰ Gjykatat në Lipjan/Lipljane dhe Podujevë/Podujevo kanë pranuar 15 respektivisht 9 lëndë.

⁷¹ Në Mitrovicë/Mitrovica 106, (nga shënimet ekzistuese vetëm në Skenderaj/Srbica dhe Glllogovc/Glogovac), Gjilan/Gnjilane 45, (nga shënimet ekzistuese vetëm në Gjilan/Gnjilane and Kamenicë/Kamenica), Prizren 162, (nga shënimet ekzistuese vetëm në Rahovec/Orahovac, Malishevë/Malisevo dhe Dragas/Drageash). Në regjionin e Pejës/Pec 45 lëndë (nga shënimet ekzistuese vetëm në Deçan/Decani dhe Gjakovë/Gjakovica¹

⁷² Neni paragrafi 4 i rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/45 thotë: “Çdo komunë e ka statusin e vet juridik, të drejtën për të poseduar dhe administruar pronën, mundësinë për të ushtruar padi dhe për të qenë i paditur në gjykata, të drejtën për të lidhur kontrata dhe të drejtën për të marrë punëtorë në punë”

palëve për gjykim në një kohë të arsyeshme, apo të vazhdoj duke interpretuar gjerësisht ligjin të pranoj autorizimet e dhëna ndokujt nga organet të cilat ushtrojnë funksione shtetërore. Mungesa e një politike gjithë-Kosovare dhe të definuar mirë lidhur me këto çështje, krahas mungesës së një qasjeje konsistente nga vetë komunat, është duke shkaktuar zvarritje të paarësyeshme në sistemin e drejtësisë.

Sa i përket numrit të kontesteve të zgjidhura pronësore juridike, së paku janë 119 lëndë të cilat kanë përfunduar⁷³. OSBE, nuk është në njohuri për numrin e lëndëve tjera të zgjidhura pas paraqitjes së ankesës në gjykatat e qarkut apo atë supreme. Ky numër është i kufizuar nga të dhënat e mbledhura nga komunat e caktuara.

Dallimet në mes të regjioneve sa i përket numrit të raportuar të lëndëve të pazgjidhura që nga qeshori i vitit 1999, shfaqin brengën se lëndëve pronëso-ro-juridike nuk u kushtohet vëmendje e duhur dhe si pasojë e kësaj, mund të shkelen të drejtat e njeriut. Sa i përket kontesteve të pazgjidhura që nga ardhja e UNMIK-ut, disaherë gjyqësia kishte infromuar OSBE-në se, nuk ka lëndë të pazgjidhura që nga ajo kohë, apo se gjykatat e rregullta nuk do ti pranojnë ato raste për shkak se gjykatat kanë filluar të punojnë në fillim të vitit 2000. Gjykatat tjera kanë pranuar se kanë mbetur lëndë të pazgjidhura dhe të trashëguara nga gjyqësia e mëhershme dhe megjithatë, janë duke u përpjekur t'i përfundojnë ato. Sipas mendimit të OSBE-së, lëndët e pazgjidhura që nga koha para ardhjes së UNMIK-ut, duhet të zgjidhen, pëkundër natyrës së tyre publike apo private. Kjo shkelë të drejtat e individëve të cilët kanë kërkuar vërtetimin e të drejtave dhe detyrimeve të tyre pasurore juridike përmes procedurës gjyqësore para asaj date. Së këndejmi, kjo dukuri shkelë parimet themelore të të drejtës civile dhe të drejtave të njeriut. Lëndët e pazgjidhura para qeshorit 1999 duhet të jenë të hapura dhe të gjykohen në bazë të ligjit në fuqi. Për më tepër, çështjet që kanë të bëjnë me suksesionin e përgjegjësive shtetërore do të duhej sqaruar përmes një rregulloreje, e në veçanti, vlefshmëria e detyrimeve ekzistuese ndaj individëve të cilat janë marrë përsipër nga institucionet shtetërore para UNMIK-ut. Kjo kërkon interpretimin e statusit të UNMIK-ut dhe raportit të tij me sjelljet paraprake të administratës, një çështje me të cilën deri më tani OSBE-ja nuk është marrë.

OSBE, është e vetëdijshme për pohimet e shkeljeve të kryera nga autoritetet e tanishme të cilat kryejnë funksione shtetërore. Gjithashtu, në kontestet në mes të palës private dhe autoriteteve të tilla, duhet të respektohen garancitë procedurale të parashikuara në nenin 6 të KEDNJ-së. Në Kosovë, ekziston një numër i kontesteve pronësore në gjykim e sipër ku, autoriteti i cili ushtron funksione shtetërore është palë në kontest. Deri më sot, nuk ka të dhëna të sakta për numrin dhe llojin e kontesteve të cilat datojnë prej dhe pas miratimit të Rezolutës 1244 të KSKB me të cilën autorizohet adminstrimi i Kosovës nga UNMIK-u.

Një çështje tjetër dhe e paqartë lidhur me administrimin e gjykatës i referohet dosjeve të lëndëve të zhdukura apo të shkatërruara gjatë konfliktit. Mungesa e dosjeve në gjykatë nuk mund të formësoj de facto mohimin e pranuar të drejtësisë.

Në mënyrë të sforcimit të zbatimit të ligjit, është me rëndësi të mbledhen të dhëna të sakta për numrin e lëndëve të paraqitura në gjykatë, të cilat janë të pakryera dhe të cilat vetëm sa janë kryer. Elaborimi i statistikave të sakta paraqet mjet të vlefshëm për reformën gjyqësore dhe të përmirësimit dhe përcjelljes së sistemit juridik. Përmirësimi i sistemit juridik duke mundësuar mjete efektive juridike do të siguronte një sistem gjyqësor më të afërt ndaj të drejtave të njeriut dhe largim nga përcaktimi për të ndërmarrë masa të kundërligjshme të zgjidhjes së kontesteve.

⁷³ Në regjionin e Mitrovicës/Mitrovica, gjykata në Vushtrri/Vucltrn ka përfunduar 60 lëndë, Skenderaj/Srbica 42 dhe Glogoc/Glogovac tre. Në regjionin e Gjilanit/Gnjilane, 20 lëndë janë përfunduar, Kaçanik/Kacanik tetë, dhe Viti/Vitina 18. Nuk ka të dhëna për komunat e regjionit të Prishtinës/Pristina.

5. Qasja e minoriteteve në gjykatat e rregullta, për kërkimin e vërtetimit të të drejtave të tyre pasurore juridike.

E drejta e gëzimit të qetë të pasurisë është themelore në zgjidhjen e çështjeve të cilat ndikojnë në minoritetet e Kosovës. Minoritetet, në baza ditore, i dorëzojnë ankesat e tyre OSBE-së, lidhur me shkeljet që ju bëhen ndaj të drejtave të tyre pasurore juridike. Duhet të bëhet një analizë mbi shkeljet e të drejtave pasurore juridike ndaj pjestarëve të minoriteteve, dhe në aspekt të raportit në mes të të drejtave pasurore juridike dhe të drejtës në një proces të rregullt. Në këtë aspekt, duhet bërë dallimi në mes të personit privat i cili ka ndërhyrë në të drejtat pasurore juridike të pjestarit të minoritetit, dhe autoritetit i cili ushtron funksione shtetërore i cili shkelë nenin 1, protokolli 1 të KEDNJ. Për më tepër, është me rëndësi të vëhet në pah se, në Kosovë, nuk pësojnë të gjitha minoritetet të njëjtën shkallë të shkeljeve të të drejtave të tyre pasurore juridike, por, mund të thuhet se, në bazë të numrit të rasteve, serbët e Kosovës janë ata të cilët më së shumti janë të ndikuar nga këto sjellje. OSBE, në raportin e saj të fundit⁷⁴, ka rekomanduar se duhet mundësuar që minoritetet të kenë qasje të plotë në DPÇBP dhe KKP. Gjithashtu, janë bërë përpjekje për të siguruar se minoritetet në Kosovë, mund të parashtrijnë ankesat pranë këtyre mekanizmave. Në anën tjetër, si shqetësim serioz për OSBE-në, mbetet çështja e qasjes dhe trajtimit të barabartë të minoriteteve para gjykatave të rregullta, në vërtetimin e të drejtave dhe detyrimeve të tyre civile juridike.

Për shkak të jetës së shkurtë të institucioneve të përkohëshme të vetqeverisjes, akoma nuk është e mundur të vlerësohet se deri në çfarë shkalle, gjykatat i përmbahen garancive të nenit 6 (proces të rregullt) dhe nenit 14 (mos diskriminimi) (lexo faqen 7), gjatë shqyrtimit të kontesteve në mes të individëve apo grupeve përkatëse të minoriteteve dhe autoriteteve të cilat ushtrjnë funksione shtetërore. Gjithsesi, dispozitat e cituara të ligjeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut zbatohen ndaj të gjithë qytetarëve, çfarëdo përkatësie etnike çofshin ata, por të drejtat e minoriteteve janë më të rrezikuara para autoriteteve shtetërore. Në këto raste, procedurat gjyqësore shpeshherë, nuk i kanë shfrytëzuar të gjitha mjetet administrativo-juridike⁷⁵, edhe pse një numër i vogël i rasteve janë paraqitur në gjyq. Sidoçoftë, kjo nuk nënkupton se autoritetet nuk duhet t'i përmbahen obligimeve që dalin nga neni 6 lidhur me procedurën e drejtë gjyqësore, me rastin e ndërhyrjes në të drejtat pasurore juridike të individëve. Në këto rrethana, OSBE, vazhdon me përpjekjet e saja të drejtuara autoriteteve kombëtare dhe ndërkombëtare, të parandaloj shkeljet potenciale të të drejtave të njeriut.

Nëse shikojmë kontestet në mes të personave privatë, ku njëra prej palëve i përket minoriteteve, atëherë, vëhet në mëdyshje qasja e individit në një tribunal të pavarur dhe të paanshëm, për vërtetimin e të drejtave dhe detyrimeve civile juridike. Neni 6 i KEDNJ-së, parashikon kërkesa/kushte të veçanta të cilat një gjykim duhet përmbushur, në mënyrë që të jetë në harmoni me standardet për të drejtat e njeriut.

Qasja e minoriteteve në gjykatë, varet nga minoriteti përkatës dhe nga shtrirja gjeografike dhe gjithëherë nga rrethanat e rastit. Serbët e Kosovës, gëzojnë qasje relativisht të papenguar vetëm në Gjykatat Komunale të Kamenicës/Kamenica, Vitisë/Vitina, Gjilanit/Gnjilane dhe Mitrovicës/Mitrovica. Në pjesën tjetër të Kosovës, kushtet e sigurisë ndikojnë në lirinë e lëvizjes

⁷⁴ Lexo raportin tematik të OSBE-së, “ Kriza e afërt pronësore e Kosovës (shtator 2000).

⁷⁵ Neni 35 i rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/45 mbi vetqeverisjen e komunave thotë: “Çdo qytetar mund të parashtrijë ankesë ndaj vendimit administrativ të komunës, nëse ai apo ajo mendon se me atë vendim i janë cenuar të drejtat e tij ose të saj. Ankesat i dorëzohen me shkrim kryeshefit ekzekutiv, ose personalisht zyrës së kryeshefit ekzekutiv”, neni 33 i të njëjtës rregullore të UNMIK-ut thotë: “Parimi i ligjshmërisë. Ligji dhe drejtësia e obligojnë administratën e komunës që të zbatojë, në veçanti të drejtat dhe liritë e njeriut sipas Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut. Të gjitha veprimet administrative duhet t'i përmbahen ligjit në fuqi”.

për serbët e Kosovës atëherë kur ata dëshirojnë qasje në gjykatë. Është interesant se, kur të ndodhë një shitblerje në mes të serbit të Kosovës si shitës dhe shqiptarit të Kosovës si blerës, të dyja palët dhe përfaqësuesit e tyre ligjorë, gëzojnë qasje në gjykatë për t'i kryer formalitetet përkundër dallimeve të tyre etnike. Në tri komunat në regjionin e Mitrovicës veriore dhe në Strpce/Shtërpçë, ekzistojnë gjyqet ilegale paralele. Gjithsesi, vendimet e pruara nga këto gjykata nuk mund të konsiderohen të vlefshme në Kosovë.

Minoritetet tjera në Kosovë, gëzojnë qasje në gjykata, me përjashtim të romëve të Kosovës në Prishtinë/Pristina (përfshirë edhe Fushë Kosovën/Kosovo Polje dhe Obiliqin/Obilic) dhe në Lipjan/Lipljane. Ky minoritet, nuk paraqet ankesa, nuk i përgjigjet thirrjeve, nuk paraqet dëshmi apo ndryshe nuk merr pjesë në këtë sistem për shkaqe të sigurisë.

Mungesa e qasjes së papenguar të minoriteteve në gjykata, në mënyrë të keqe ndikon në të drejtat e tyre të kërkojnë vërtetimin gjyqësor të të drejtave dhe detyrimeve të tyre. Gjithshtu ndikon keq në të drejtën e tyre për një gjykim të drejtë kur palët tjera i padisin ato, pasi që ata mund të mos marrin pjesë në një proces gjyqësorë i cili përfundon me aktvendim. Pra, lidhur me këtë çështje, ekziston jokonsistencë serioze në mesin e gjykatave të ndryshme në tërë Kosovën. Disa gjykata të rregullta, nuk vazhdojnë me procedurë nëse thirrjet gjyqësore nuk janë realizuar, pa marrë parasysh arsyetimet që mund të ekzistojnë. Disa gjykata tjera të rregullta, vazhdojnë procedurën pas dorëzimit të thirrjeve personit por që personi në fjalë dy herë rradhazi nuk i është përgjigjur thirrjes apo në rastet kur personi nuk mund të gjindet. Policia e UNMIK-ut, luan një rol shumë të rëndësishëm për qasjen e minoriteteve në gjykata, pasi që përcjelljet nevojiten shpeshherë. Për shembull, nuk duket se ekziston një politikë e unisuar e veprimit në Kosovë, për përcjelljen e personave privatë të cilët janë palë në kontestet civile dhe të cilat i takojnë grupeve të minoriteteve. Në disa komuna, policia e UNMIK-ut, ofron përcjellje adekuate ndërsa në disat të tjera, këtë e refuzojnë në mënyrë sistematike. Duhet sqaruar ligji në fuqi lidhur me gjykimet në mungesë, thirrjet dhe roli i policisë në ofrimin e përcjelljes për në gjykata për palët në kontestet civile juridike.

Krijimi i njësitit përkatës në kuadër të Departamentit të Drejtësisë, i cili i dedikohet çështjeve të lidhura me minoritetet dhe sistemin juridik të Kosovës, paraqet një hap të rëndësishëm në adresimin e problemeve me të cilat përballohen këto popullata. Krahas kësaj, OSBE, dëshiron të potencojë se, ky njësit për minoritete duhet të sigurojë se do t'i shmangët gjykatave të segreguara nëpër enklava apo gjykatësve minoritarë të cilët merren vetëm me rastet e minoriteteve. OSBE, beson se çelës kryesorë është integrimi i të gjitha grupeve etnike në sistemin juridik.

6. Rekomandimet parkitazi me të drejtat pronësore dhe procesin e rregullt gjyqësor nëpër gjykatat e rregullta në Kosovë

Mbi reformën e përgjithshme të sistemit juridik civil, duke përfshirë këtu edhe çështjet substanciale dhe ato procedurale:

- **Duhet të themelohet një komitet drejtues i përbërë nga disa agjenci me qëllim të zhvillimit, promovimit dhe hartimit të legjislacionit dhe dokumenteve tjera të cilat kanë për qëllim adresimin e problemeve të cilat janë identifikuar në këtë kapitull**
- **Një grup i tillë punues duhet të ketë përkrahjen e plotë të instancave më të larta të organizatave të përfshira në këtë proces.**
- **Komiteti i tillë Drejtues duhet të përfshijë edhe përfaqësuesit e katër shtyllave të UNMIK-ut, agjencive të pavarura me kompetenca ndaj çështjeve pronësore, në veçanti DPCBP-ja dhe Agjencioni Katastral i Kosovës dhe përfaqësuesit e Institucioneve të**

Përkohshme të Vetëqeverisjes. Komiteti Drejtues duhet të formoj grupet punuese të përbëra nga akterët relevant me qëllim të identifikimit të problemeve dhe formulimit të zgjidhjeve dhe politikave që kanë të bëjnë me të drejtat pronësore dhe procesin e rregullt.

Mbi konfliktin e kompetencave ndërmjet të gjykatave dhe KKPB-së:

- Gjyqësia duhet të pranoj dhe respektoj mandatin e KKPB-së. Njësia për Inspektim Gjyqësor dhe Këshilli Gjyqësor dhe i Prokurorisë së Kosovës duhet të siguroj një gjë të tillë.
- Ligjet relevante procedurale, duke përfshirë këtu edhe Ligjin e Procedurës Civile, Librin e Rregullave për Gjykatat e rregullta dhe Ligjin e Procedurës Administrative duhet të ndryshohen qoftë nëpërmjet të Rregulloreve apo Urdhëresave Administrative me qëllim të sigurimit të integritetit të DPÇBP-së dhe KKPB-së në sistemin juridik dhe garantimit të së drejtës për proces të mirëfilltë gjyqësor.
- KKPB-ja duhet të miratoj rregulla shtesë dhe PSSP-ja duhet të lëshoj urdhëresa administrative me qëllim të harmonizimit të procedurave të këtyre institucioneve me ligjin e aplikueshëm vendës.
- Gjyqësia duhet të informohet në mënyrë adekuate përkitazi me të gjitha ndryshimet që bëhen në ligjin e zbatueshëm vendës dhe për zhvillimet e mëtutjeshme në lidhje me nxjerrjen e Rregulloreve të UNMIK-ut dhe instrumenteve subsidiare, dhe gjithashtu duhet të trajtohet mbi këto çështje në mënyrë të duhur.
- Roli i Gjykatës Supreme përkitazi me konfliktin e kompetencave duhet të qartësohet nga ana e vetë Gjykatës Supreme qoftë nëpërmjet të jurisprudencës së sah apo nëpërmjet të një grupi punues të përbërë nga më shumë agjenci të themeluar përkitazi me mospërputhjen e jurisdikcionit. Rezultati i gjithë kësaj pune duhet të inkorporohet në reformat e gjithëmbarshme ligjore.

Mbi ngecjen e zgjidhjes së kontesteve pronësore:

- Ministria e Shërbimeve Publike në bashkëpunim me Departamentin e Drejtësisë duhet të implementoj një sistem adekuat për mbledhjen e statistikave.
- Në pajtim me mandatin e tyre përkitazi me çështjet gjyqësore, Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes duhet të formulojnë rekomandime përkitazi me krijimin e kategorive të reja të kontesteve pronësore, sidomos të atyre të cilat presin zgjidhje gjatë periudhës para 12 qeshorit 1999 dhe atyre rasteve të cilat kanë humbur si rezultat i konfliktit. Kjo duhet të pasohet me një legjislacion të përshtatshëm.
- Ligji mbi Avokatin Publik duhet të azhurohet nga vetë PSSP-ja në mënyrë që ajo të jetë në gjendje t'i plotësoj nevojat ditore siç janë: përfaqësimi ligjor i komunave i cili duhet të bëhet në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/45 dhe në këtë mënyrë të dilet nga kjo ngecje e kontesteve veçanërisht të atyre kur komuna është njëra nga palët kontestuese. Kjo nevojë duhet të aplikohet edhe sa i përket përfaqësimit ligjor të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes.
- Duhet të bëhet gjithashtu edhe një përcaktim i qartë i statusit të atyre kontesteve pronësore të cilat prisnin zgjidhjen e tyre nëpër gjyqe para themelimit të UNMIK-ut,

përcaktim ky i cili duhet bërë në kontekst të reformave të propozuara ligjore në këtë raport. Në veçanti, është shumë e rëndësishme që të qartësohet fakti se nëse procedurat gjyqësore për zgjidhjen e këtyre kontesteve janë ndërprerë për shkak të konfliktit të armatosur ato duhet të rifillojnë përsëri duke pasur parasysh pasojat të cilat palët kontestuese mund t'i kenë si rezultat i kësaj.

- OSBE-ja sugjeron se në të gjitha kontestet të cilat presin zgjidhje qoftë para periudhës së konfliktit apo pas tij për të cilat konteste nuk ekzistojnë kurrfarë shënimesh përkatëse, palët e interesuara duhet të informohen përkitazi me statusin e procedurave gjyqësore, se dëshmitë janë duke u riekzaminuar dhe se zgjidhjet përkatëse duhet të gjinden në këtë drejtim duke iu përmbajtur konditave strikte të cilat i parasheh ligji.

Mbi qasjen e minoriteteve në gjyqe:

- Seksioni për Integrim Gjyqësor duhet të posedoj me resurse adekuate në mënyrë që të kryej mandatin e tij.
- Seksioni për Integrim Gjyqësor duhet t'i kushtoj vëmendje të veçantë jurisdikcionit civil.
- Qartësia dhe uniformiteti duhet të sigurohet sidomos kur kemi të bëjmë me gjykimet në mungesë, thirrjen e dëshmitarëve dhe palëve në gjyq, dhe detyrimet e organeve për zbatimin e ligjit për të siguruar përcjellje adekuate të sigurisë për minoritetet nëse një gjë e tillë është e nevojshme.

Fjalorth

<i>KEFDG</i>	<i>Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Gruas</i>
<i>KEFDR</i>	<i>Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor</i>
<i>KDF</i>	<i>Konventa për të Drejtat e Fëmiut</i>
<i>DD</i>	<i>Departamenti i Drejtësisë</i>
<i>AER</i>	<i>Agjencia Evropiane për Rindërtim</i>
<i>KEDNJ</i>	<i>Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut</i>
<i>GJEDNJ</i>	<i>Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut</i>
<i>RFJ</i>	<i>Republika Federative e Jugosllavisë</i>
<i>IRJM</i>	<i>Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë</i>
<i>DPÇBP</i>	<i>Drejtorati për Çështje Banesore dhe Pronësore</i>
<i>KKPB</i>	<i>Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore</i>
<i>SDNJ</i>	<i>Spektori për të Drejtat e Njeriut pranë OSBE-së</i>
<i>MNDCP</i>	<i>Marrëveshja Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike</i>
<i>MNDESK</i>	<i>Marrëveshja Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike Sociale dhe Kulturore</i>
<i>PZH</i>	<i>Personat e Zhvendosur</i>
<i>KFOR</i>	<i>Forca e Kosovës</i>
<i>UÇK</i>	<i>Ushtria Çlirimtare e Kosovës</i>
<i>OSBE</i>	<i>Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë</i>
<i>OMiK</i>	<i>Misioni i OSBE-së në Kosovë</i>
<i>RSFJ</i>	<i>Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë</i>
<i>KSAK</i>	<i>Krahina Socialiste Autonome e Kosovës</i>
<i>PSSP</i>	<i>Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm</i>
<i>UNMIK</i>	<i>Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve</i>

të Bashkuara në Kosovë

UNCHS

Komisioni i Kombeve të Bashkuara për Strehim Njerëzor

UNSCR

Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara

Shtojca: Prona në Kosovë – një pasqyrë historike

Mungesa e qartësisë përkritazi me të drejtën e pronësisë për pronat në Kosovë është e përbërë nga një sërë incidentesh të konfiskimit masiv të pasurisë e cila ka ndodhur gjatë këtij shekulli, qoftë për arsye etnike, apo për arsye tjera politike apo sociale. Kjo në vete do të kishte krijuar shumë e shumë probleme për të cilat do të ishin nevojitur vite të tëra për t'i zgjidhur, si në vendet post-socialiste. Sidoqoftë, situata në Kosovë që nga viti 1989 ka lënë një trashëgimi të tërë të problemeve të pazgjidhura pronësore:

Sistemi i pronave filloj të shkatërrohet që nga viti 1989 kur regjimi i Beogradit kishte pruar në fuqi një sërë ligjesh diskriminuese të pronave. Si rezultat i kësaj, një numër mjaft i madh i shqiptarëve të Kosovës humbi të drejtat e tyre të posedimit ndaj pronave të shoqërore e cila kohëpaskohe në shumëra të jepeshin serbëve të Kosovës apo refugjatëve serb nga Kroacia. Si rrjedhojë e kësaj, shumica e shitblerjeve të pronave të cilat ndodhnin ndërmjet grupeve të ndryshme etnike gjatë kësaj periudhe ishin joformale (p.sh pa shënime ligjore) e cila rezultonte me një fakt se dosjet në lidhje me pronat dhe katastrofat humbnin vlerën e tyre si dokumentacion i saktë në lidhje me këtë problematikë.

Sistemi i pronave më në fund u shkatërrua si pasojë e ngjarjeve të periudhës së pas vitit 1998. Shkatërrimi dhe largimi i dosjeve të pronave nga ana e autoriteteve jugosllave e kanë bërë shumë të vështirë vërtetimin e pronësisë ndaj një prone. Lufta e cila pasoi me bombardimet e NATO-s, rezultoi me një shkatërrim masiv të pronave, dhe në vitin 1999, me një evakuim masiv të popullatës shqiptare. Që nga ardhja e UNMIK-ut dhe KFOR-it, gjendja në këtë drejtim është shkatërruar edhe mëtej për shkak të ikjes së një numri të madh të pjesëtarëve të pakicave (serbëve, romëve⁷⁶, sllavo-muslimanëve) të cilët lenin pas vetes pronat e tyre të braktisura. Në shumicën e rasteve kjo pronë ishte ose e shkatërruar ose e uzurpuar.⁷⁷

Mungesa e autoriteteve komunale në Kosovë e cila pasoi pas largimit të autoriteteve jugosllave nga Kosova në vitin 1999, lindja e 'qeverive' paralelele e komplikonte edhe mëtej situatën e krijuar në Kosovë. Këto autoritete të vetëshpallura, të cilat toleroheshin në masë të madhe edhe nga ana e bashkësisë ndërkombëtare deri në krijimin strukturave të përbashkëta të përkohshme administrative në janar 2000, të cilët themeluan komisionet e tyre përkritazi me pronën të cilat në shumë raste kryenin edhe dëbime të paligjshme dhe i vendosnin uzurpuesit e paligjshëm nëpër ato prona me përkrahjen e forcave ilegale policore.

Në nëntor të vitit 1999 UNMIK-u themeloi Drejtoratin për Çështje Banesore dhe Pronësore dhe Komisionin për Kërkesa Pronësore dhe Banesore institucione këto të themeluara enkas për qëllim të zgjidhjes së kërkesave pronësoro-juridike sa i përket pronës banesore. UNMIK-ut iu nevojiti gati një vit në mënyrë që t'i bie në fuqi Rregullat e Procedurës të këtyre dy institucioneve. Pa rregulla të tilla institucionet në fjalë nuk mund të ushtronin mandatin e tyre dhe si rezultat i kësaj kërkesat në lidhje me pronën banesore mbatën të pazgjidhura. Në nëntor 2001, PSSP-ja nxorri Rregullat e Procedurës dhe të Dëshmisë të Drejtoratit për Çështje Banesore dhe Pronësore dhe Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore duke siguruar në këtë mënyrë kornizën ligjore për veprimin e institucioneve në fjalë. Gjatë atij viti pas miratimit të rregullave të këtyre dy institucioneve pasoi edhe hapja e zyreve nga ana e DPÇBP-së në katër regjionet e Kosovës, të cilat pranonin shumicën e kërkesve pronësoro-juridike të parashtruara përderisa një numër i pronave banesore u vendosën nën administrimin e DPÇBP-së. Gjatë kësaj kohe edhe KKPBP-ja

⁷⁶ Përfshirë këtu edhe ashkalinjtë dhe egjiptasit.

⁷⁷ Në disa raste, shqiptarët e Kosovës pohonin se pjesëtarët e minoriteteve të cilët po i lëshonin vatrat e tyre i kishin shkatërruar vetë pronat e tyre, me qëllim që t'i parandalonin të tjerët që të hyjnë në to për të banuar. Dëshmitë për këtë, megjithatë, bëjnë me dije se ekzistojnë raste të dëmtimit apo shkatërrimit të pronave nga ana e vetë pjesëtarëve të minoriteteve të cilët po i lëshonin vatrat e tyre, mirëpo rastet e tilla ishin më pak të zakonshme se shkatërrimi nga ana e individëve tjerë të panjohur. .

filloi të merr vendime. Përkundër përparimit të arritur gjatë kësaj periudhe mekanizmi për mbrojtjen e të drejtave pronësore është larg nga të qenurit plotësisht funksional. Në janar 2002, institucioni është duke u ballafaquar me një krizë të thellë financiare dhe shumica e aktiviteteve të saj do të pushojnë..

Kosova është një vend me një numër të madh të pronave të shkatërruara dhe atyre të braktisura. Shumë prona kanë nga disa persona të cilat parashtrajnë kërkesë për vërtetimin e pronësisë, dhe vërtetimin i pronësisë së një prone është një detyrë tejet e vështirë. Duke marrur parasysh vakumin e krijuar ligjor dhe institucional, nuk është edhe aq befasuese të konkludojmë se pse uzurpimet dhe ndërtimet e paligjshme janë aq të përhapura. Nën rrethana të tilla, pa një mekanizëm funksionues për mbrojtjen e të drejtave pronësoro-banesore, kthimi i personave të zhvendosur nga Serbia dhe Mali i zi nuk ka kurrfarë gjasash të ndodh.